



**PLANI NACIONAL AKSIONAL I PARTNERITETIT PËR QEVERISJE TË HAPUR
2024-2026**

Shkup, shkurt 2024

LISTA E SHKURTESAVE

APRMV – Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut
NJF – Ndihmë Juridike Falas
QRMV - Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
OQ – Organizatat Qytetare
SP i QRMV - Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut
ESHR – Enti Shtetëror për Revizion
ESHS – Enti Shtetëror për Statistik
KSHZ – Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
KSHPK - Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
NJVL – Njësi të Vetëqeverisjes Lokale
ENER – Regjistri Unik Nacional Elektronik i Rregulloreve
ESB - Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave
SEPP – Sistemi Elektronik i Prokurimeve Publike
BE – Bashkimi Evropian
BNJVL – Bashkësia e Njërive të Vetëqeverisjes Lokale
SHHA – Shoqata për Hulimtim dhe Analizë
IDSC - Instituti për Demokraci Societas Civilis
TIK – Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
INA – Instrumenti për Ndihmë Paraaderuese
INR – Instituti Ndërkombëtar Republikan
TI – Teknologjia informatike
PPP – Partneriteti Privato – Publik
SMM – Sistemi i Menaxhimit të Mësimit
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
MMJPH - Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
MSH - Ministria e Shëndetësisë
MBPEU – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave
MSHIA - Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
MVL - Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
MD - Ministria e Drejtësisë
LLMPI – Llogaritja Mujore për Pagesën e Integruar
MPPS - Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
MF - Ministria e Financave

OJQ – Organizatat Joqeveritare

PNA – Plani Nacional Aksional

PNA 6- Plani i Gjashtë Nacional Aksional i Partneritet për Qeverisje të Hapur për periudhën 2024-2026

PTHP – Prokuroria Themelore Publike

PQH – Partneriteti i Qeverisjes së Hapur

RMV – Republika e Maqedonisë së Veriut

DAP –Drejtoria e të Ardhurave Publike

QKQ – Qendra për Komunikime Qytetare

RQRMV - Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut

QPS – Qendrat për Punë Sociale

HYRJE

Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV) është anëtare e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (PQH) që nga fundi i vitit 2011.

Përmes modelit të PQH-së, anëtarët i shfyrëtojnë përfitimet nga bashkëpunimi ndërmjet sektorit publik dhe sektorit joqeveritar për tu përballur me sfidat përmes formimit të koalicioneve për avancimin e reformave dhe për përhapjen e inovacioneve nëpër vende. PQH-ja u ndihmon qeverive të ko-krijojnë, zbatojnë dhe njoftojnë mbi planet nacionale aksionale duke e bërë qeverinë më inkluzive, më llogaridhënëse dhe më të përgjegjshme

RMV -ja është e dedikuar në këtë iniciativë dhe ka bërë përparim të mirë dhe të njohur gjatë viteve të kaluara. Që në fillimit e saj, RMV-ja me përkushtim ka përcjellë nevojën për angazhim dhe përfshirje më të madhe të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, futjen e standardeve më të larta të integritetit dhe qasje më të madhe në teknologji për të gjithë qytetarët.

Nga themelimi i tij në vitin 2011 e deri më sot, në PQH marrin pjesë 75 vende dhe 104 pushtete lokale të cilët punojnë së bashku me mijëra organizata qytetare. Çdo dy vjet, çdo shtet anëtar paraqet plan aksional të ko-krijuar me shoqërinë civile, në të cili përcaktohen angazhimet konkrete për përmirësimin e transparencës, përgjegjshmërinë dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje.

Përkushtimi për hapje solli shumë dobi, duke e bërë qeverinë më transparente dhe më të përgjegjshme, duke krijuar potencial për zhvillim të një ambienti dinamik për përfshirje, udhëheqje efikase me resurset publike, ndërtim të sistemit të integritetit, hapësirë mundësuese në nivel lokal, qasje në informacione dhe të dhëna të hapura. Përmes hapjes dhe vendosjes së resurseve tona në dobi të publikut, ia dolëm të përmirësojmë dialogun, inovacionet dhe përdorimin e teknologjisë që e bëjnë jetën e qytetarëve më të mirë dhe më të lehtë.

Plani i Gjashtë Nacional Aksional i Partneritet për Qeverisje të Hapur për periudhën 2024-2026 (PQH 6) ndërlidhet me intensitetin e mëparshëm të punës me ndërmarrjen e obligimeve për rritjen e pjesëmarrjes së publikut dhe ofrimin e zgjedhjeve të vërteta transformuese. Gjithashtu, e njëj nevojën që sektori publik të inovohet, të zhvillojë politika që përgjigjen me nevojat e qytetarëve si përgjigje ndaj trendeve bashkëkohore.

PQH i 6 i ri e vërteton nevojën e thellimit të obligimit të mëparshme dhe përmirësimit të kualitetit të tyre dhe atë përmes angazhimeve për qeveri të hapur parlament të hapur dhe gjyqësor të hapur. Pritet që pas periudhës dyvjeçare të realizimit të angazhimeve të përcaktuara në këtë plan aksional do të mundësohet njohje e vërtetë e rezultateve ndërsa qytetarët

Bazuar në suksesin e arritur nga zgjerimi i mëparshëm i kësaj iniciative në kuadër të Kuvendit, në ciklin e pestë 2021-2023, krahas angazhimeve për Parlamentin e Hapur, u krijuan edhe angazhimet për Gjyqësor të Hapur.

do të kenë mundësi ta vërtetojnë ndryshimin..

Në PNA 6 janë përfshirë fushat/angazhimet prioritare të mëposhtme:

QEVERI E HAPUR
• Participim në vendimmarrje dhe pjesëmarrje qytetare, • Fuqizim juridik dhe qasje në drejtësi, • Lufta kundër korrupsionit, • Zhvillim dhe përdorimi i teknologjive digjitale dhe • Promovim i aktiviteteve për ndryshimet klimatik.
PARLAMENT I HAPUR
• Regjistër i trupave rregullator të themeluara nga Kuvendi • Informim i publikut përmes kanalit televiziv të Kuvendit

- Debat mbikëqyrës në Kuvend për zbatimin e planit nacional PQH 2024-2026 dhe -
- Parlament karvan - mobil parlamentar për komunikim të drejtpërdrejtë të deputetëve me qytetarët

GJYGJËSOR I HAPUR

- Qasje në informacione dhe të dhëna dhe
- Performanca.

PËRPIEKJET E DERITANISHME PËR PARTNERITET PËR QEVERISJE TË HAPUR

Përmes kësaj iniciative globale, RMV përmes [pesë planeve aksionale](#) (2012-2014; 2014-2016; 2016-2018 2018-2020 dhe 2021-2023) ka arritur arritje të rëndësishme në sfera të ndryshme të rëndësishme duke përfshirë transparencën fiskale dhe financat e hapura, bashkëpunimin me shoqërinë qytetare, qasje në informacione të karakterit publik, krijimin participativ të politikave, shërbime publike, hapësirë e volitshme juridike për marrëveshje sociale, të dhëna të hapura, parandalim i korupsionit, prokurimet publike, transparenca në nivel lokal, qasje në drejtësi dhe ndryshimet klimatike.

Është futur praktika e mirë e ndërlidhjes së angazhimeve nga Plani nacional me qëllimet e përcaktuara në Agjendën për zhvillim të qëndrueshëm deri më vitin 2030, veçanërisht me qëllimin 16 „-Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme-“, 3 „-Shëndet i mirë dhe mirëqenie-“, 11 „-Qytetet dhe vendbanimet njerëzore të jenë përfshirëse, të sigurt, rezistente dhe të qëndrueshme-“, 13 „-Aksioni klimatik-“ dhe qëllimi 17 „-Partneritet për qëllimet-“.

Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve është parakusht bazë për suksesin e partneritetit për qeverisje të hapur. -Pjesëmarrja e shoqërisë civile është kyçe për qeverisje të hapur dhe element kyç në ciklin nacional për krijim të planeve aksionale..

Bazuar në udhëzimet për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në iniciativën Partneritet për Qeverisje të Hapur dhe Standardet për ko-krijimin dhe dizajnimin e forumit me

më shumë palë, është krijuar strukturë e përshtatshme për koordinim, monitorim dhe pjesëmarrje në këtë proces, dhe atë:

KËSHILLI PËR KORDINIM DHE MONITORIM TË PROCESIT TË PARTNERITETIT TË QEVERISJES SË HAPUR DHE PLANIT NACIONAL AKSIONAL 2021-2023.

Këshilli ka rol kyç dhe ka për qëllim në mënyrë të strukturuar të maksimizojë

pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë qytetare, nëpërmjet përfshirjes së partnerëve relevantë në diskutim dhe mundësinë për t'u dëgjuar zëri i të gjithëve.

Këshilli i Partneritet për Qeverisje të Hapur është i përbërë nga 16 anëtarë, tetë prej të cilëve e përfaqësojnë Qeverinë, Kuvendin dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe numër të barabartë përfaqësuesish nga organizatat e shoqërisë civile të nominuar përmes Rrjetit të Organizatave Civile për Partneritet për Qeverisje të Hapur.

Këshilli për PQH e monitorton zbatimin e PNA-s aktual për PQH shqyrton dhe propozon raporte për zbatimin e Planit Aksional, në përputhje me afatet e

paracaktuara nga QRMV-ja dhe iniciativës ndërkombëtare, shqyrton dhe propozon udhëzime për avansimin e procesit në përputhje me udhëzimet që rrjedhin nga iniciativa ndërkombëtare, e përcakton kornizën kohore dhe mënyrën e zbatimit të procesit të ko-krijimit të Planit Aksional, zhvillon procedurë të konsultimeve për Draft Planin Aksional dhe e propozon PNA për PQH deri tek QRMV-ja për miratim, dhe siguron dialog të vazhdueshëm të organeve të administratës shtetërore, si dhe institucioneve të tjera të pushtetit shtetëror organizatave qytetare, sektorit të biznesit, bashkësisë akademike, mediumeve, dhe përfaqësues të tjerë për të përmirësuar standardet e hapjes dhe transparencës së pushteteve

GRUP PUNUES ME TË GJITHA PALËT PËR ZBATIMIN E PLANIT NACIONAL AKSIONAL PËR PARTNERETIN E QEVERISJES SË HAPUR 2021-2023

Koordinimin e zbatimit të angazhimeve dhe arritjeve të Planit Nacional Aksional të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur 2021-2023 e siguron

kordinatori nacional i partneritetit të qeverisjes së hapur, ndërsa grupin punues e përbëjnë koordinatoret e prioritetëve, zëvendës - koordinatoret e prioritetëve, koordinatoret e angazhimeve dhe anëtarët e nëngrupeve punuese me angazhim nga Planin Nacional Aksional i Partneritetit të Qeverisjes së Hapur 2021-2023.

Për monitorimin e statusit të realizimit të PNA dhe për përgaditjen e Raportit të Vetë-Vlerësimit dhe Raportit Përfundimtar të Vlerësimit të Zbatimit, MSHIA i përdor të dhënat e ofruara nga ana e nëngrupeve të punës.

RRJETI I ORGANIZATAVE QYTETARE I PARTNERITETIT TË QEVERISJES SË HAPUR.

Qëllimi kryesor i Rrjetit është ta koordinojë dhe të përforcojë zërin e organizatave qytetare të cilat angazhohen për participim, hapje dhe llogaridhënie të pushteteve. Rrjeti angazhohet për inicim, inkurajim, zbatim, mbështetje, zbatim dhe monitorim të procesit të PQH dhe për inkurajimin e pushteteve dhe institucionet tjera për të rritur transparencën e tyre llogaridhënie dhe hapje për pjesëmarrje (participim). Në rrjet janë të përfshirë më shumë se 70 organizata qytetare.

PORTALI PËR PARTNERITETIN E QEVERISJES SË HAPUR (<https://ovp.gov.mk>)

Portali për PQH paraqet pikë qendrore për konsultim, monitorim, përfshirje, rrjetëzim dhe njoftim të të gjithë palëve të interesuara dhe të prekura në këtë proces. Portali për PQH shërben si platformë për interaksion dhe shkëmbim të informacioneve në katër segmente të këtij procesi: konsulta për përgatitje të Planit nacional aksional, monitorimin e zbatimit të PNA, si dhe monitorimin e punës së Këshillit për PQH dhe Rrjetit të organizatave qytetare për PQH. Portali ofron mundësi për mbajtjen e takimeve virtuale online me biseda të pjesëmarrësve drejtpërdrejtë – „live chat” dhe video-lidhje.

Këshilli për PQH, grupi punues me të gjitha palët e interesuara për zbatimin e Planit Nacional Aksional të Partneritet për Qeverisje të Hapur 2021-2023 dhe Rrjeti i Organizatave Qytetare të Partneritet për Qeverisje të Hapur, e përfaqësojnë strukturën për koordinimin, monitorimin dhe zbatimin e procesit të PQH-së në RMV.

Prandaj, procesi i PQH edhe në ciklin e gjashtë u mbështet gjithashtu nga Këshilli i PQH, Grupi Punues i PQH-së dhe Rrjeti i Organizatave Qytetare të Partneritet për Qeverisje të Hapur dhe u mundësua në mënyrë të strukturuar të maksimizojë pjesëmarrjen dhe kontributin e përfaqësuesve të opinionit dhe të sektorit joqeveritar.

ZHVILLIMI I PLANIT NACIONAL AKSIONAL PËR PARTNERITET TË QEVERISJES SË HAPUR PËR PERIUDHËN 2024-2026

Këshilli i PQH dhe Rrjeti i PQH, e vazhduan praktikën e mirë të mbështetjes dhe përfshirjes aktive në procesin e ko-krijimit të PNA 6.

Me qëllim që të sigurohet mënyrë e sistematizuar e planifikimit dhe e implementimit të procesit të konsultimit, i cili do të sigurojë proces transparent, inkluziv dhe të pandërprerë të ko-krijimit të Planit Aksional, në vitin 20223 u përcaktua mënyra e implementimit të procesit të ko-krijimit të PNA si dhe i Procedurës së implementimit të konsultimeve me palët e përfshira lidhur me krijimin e prioriteteve të reja dhe angazhimeve në kuadër të procesit të PQH me kornizë kohore, dhe Thirrje e hapur për paraqitje për pjesëmarrje në procesin e ko-krijimit të PNA 6.

Gjithashtu janë përgatitur edhe materiale që rrjedhin procedura e konsultimit: Afati kohor për përgatitjen, Materiali edukativ dhe Kriteret për vlerësimin e rëndësisë dhe lidhjes me parimet e PQH-së-së. Të gjitha [dokumentet](#) janë të disponueshme në portalin për PQH.

KORNIZA KOHORE PËR KO-KRIJIMIN E PNA 6

Me qëllim planifikimin dhe përgatitjen në kohë të procesit të ko-krijimit të PNA6, Këshilli i PQH-së në maj të vitit 2023 miratoi Kornizë kohore të aktiviteteve për përgatitjen e Plani Aksional për Partneritetin e Qeverisjes e Hapur për periudhën 2024-2026.

KORNIZA KOHORE E AKTIVITETEVE PËR PËRGADITJE TË PLANIT AKSIONAL TË PARTNERITETIT PËR QEVERISJE TË HAPUR 2024-2026

THIRJE PUBLIKE

Java e I e Qershorit 2023
Thirje Publike për Pjesëmarrje dhe Paraqitje

Java e I e Korikut 2023
Ngjarje Publike për fillimin e procesit të ko-krijimit

Java e I e Korikut 2023
Formim i grupeve punuese sipas sferave prioritare për ko-krijim

EDUKIM DHE INFORMIM

Java e I e Qershorit 2023

Publikim i materialeve edukative për PQH dhe procesin e ko-krijimit të PA

KONSULTIM NË PROCESIN E KO-KRIJIMIT

Java e I e Qershorit 2023
Pyetsor për zbatimin e angazhimeve nga PNA 5

TAKIMI I PARË (Java e I e Korikut 2023)
IDENTIFIKIM DHE PËRSHKRIM I PROBLEMEVE TË REJA

TAKIMI I DYTË (Java e III e Korikut 2023)
IDENTIFIKIM I AKTIVITETEVE NË VAZHDIM LIDHUR ME PROBLEMET E PËRCAKTUARA

TAKIMI I TRETË (Java e IV e Shtatorit 2023)
PËRCAKTIM I ZGJIDHJEVE TË MUNDSHME DHE SHPËRNDARJA E TYRE SIPAS PRIORITETEVE

Java e IV e Shtatorit 2023
TAKIM I KËSHILLIT PËE PQH PËR PRIORITIZIMIN E ANGZHIMEVE DHE SHPËRNDARJA E TYRE SIPAS PRIORITETEVE

TAKIMI I KATËRT
Java e III e Tetorit – IV e nëntorit 2023
ZHVILLIM I ANGZHIMEVE DHE INDIKATOREVE ZHVILLUES

DORËZIM I PROPOZIM ANGZHIMEVE

Java e IV e Nëntorit 2023
Dorëzim i propozim angazhimeve praë Këshillit të PQH

Java e I e Dhjetorit 2023
Përcaktim i draft PA për PQH nga ana e Këshillit të PQH

Java e II e Dhjetorit 2023
Konsultim i draft PA për PQH

Java e III e Dhjetorit 2023
Ngjarje Publike

Java e II e Janarit 2024
Përcaktim i PA Final për PQ nga ana e Këshillit të PQH


SHKURT 2024
Miratim i PA për PQH 2024-2026 nga ana e Qeverisë së RMV-së

Bazuar në procedurë të parashikueshme dhe të rregulluar siç duhet të procesit të ko-krijimit në korrik 2023 në një ambient dinamik dhe inkluziv, filloi procesi i përgatitjes së Planit të gjashtë Nacional Aksional të Partneritetit për Qeverisje të Hapur për periudhën 2024-2026.

Gjatë përgatitjes së Planit Aksional për Parlament të Hapur 2024-2026, Kuvendi në përgjithësi e monitoroi kornizën kohore të përcaktuar për ko-krijim dhe aktivitetet i realizoi në mënyrë të harmonizuar me punën e Kuvendit dhe Vendimit për formimin e grupit punues për përgatitjen dhe miratimin e Planit Aksional të Kuvendit për 2024-2026 të Partneritetit për Qeverisje të Hapur, të miratuar nga ana e Kryetarit të Kuvendit të RMV-së. Sa i përket planit

që i referohet Gjyqësorit të Hapur, në ciklin e dytë të anëtarësimit të gjyqësorit në PQH, Këshilli për Gjyqësor të Hapur vendosi angazhimet nga plani aksional për Gjyqësorin e Hapur 2021-2023 që nuk janë realizuar në tërësi të zbatohen në Planin e ri Aksional për Gjyqësorin e Hapur 2024-2026.

Në kuadër të procesit të planifikimit dhe zbatimit të ko-krijimit të PNA6, në periudhën maj 2023 -dhjetor 2024, u zhvilluan:



PJESËMARRJE DHE PËRFQËSIM I PALËVE TË INTERESUARA NË PROCESIN E KO-KRIJIMIT

Përmes procesit të gjerë konsultativ dhe praktikave ekzistuese të përmirësuar bazuar edhe në përvojat nga planet e mëparshme aksionale të PQH-së, këshillat dhe rekomandimet nga Sekretariati i PQH-së, rekomandimet nga mekanizmi për njoftim të pavarur, propozimet kreative nga palët e interesuara dhe me përfshirja e drejtpërdrejtë të mbi 100 përfaqësuesve nga sektori qeveritar dhe sektori qytetar u përgatit draft plan nacional aksional i Partneritet për Qeverisje të Hapur për periudhën 2024-2026, në të cilin janë definuar 15 angazhime në 5 fusha prioritare për Qeveri të Hapur, 4 angazhime në pjesën Parlament i Hapur, dhe 6 angazhime në dy fusha prioritare në pjesën Gjyqësor i Hapur

PASQYRË PËRMBLEDHËSE E ANGAZHIMEVE SIPAS FUSHAVE PRIORITARE NË PNA 6

Qeveri e Hapur

FUSHA PRIORITARE	ANGAZHIME
1. LUFTA KUNDËR KORUPSIONIT	1.1 Përmirësim i transparencës së seancave qeveritare dhe mbledhjeve 1.2 Shpallje publike e emrave të pronarëve të vërtetë të firmave që kanë lidhur marrëveshje për prokurime publik, për koncesione (me Ministrinë e Ekonomisë) dhe për krijimin e partneritetit publiko privat. 1.3 Shpallje publike e marrëveshjeve të lidhura për koncesione dhe për krijimin e partneritetit publiko privat
2. PARTICIPIM NË VENDIMMARRJE DHE PJESËMARRJE QYTETARE	2.1 Pjesëmarrje e publikut në krijimin e masave aktive, politikave dhe shërbimeve të punësimit 2.2 Futja e trajnimit të detyrueshëm të nëpunësve administrativ për temat që lidhen me transparencën dhe llogaridhënien, luftën kundër korrupsionit, përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje etj. 2.3 Përmirësim i kualitetit të konsultimeve publike në nivel nacional 2.4 Publikim i rregullt dhe i vazhdueshëm i raporteve vjetore për mundësi të barabarta për meshkujt dhe femrat nga ana e ministrive dhe komunave 2.5 Përcaktim i metodologjisë për përzgjedhjen e mjeteve për e-konsultimet dhe përfshirjen me pjesëmarrje të qytetarëve në proceset e miratimit të vendimeve në komuna

	2.6 Përgatitje e planit për trajtim me ndryshimet në mjedisin jetësor që kanë ndikim në shëndetin e qytetarëve, me pjesëmarrjen e OJQ-ve.
3. FUQIZIM JURIDIK DHE QASJE NË DREJTËSI	3.1 Digjitalizim dhe përmirësim i sistemit për ndihmë juridike falas 3.2 Parandalim i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
4. ZHVILLIM DHE PËRDORIM I TEKNOLOGJIVE DIGJITALE	4.1 Digjitalizim i proceseve për njoftim financiar të partive politike 4.2 Digjitalizim i të dhënave, për promovimin e politikave lokale ekonomike
5. PROMOVIM I AKTIVITETEVE PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE	5.1 Pjesëmarrje efektive e publikut në vendimmarrje në fushën e drejtës së ujërave 5.2 Informim i rritur i qytetarëve për aktivitetet në institucionet lidhur me ndryshimet klimatike përmes promovimit të bashkëpunimit ndërsektorial ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

Parlament i Hapur

PARLAMENT I HAPUR	ANGAZHIME
	1. Regjistër i trupave rregullator të themeluara nga Kuvendi 2. Informim i publikut përmes kanalit televiziv të kuvendit 3. Debat mbikëqyrës në Kuvend për zbatimin e planit nacional PQH 2024-2026 4. Parlament karvan - mobil parlamentar për komunikim të drejtpërdrejtë të deputetëve me qytetarët

Gjyqësor i Hapur

FUSHA PRIORITARE	ANGAZHIME
1. QASJE NË INFORMACIONE DHE TË DHËNA	1.1 Përmirësim i portalit elektronik gjyqësor të RMV-së (www.sud.mk) 1.2 Përmirësim i marrëdhënieve me publikun të gjykatave 1.3 Përmirësim i kualitetit dhe disponueshmërisë së të dhënave dhe informacioneve për funksionimin e Këshillit Gjyqësor
2. PERFORMANCA	2.1 Përforsim i rolit mbikëqyrës të Këshillit Gjyqësor mbi transparencën e gjykatave 2.2 Përmirësim/unifikimi i strukturës së raporteve të gjykatave dhe cilësisë së të dhënave 2.3 Përmirësim i sistemit elektronik për trajnimin bazë dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve

SFIDA PQH

Gjatë vitit 2023, Komiteti Drejtues dhe Sekretariati për Mbështetje të PQH i bënë thirrje komunitetit të PQH-së që të drejtojnë idetë dhe energjinë e tyre në ndryshim të qëndrueshëm të politikave me qëllim adresimin e sfidave aktuale dhe të ardhshme. Në Strategjinë e PQH 2023-2028 janë identifikuar fushat e veprimit përmes të cilave shoqëritë mund të forcohen dhe komunitetet të përmirësohen, përkatësisht: qasja në informacione, antikorrupsioni, hapësira qytetare klima dhe mjedisi jetësor, qeverisja dixhitale, hapja fiskale, gjinia dhe përfshirja, drejtësia, liria e medimeve dhe pjesëmarrjen e publikut. Sipas strategjisë, gjatë pesë viteve të ardhshme, pritet që të gjithë anëtarët e Partneritetit të bashkëngjiten në "sfidën" për të ngritur ambicien për reforma në këto fusha dhe për të identifikuar angazhimet dhe përmes të cilave do të demonstron progresi përkatës. Është planifikuar që "reformatorët" më ambicioz do të njihen dhe promovohen në forume ndërkombëtare

dhe do të shërbejnë si histori frymëzuese, dhe vetë progresi të ndahet me komunitetin PQH në mbarë botën.

Duke pasur parasysh Strategjinë e PQH 2023-2028 dhe thirrjen për t'iu bashkuar sfidës së lartpërmendur, Këshilli i PQH gjatë procesit të ko-krijimit të PNA 6 vendosi t'i bashkohet kësaj thirrjeje dhe të identifikojë sfidë të përshtatshme. Nga angazhimet që janë pjesë e PNA 6, Këshilli i PQH vendosi që angazhimi “1.2 Shpallje publike e emrave të pronarëve të vërtetë të firmave që kanë lidhur marrëveshje për prokurime publik, për koncesione (me Ministrinë e Ekonomisë) dhe për krijimin e partneritetit publiko privat të shërbejë si përgjigje adekuate ndaj sfidës së paraqitur nga PQH.

Realizimi i këtij angazhimi si pjesë e PNA 6 pritet të mundësojë shpalljen publik të emrave të pronarëve përfundimtarë apo të vërtetë të firmave. Me shpalljen publike të emrit të pronarëve përfundimtarë apo të vërtetë të firmave, do të mundësohet kontrollimi i kryqëzuar i të dhënave nga disa baza të dhënash të disponueshme publikisht dhe në këtë mënyrë do të bëhet i mundur kontrollimi i plotë i personat e përzgjedhur dhe të emëruar - nëse fshihen pas firmave që marrin tenderë dhe koncesione, pra kontrata shtetërore duke përdorur pozicionin dhe funksionin në të cilin janë zgjedhur ose emëruar. Përdorimi i plotë i potencialit të këtyre të dhënave do të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit, domethënë mund të çojë jo vetëm në zbulimin e korrupsionit, por edhe më shumë në parandalimin e tij.

PLANI AKSIONAL I PARTNERITETIT PËR QEVERISJE TË HAPUR 2024-2026

– QEVERI E HAPUR –

Puna e qeverisë së hapur është angazhim i vazhdueshëm dhe ky plan aksional përmban pjesë nga të mundshmet por përpjekjet ambicioze për promovim të transparencës dhe llogaridhënies së QRMV.

Ky dokument e promovon hapjen dhe mundësinë për zhvillim të mëtutjeshëm dhe thellim të prioritetëve të mëposhtme në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë palët e interesuara në sferën e PQH.

I gjithë procesi i krijimit zbatimit dhe monitorimit është mbështetur nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Këshilli për PQH dhe Rrjetit për PQH.

Për këtë cikël të ko-krijimit, Këshilli i PQH- i ka përcaktuar pesë fushat prioritare dhe grupet e punës në pjesën e Qeverisjes së Hapur:

LUFTA KUNDËR KORUPSIONIT

PARTICIPIM NË VENDIMMARRJE DHE PJESËMARRJE QYTETARE

FUQIZIM JURIDIK DHE QASJE NË DREJTËSI

ZHVILLIM DHE PËRDORIM I TEKNOLOGJIVE DIGJITALE

PROMOVIM I AKTIVITETEVE PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Në procesin e ko-krijimit të planit të aksional në pjesën e Qeverisë së Hapur, nga puna e grupeve të punës dolën 24 ide të propozuara për angazhime. Pas mbajtjes së takimeve me institucionet për harmonizimin e ideve të propozuara dhe zbatimin e procesit konsultativ, Këshilli i PQH e miratoi tekstin final të PNA 6, në të cilin janë të përfshira 15 angazhime të propozuara dhe 57 arritje.

QEVERI E HAPUR

1. LUFTA KUNDËR KORUPSIONIT

Numri dhe emri i angazhimit	1.1 PËRMIRËSIM I TRANSPARENCËS SË SEANCAVE QEVERITARE DHE MBLEDHJEVE		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Qëllimi i angazhimit është përmirësimi i transparencës së seancave qeveritare dhe mbledhjeve, sepse qytetarët e vënë në dukje ekzistencën e rrezikut të lartë për korrupsioni lidhur me integritetin e Qeverisë gjatë marrjes së vendimeve, i cili do të reduktohej përmes rritjes së transparencës së seancave qeveritare dhe mbledhjeve të përfaqësuesve të qeverisë, gjegjësisht Kryetarit të QRMV-së dhe ministrave. Për këtë qëllim, është e nevojshme të sigurohet menaxhim dhe publikimi i detyrueshëm i kalendarit të takimeve të përfaqësuesve të qeverisë, gjegjësisht Kryetarit të QRMV-së dhe ministrave me informacion për personat me të cilët janë caktuar, përkatësisht takimeve të realizuara, dhe i cili do të jetë i disponueshëm dhe i përditësuar për të paktën shtatë ditë përpara, kohës së ngjarjes dhe temën. Gjithashtu, kalendar i takimeve duhet të shoqërohet me shënime, përkatësisht procesverbal të takimeve të zhvilluara, sipas rendi të unifikuar të përmbajtjes të vendosur më parë. Në drejtim të përmirësimit të transparencës së seancave qeveritare, është e nevojshme të publikohet kalendar (shpallje e seancave), përkatësisht të publikohet rendi i ditës së seancave qeveritare. Është e nevojshme, në drejtim të promovimit të transparencës së seancave, që rendi i ditës të publikohet të paktën shtatë ditë pune përpara mbajtjes së tij. Përveç faktit se këto aktivitete do të ndikojnë në promovimin e transparencës së Qeverisë, ato do të kontribuojnë edhe në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve, në përmirësimin e integritetit të Qeverisë, si dhe në uljen dhe çrrënjosjen e korrupsionit, i cili është i rëndësishëm thelbësor për rritjen e mbrojtjes së demokracisë, promovimin e barazisë dhe qeverisjes së mirë. Në fund, përmes kësaj qasjeje me shpalljen e kalendarëve të përfaqësuesve të qeverisë, vijuar me shënime nga mbledhjet, si dhe me publikimin paraprak të rendit të ditëve për seancat e qeverisë, do të rritet efikasiteti i punës i shërbimeve qeveritare ashtu edhe i Qeverisë pasi pritet të ulë vëllimi i kërkesave për qasje në informacion.		
Institucioni udhëheqës	Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut		
	Sektori publik	Sektori joqeveritar	Të tjerë (Parlamenti, sektori privat,

Mbështetje nga palët e interesuara			organizatat ndërkombëtare, etj.)
	/	Fondacioni Metamorfozis	/
Korniza kohore e angazhimit	mars 2024 – janar 2026		

Definim i problemit

1. Çfarë problemi adreson angazhimi?

Angazhimi i referohet rezikut t[detektuar të korrupsionit në lidhje me integritetin e Qeverisë në vendimmarrje, i cili do të reduktohej përmes rritjes së transparencës së seancave qeveritare dhe mbledhjeve. Në të njëjtën kohë do të rritej besimi i qytetarëve tek institucionet dhe funksioni i tyre mbikëqyrës si korrigjues kryesor i punës së pushtetit ekzekutiv. Indeksi Rajonal i Hapjes (https://metamorphosis.org.mk/izdaniya_arhiva/procenka-na-dobroto-vladeenje-vo-severna-makedonija-i-regionot-preku-indeksot-na-otvorenost-sobranie-i-izvrshna-vlast-merenje-za-2021/) për disa vite me radhë e thekson këtë problem që seancat qeveritare nuk shpallen me kohë me agjenda shoqëruese të paktën një ditë para mbajtjes së seancës, si dhe për shtatë vite me radhë paralajmëron se dokumentet që shqyrtohen dhe diskutohen gjatë seancave të qeverisë duhet të publikohen së bashku me rendin e ditës sipas praktikave ndërkombëtare.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Arsyeja kryesore e këtij problemi është se publiku nuk ka njohuri të plotë dhe në kohë mbi rendin e ditës (dhe dokumentet) apo informacionet që diskutohen dhe shqyrtohen gjatë seancave të qeverisë, për shkak të të cilit perceptimi i qytetarëve është se vendimet merren në mënyrë jo transparente dhe për arsye personale ose partiake. Vitet e fundit vërehet trend i vonësës së publikimit të agjendave dhe procesverbaleve të mbledhjeve të qeverisë në faqen e Qeverisë, ndërkohë që dokumentet apo informacionet që shqyrtohen apo diskutohen në seanca nuk janë bërë publike deri më tani.

Përshkrim i angazhimit

1. Çfarë është bërë deri më tani për të zgjidhur problemin?

Agjendat për seancat e ardhshme qeveritare publikohen në portalin e-Qeveria, i cili nuk është i disponueshëm për publikun e gjerë. Në kalendarin e web-faqes së Qeverisë publikohen informacionet për mbledhjet e kaluara dhe seancat qeverisë, por jo edhe për ato të ardhshmet. Gjithashtu, në web-faqen e Qeverisë publikohen me vonësë procesverbalet e seancave.

2. Çfarë zgjidhje propozoni?

Përmes zbatimit të angazhimit do të futet procedurë për futjen dhe publikimin e kalendarit në web faqen e QRMV-së në drejtim të transparencës më të madhe të punës së Qeverisë dhe rritjes së besimit të qytetarëve ndaj institucioneve. Procedura do të rregullojë procedurat në vijima: 1) Shpalljen e mbledhjeve të radhës të përfaqësuesve të qeverisë, Kryeministrit dhe ministrave, të paktën shtatë ditë përpara, me informacion të standardizuar për shpalljen; 2) Publikimi i informacionit nga mbledhjet sipas formati të standardizuar të procesverbaleve/shënimeve; dhe 3) Publikimi i seancave të ardhshme qeveritare me orarin e seancave shtatë ditë pune përpara, agjendë për seancën.

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Përmes krijimit dhe zbatimit të procedurës për mbajtjen dhe publikimin e kalendarit në web faqen e QRMV-së, synojmë të arrijmë transparencë më të madhe të punës së Qeverisë dhe në këtë mënyrë të rrisim rolin mbikëqyrës të sektorit civil dhe besimin e qytetarëve ndaj institucioneve.

Analizë e angazhimit	
Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë angazhimi transparencën?	Palët e interesuara para së gjithash do të kenë qasje në kohë dhe të plotë tek informacionet në lidhje me mbledhjet dhe seancat e përfaqësuesve të qeverisë, gjë që do t'u mundësojë atyre në kohë dhe të informuar ta ushtrojnë rolin e tyre si mbikëqyrës të punës së qeverisë dhe të reagojnë në përputhje me nevojën.
2. Si do të ndihmojë angazhimi në nxitjen e llogaridhënies?	Sigurimi publik i informacioneve lidhur me seancat qeveritare dhe mbledhjet, së bashku me dokumentet dhe procesverbalet, do t'i mundësojë publikut në kohë dhe i informuar të reagojë dhe të kërkojë përgjegjësi nga përfaqësuesit e qeverisë nëse ka (mos)miratim të dokumenteve të diskutueshme ose informacioneve që shkojnë kundër interesave të qytetarëve.
3. Si do të përmirësojë angazhimi pjesëmarrjen e qytetarëve në definimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	Angazhimi ka si qëllim kryesor të ofrojë procedurë për informimin e vazhdueshëm dhe në kohë të palëve të interesuara për seancat qeveritare dhe mbledhjet, përmes së cilës publiku do të jetë në gjendje në kohë dhe i informuar të reagojë dhe të kërkojë përgjegjësi nga ana e përfaqësuesve të qeverisë nëse ka (jo) miratim të dokumenteve apo informacioneve të kontestuara, të cilat janë në kundërshtim me interesat e qytetarëve. Në këtë mënyrë qytetarët bëhen më të vetëdijshëm dhe më të

	informuar për punën e Qeverisë duke kuptuar rendin dhe informacionet që procesohen në seancat qeveritare dhe mbledhjet.
--	---

Planifikimi i angazhimeve				
Arritjet	Rezultatet e pritura	Data e pritshme e përfundimit	Palët e interesuara	
1.1.1 Përgatitja e procedurës për mbajtjen dhe publikimin e kalendarit në web-faqen e QRMV-së, e cila i rregullon komponentët e mëposhtëm: - Publikimi i mbledhjeve të ardhshme të përfaqësuesve të qeverisë të paktën shtatë ditë përpara, me informacion të standardizuar për shpalljen; - Publikimi i informacionit nga mbledhjet sipas formati të standardizuar të procesverbaleve/shënimeve brenda 5 ditëve pune pas mbajtjes së mbledhjeve; - Publikimi i seancave të ardhshme qeveritare me orarin e seancave shtatë ditë pune përpara, së bashku me rendin e ditës së seancës.	Përgatitja e procedurës për mbajtjen dhe publikimin e kalendarit në web-faqen e QRMV-së, e cila i rregullon komponentët e mëposhtëm: - Publikimi i mbledhjeve të ardhshme të përfaqësuesve të qeverisë të paktën shtatë ditë përpara, me informacion të standardizuar për shpalljen; - Publikimi i informacionit nga mbledhjet sipas formati të standardizuar të procesverbaleve/shënimeve brenda 5 ditëve pune pas mbajtjes së mbledhjeve. - Publikimi i seancave të ardhshme të qeverisë me orarin e seancave shtatë ditë pune përpara,	Dhjetor 2024	Institucioni udhëheqës: SP i QRMV-së	
			Mbështetje	
			Spektori Publik	HBO Të tjerë
			SP i QRMV-së	Fondacioni Metamorfozis /

	së bashku me rendin e ditës së seancës.				
1.1.2 Zbatimi i procedurës për mbajtjen dhe publikimin e kalendarit në web- faqen e QRMV-së.	Zbatimi i procedurës për mbajtjen dhe publikimin e kalendarit në web- faqen e QRMV-së.	janar, 2026	SP i QRMV-së	/	/

Numri dhe Emri i angazhimit	1.2 SHPALLJE PUBLIKE E EMRAVE TË PRONARËVE TË VËRTETË TË FIRMAVE-OFRUESVE TË FIRMAVE QË KANË LIDHUR MARRËVESHJE PËR PROKURIMET PUBLIKE, PËR KONCESIONET (PREJ MINISTRISË SË EKONOMISË,) DHE PËR KRIJIMIN E PARTNERITETIT PUBLIKO PRIVAT
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Që nga viti 2019, RMV-ja krijoi Regjistrën të Pronarëve të Vërtetë. Këta regjistra filluan të krijoheshin pasi u zbulua se shumë persona të ekspozuar-politik zotërojnë “fshehurazi” firma që përdorin para publike (shtetërore). Informacionet për pronarët e vërtetë u bë menjëherë një nga mjetet më të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit. Sigurimi i aksesit të lehtë dhe të gjerë në këto informacione është mënyra më efektive për t'u mundësuar të gjithë përdoruesve përkatës – nga institucionet për zbatimin të ligjit tek gazetarët hulumtues dhe organizatat e qytetare – që të jenë në gjendje ti përdorin informacionet në luftën kundër korrupsionit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për firmat që marrin mjete publike dhe për të cilat informacionet se kush i posedon dhe kontrollon kompanitë janë thelbësor për mbikëqyrjen dhe përgjegjshmërinë. Sot, pavarësisht vendimit të fundit të Gjykatës Evropiane, këto regjistra janë të disponueshëm publikisht në një të tretën e shteteve anëtare të BE-së dhe në shumë vende të tjera anembanë botës. Ky është gjithashtu një kusht i vendosur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore (BB) për dhënien e ndihmës financiare vendeve (siç përdor edhe RMV-ja). Shpallja publike e emrave të pronarëve të vërtetë është gjithashtu pjesë e rezolutës së Kombeve të Bashkuara për këtë çështje. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të dhëna të tilla të jenë më në fund të disponueshme për publikun edhe në vendin tonë, ku krahasuar me të gjitha vendet e BE-së ku këto regjistra janë publikisht, ka dukshëm më shumë korrupsion, pra një nevojë edhe më e madhe për këto informacione. Angazhimi ka të bëjë me mundësimin e disponueshmërisë publike të të dhënave për pronarët e vërtetë, në radhë të parë, për firmat që përdorin mjete publike, përkatësisht kanë lidhur marrëveshje për prokurimet publik, për koncesione për eksploatimin e burimeve minerale, marrëveshje për koncesionin e hulumtimit të detajuar gjeologjike, si dhe ato me marrëveshje të lidhura për krijimin e PPP-ve. Gjithashtu, në drejtim të mbrojtjes edhe më të madhe nga

	korrupsioni dhe në përputhje me trendet botërore në këtë sferë, angazhimi parashikon publikimin e emrave të pronarëve të vërtetë dhe të kompanive ofertuese në procedurat e prokurimeve publik.		
Institucioni udhëheqës	(Kabineti i Zëvendës kryeministrit përgjegjës për politikën e qeverisjes së mirë)		
Mbështetje nga palët e interesuara	Spektori publik	Spektori joqeveritar	Të tjera (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare, etj.)
	MF, Ministria e Ekonomisë, Byroja e Prokurimeve Publike dhe RQRMV	QKQ	/
Korniza kohore për angazhimin	maj 2024 - dhjetor 2025		

Definimi i problemit

1. Çfarë problemi adreson angazhimi??

Ekzistojnë shumë shembuj të individëve të korrumpuar që e shfrytëzojnë jotransparencën e strukturave të pronësisë së firmave, qoftë për të lidhur apo për të fituar marrëveshje me institucionet shtetërore duke i favorizuar firmat në të cilat ata kanë interes të caktuar. Të dhënat oficiale nga bota thonë se në 70 % të rasteve të korrupsionit të lartë janë të përfshira kompani me pronarë anonimë (për të cilat ka pasur raste të shumta në vendin tonë, para se të zbuloheshin në hetimet e Prokurorisë Speciale dhe gazetarëve hulumtues). Mungesa e transparencës në pronësinë aktuale të personave juridike jo vetëm që kontribuon në korrupsion, por gjithashtu pengon seriozisht hetimet dhe aftësinë për të gjurmuar, ngrirë dhe konfiskuar pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme dhe zbatimin e ligjit. Tek prokurimet publike, individë të korrumpuar mund të përpiqen ta shfrytëzojnë jotransparencën e strukturave të pronësisë për të fituar tenderë, duke favorizuar kompanitë në të cilat kanë interes të fshehur. Përkundrazi, duke mundësuar transparencën e pronësisë, autoritetet dhe të gjithë palët e tjera të interesuara do të mund ti zbulojnë pronarët e vërtetë që qëndrojnë pas ofertuesve të tenderit, dhe nga ana tjetër, do të jetë më e vështirë për zyrtarët e korrumpuar të manipulojnë procesin e prokurimeve për qëllime personale. Transparenca e tillë e inkurajon konkurrencën e ndershme dhe i dekurajon akterët e korrumpuar nga përdorimi i strukturave komplekse të pronësisë për të fshehur përfshirjen e tyre në marrëveshje. Përveç kësaj, kombinimi i transparencës së pronësisë dhe prokurimeve publikë e përmirëson përgjegjshmërinë e përgjithshme të procesit të prokurimeve, duke mundësuar identifikimin e konflikteve të mundshme të interesit dhe duke siguruar që marrëveshjet jepen në bazë të meritës dhe jo nëpërmjet favorizimit apo rryshfetit.

2. Cilat janë arsyet e problemit? Transparenca e pamjaftueshme në pronësinë faktike të personave juridike lë hapësirë për aktivitete korruptive gjatë lidhjes së marrëveshjeve për prokurimet publike, për koncesionet për eksploatimin e burimeve minerale, marrëveshjeve për koncesion të hulumtive të detajuara gjeologjike, si dhe ato me marrëveshje të lidhura për krijimin e PPP.

Përshkrim i angazhimit 1. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit? Me disa aktivitete të mëvonshme të kryera gjatë viteve të fundit, janë krijuar parakushtet për zgjidhjen përfundimtare të problemit të përmendur. Së pari, në Sistemin e vetëm Elektronik për Prokurime Publike (SEPP) detyrimisht publikohen të gjitha marrëveshjet e lidhura për prokurimet publike (dhe anekset e tyre). Më pas, edhe në SEPP, në Njoftimin e marrëveshjes së lidhur, publikohen jo vetëm emrat e firmave me të cilat është lidhur marrëveshja e prokurimit publik, por edhe të të gjitha firmave që kanë marrë pjesë në prokurim. Gjithashtu, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka krijuar dhe në mënyrë publike e publikon Regjistrin e personave të zgjedhur dhe të emëruar. Por të gjitha këto dhe zgjidhje të tjera janë vetëm të pjesshme dhe nuk e realizojnë plotësisht idenë e tyre - të jenë një mjet i fuqishëm për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit. Ajo që mungon janë të dhënat e disponueshme publike për pronësinë e firmave për të kryqëzuar të gjitha këto të dhëna dhe për të parandaluar keqpërdorimin e mjeteve publike. Me Planin e kaluar Aksional të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur 2021-2023 (PNA për PQH) është bërë përpjekje për të nisur me këtë proces me miratimin e angazhim për të publikuar emrat e pronarëve të vërtetë të firmave që fituan marrëveshje për prokurim publik. Për fat të keq, angazhimi, edhe pse i njohur si një nga më të mirët në mbarë botën nga ana e Sekretariatit të PQH, nuk u zbatua kryesisht për shkak të aspekteve që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale. Duke pasur parasysh se përpjekjet për realizimin e angazhimit nuk kanë të ndalur, tani po tentohet që të lejohet kohë shtesë për ndryshimet e gjoja të nevojshme ligjore në mënyrë që angazhimi të realizohet, por përfshin edhe marrëveshje të ngjashme të prokurimeve publike, si koncesionet dhe marrëveshjet për krijimin e PPP. 2. Çfarë zgjidhje propozoni? Me shpalljen publike të propozuar të emrit të vërtetë, përkatësisht të pronarëve përfundimtarë të firmave, do të mundësohet kontrollimi i kryqëzuar i të dhënave nga disa baza të dhënash të disponueshme publikisht dhe në këtë mënyrë do të bëhet i mundur kontrollimi i plotë i personave të përzgjedhur dhe të emëruar - nëse janë të fshehur nga firmat që marrin tenderë dhe koncesione, përkatësisht marrëveshje shtetërore duke përdorur pozicionin dhe funksionin në të cilin janë zgjedhur ose emëruar. Megjithatë, problemi do të zgjidhet vetëm pjesërisht, sepse në vend gjithashtu nuk janë të disponueshme as të dhënat për pronarët e regjistruar të firmave, kështu që Maqedonia e Veriut është në mesin e 15 vendeve në botë në të cilat paguhet tarifë për marrjen e këtij informacion rreth firmave (informacion që nga tetori 2023, UNODC). Për këtë ka pasur angazhim edhe në të kaluarën, me të cilën janë bërë publike disa të dhëna të caktuara bazë për firmën, madje as emrin e pronarëve të firmave, siç ndodh pothuajse në të gjitha vendet e botës. Ky vazhdon mbetet problem për zbardhjen e plotë të lidhjes së firmës dhe për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit, i cili duhet të zgjidhet në të ardhmen. Me mosdisponueshmërinë publike të këtyre të dhënave, në një mënyrë

bëhet i mundur korrupsioni sepse pengohet zbulimi i tij, gjë që do të ndodhte nëse këto të dhëna do të ishin publike.

Gjithashtu, si problemi mbetet edhe ajo se të gjitha këto të dhëna nuk janë në formën e të dhënave të hapura dhe me këtë përdorimi i tyre mbetet i vështirë, gjë që funksionon vetëm në favor të të korrupsionarëve.

Në afat të shkurtër, të dhënat edhe për pronësinë ashtu edhe për pronësinë përfituese të firmave duhet të bëhen plotësisht të disponueshme për publikun për të mundësuar përdorimin më të gjerë të tyre (p.sh. lidhja me të dhënat mbi pronën, gjykimet, etj.). Ka shembuj të suksesshëm të këtij përdorimi të të dhënave në Francë, Mbretërinë e Bashkuar, Kenia, Malajzi, Ukrainë, etj.

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Me shpalljen publike të emrave të pronarëve përfundimtarë apo të vërtetë të firmave, do të mundësohet shfrytëzimi i plotë i potencialit të këtyre të dhënave në luftën kundër korrupsionit dhe krimit. Do të thotë, ajo do të mundësojë verifikimin e të dhënave nga regjistrat e lartpërmendur dhe bazat e të dhënave të disponueshme publikisht, të cilat mund të çojnë jo vetëm në zbulimin e korrupsionit, por edhe më shumë në parandalimin e tij. Besohet se vetë fakti që këto të dhëna do të jenë në dispozicion të publikut do t'i pengojë ata që synojnë të keqpërdorin mjetet publike për ta bërë këtë, pasi shanset për t'u zbuluar do të rriten.

Analiza e Angazhimit	
Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë transparencën angazhimi?	Angazhimi në thelb do të nënkuptojë hapjen historike të të dhënave nga Regjistri i Pronarëve të Vërtetë, i cili tashmë është i disponueshëm vetëm përmes procedure zyrtare dhe pagesës së tarifës. Me zbatimin e angazhimit, këto të dhëna do të jenë të hapura publikisht, gjë që do t'i bëjë lehtësisht të aksesueshme për të gjithë të interesuarit, si qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, mediat etj.
2. Si do të ndihmojë angazhimi në nxitjen e llogaridhënies?	Transparenca e emrave të përdoruesve fundorë të personave juridik do t'u mundësojë organizatave të shoqërisë qytetare, mediave, qytetarëve dhe të gjithë palëve të tjera të interesuara që të rrisin mbikëqyrjen mbi institucionet publike dhe në këtë mënyrë presionin për funksionim më të përgjegjshëm. Në këtë mënyrë jo vetëm që do të zbulohen abuzimet e mundshme politike në përdorimin e parasë publike për përfitime private, por do të ndërmerren veprime për të parandaluar të tilla në të ardhmen, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e përgjegjësisë së institucioneve publike në shpenzimin e parasë publike.
3. Si do të përmirësojë angazhimi pjesëmarrjen e qytetarëve në	Duke pasur informacione dhe mbikëqyrje të vazhdueshme se cilët janë pronarët e vërtetë, gjegjësisht përdoruesit përfundimtarë të firmave, me të dhëna të tjera të

definimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	rëndësishme në dispozicion njëkohësisht, si - kush i merr tenderët dhe koncesionet, do t'u mundësojë qytetarëve të përfshihen më intensivisht në luftën kundër korrupsionit. Në këtë mënyrë, qytetarët, në vend që të jenë vetëm vëzhgues pasivë dhe pjesë e problemit, do të mund të luajnë rolin e tyre shoqëror si palë aktive në luftën kundër korrupsionit dhe mbrojtjen e mjeteve të tyre pronësore.
--	--

Planifikim i angazhimit					
<i>Arritjet</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Data e pritshme e përfundimit</i>	<i>Palët e interesuara</i>		
<i>1.2.1 Detektim i parakushteve të nevojshme për shpalljen publike të emrave të pronarëve të vërtetë, me afat të mundshëm kohor të realizimit.</i>	Është hartuar listë me të gjitha parakushtet dhe afat kohor për zbatimin e angazhimit	maj 2024	Institucioni udhëheqës: Kabineti i Zëvendës Kryetarit të Qeverisë Përgjegjës për Politikat e Qeverisjes së Mirë		
			<u>Mbështetje</u>		
			Sektori Publik	HBO	Të tjerë
			Kabineti i Zëvendës kryetarit të Qeverisë përgjegjës për politikat e qeverisjes së mirë MF, Ministria e Ekonomisë, Byroja e Prokurimeve Publike, Regjistri Qendror, dhe Drejtoria për Zbulim Financiar	QKQ	/
<i>1.2.2 Zbatimi i parakushteve të detektuara për shpalljen publike të</i>	Janë zbatuar parakushte të nevojshme për zbatimin e	Dhjetor 2024	Kabineti i Zëvendës kryetarit të Qeverisë	QKQ	/

<i>emrave të pronarëve të vërtetë të firmave-ofertuese dhe të firmave me marrëveshje të lidhura për prokurime publik, koncesione dhe PPP</i>	angazhimit		përgjegjës për politikat e qeverisjes së mirë MF, Ministria e Ekonomisë, Byroja e Prokurimeve Publike, RQRMV dhe Drejtoria për Zbulim Financiar		
<i>1.2.3 Shpallja publike e emrave të pronarëve të vërtetë të firmave ofertuese dhe të firmave me marrëveshje të lidhura për prokurime publike, koncesione dhe PPP.</i>	Të dhënat për pronarët përfundimtarë të firmave që kanë lidhur marrëveshje për prokurime publike, për koncesione për burime minerale dhe për krijimin e PPP janë të disponueshme në publik	maj 2025	Kabineti i Zëvendës kryetarit të Qeverisë përgjegjës për politikat e qeverisjes së mirë Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Byroja e Prokurimeve Publike, Regjistri Qendror dhe Drejtoria për Zbulim Financiar	QKQ	/

Numri dhe emri i angazhimit	1.3 SHPALLJE PUBLIKE E MARRËVESHJEVE TË LIDHURA PËR KONCESIONE DHE PËR KRIJIMIN E PARTNERITETIT PUBLIKO PRIVAT
------------------------------------	---

Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Angazhimi nënkupton shpalljen e detyrueshme publike të marrëveshjeve të lidhura për koncesione dhe për krijimin e (PPP), siq janë të disponueshme edhe marrëveshjet për prokurimet publik. Koncesionet, prokurimet publike dhe PPP janë tre llojet bazë të marrëveshjeve publike të institucioneve shtetërore me sektorin privat. Edhe pse në vendin tonë, këto tre lloje marrëveshjesh publike nuk janë ende të unifikuara në kuptimin që procedurat për lidhjen e tyre menaxhohen nga një vend i centralizuar, siç është për shembull Sistemi Elektronik i Prokurimeve Publike (SEPP), ato janë ende marrëveshje të lidhura. Prandaj, është e nevojshme siq janë të disponueshme marrëveshjet për prokurimet publike, të sigurohet e njëjta transparencë për marrëveshjet për koncesione dhe për PPP, Për sa i përket koncesioneve, të paktën gjatë realizimit të këtij angazhimi, nënkuptohet në marrëveshjet për koncesion për eksploatimin e burimeve minerale dhe marrëveshjeve për koncesione për hulumtime të detajuara gjeologjike të lidhura nga Ministria e Ekonomisë. Angazhimi ka të bëjë me shpalljen publike të këtyre marrëveshjeve në web-faqen e kësaj ministrie. Në lidhje me marrëveshjet për krijimin e PPP-së, angazhimi i referohet publikimit të marrëveshjeve në kuadër të SEPP-. Konkretisht, në SEPP publikohen shpalljet për themelimin e PPP-ve. Sipas shembullit të prokurimeve publike, angazhimi nënkupton të publikohen edhe marrëveshjet e lidhura për PPP në pjesën e "dokumenteve", veçmas për secilën marrëveshje të lidhur. Në këtë mënyrë, edhe pse angazhimi i mbulon ministritë, komunat si dhe ndërmarrjet publike dhe shtetërore të krijuara prej tyre, në fakt e mbulon vetëm Byronë e Prokurimeve Publike sepse institucionet e përmendura duhet t'i dorëzojnë pranë SEPP-së për publikim marrëveshjet e lidhura (siq atë e bëjnë me marrëveshjet e prokurimeve publike).		
Institucioni udhëheqës	Ministria e Ekonomisë		
Mbështetje nga palët e interesuara	Spektori publik	Spektori joqeveritar	Të tjerë (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare, etj.)
	<i>Byroja e Prokurimeve Publike (MF), (Kabineti i Zëvendës kryetarit të Qeverisë përgjegjës për politikën e qeverisjes së mirë), komunat, ndërmarrjet publike dhe shtetërore</i>	<i>QKQ</i>	<i>/</i>

Korniza kohore e angazhimit	shkurt 2024 – janar 2026
--	--------------------------

Definimi i problemit
1. Çfarë problemi adreson angazhimi? Edhe pse i përkasin të njëjtit grup marrëveshjet ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve të sektorit publik, marrëveshjet për koncesione dhe për PPP nuk publikohen siç është rasti me marrëveshjet e prokurimeve publike. Me këtë, për një sektor të rëndësishëm, i cili ndër të tjera është edhe ndër më të ndjeshëm ndaj korrupsionit, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, gazetarët, madje edhe institucionet shtetërore që kanë nevojë për këtë informacion, nuk kanë akses në detajet e asaj që është rënë dakord, sidomos rreth obligimeve të koncesionarëve. Nga ana tjetër, janë të shumtë shembujt e abuzimeve me këto marrëveshje. Me atë se marrëveshjet janë të padisponueshme jo vetëm që e pamundëson monitorimin e zbatimit të tyre në mënyrë adekuate, por në një farë mënyre e mbështet edhe korrupsionin sepse mbahen në sekret informacione të tilla të rëndësishme. Edhe pse ekziston obligim në bazë të Strategjisë Nacionale për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2021-2025, marrëveshjet për koncesione nuk shpallen publikisht. I njëjtë është rasti edhe me marrëveshjet për krijimin e PPP. Për të dyja llojet e marrëveshjeve, në opinion mbizotëron mendimi se ato janë përgjithësisht të korruptuara, gjë që i kufizon investimet e mundshme të mëtejshme të sektorit të biznesit nëpërmjet këtyre dy llojeve të marrëveshjeve. Në ndryshim nga Maqedonia e Veriut, në botë, pikërisht koncesionet dhe PPP-të janë instrument i rëndësishëm për tërheqjen e investimeve të huaja dhe për zhvillimin ekonomik, duke kontribuar 2 deri në 3 pikë përqindje në rritjen vjetore të prodhimit të brendshëm bruto të vendeve.
2. Cilat janë shkaqet e problemit? Duket se në themel të problemit qëndron faktori njerëzor, përkatësisht mungesa e vullnetit për publikimin e këtyre marrëveshjeve. Konkretisht, Ministria e Ekonomisë edhe tani publikon dokument në format të mbyllur pdf për koncesionet e dhëna për burimet minerale, me të dhënat bazë për rreth 370 koncesione të tilla si: emri i koncesionarit, adresa, e-mail, kohëzgjatja e marrëveshjes, data e lidhjes së marrëveshjes, lënda e parë, lokaliteti i koncesionit, komuna në të cilën ndodhet dhe sipërfaqja e mbuluar në kilometra katrorë. Megjithatë, ndër të dhënat e publikuara publikisht nuk ka të dhëna për kompensimin e paguar për sipërfaqen koncesionare, qoftë kompensimi fiks për kilometër katror, qoftë ai variabël, për sasinë e lëndës së parë të shfrytëzuar. Gjithashtu, nuk dihen kushtet që i ka koncesionari me marrëveshjen për koncesion, gjë që i bën këto marrëveshje krejtësisht të pamundura për çdo lloj inspektimi apo kontrolli publik në zbatimin e tyre. Situata është e ngjashme me marrëveshjet për krijimin e PPP. Në SEPP publikohen konkurset për marrëveshjet e tilla, por jo informacione për marrëveshjet e lidhura dhe as vetë marrëveshjet, megjithëse bëhet fjalë vetëm për disa në vit.

Përshkrim i angazhimit
1. Çfarë është bërë deri më tani për të zgjidhur problemin?

Siç është theksuar, edhe pse në domenin e prokurimeve publike, gradualisht rritet transparenca dhe disponueshmëria për publikun e numri të madh të informacioneve dhe dokumenteve lidhur me tenderat, ky trend nuk u ndoq edhe për dy llojet e tjera të marrëveshjeve, siç janë koncesionet dhe PPP, nese behet fjale per marrëveshje te ngjashme. Pjesërisht për këtë, por edhe për shkak të rregulloreve të vjetruara, në të dyja fushat nuk janë shfrytëzuar potencialet e plota që ofrojnë, veçanërisht për tërheqjen e investimeve dhe për zhvillimin ekonomik, jo vetëm në nivel nacional, por edhe brenda mjediseve lokale. Ka pasur përpjekje për përmirësimin e situatës me iniciativa të tjera, por edhe ato ishin të pasuksesshme. Sa i përket koncesioneve, si rezultat i angazhimi në Planin Aksional për PQH 2016-2018, në web-faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë publikohet regjistër i koncesioneve për burimet minerale, por në të nuk përfshihen marrëveshjet e lidhura. Sa i përket PPP-ve, në SEPP publikohen vetëm kokurset për marrëveshjet e tilla dhe dokumentet e tenderit, por kjo mundësi nuk përdoret për të publikuar, në të njëjtin vend, edhe njoftimet për marrëveshjet e lidhura, si dhe për vetë marrëveshjet, siç është rasti me prokurimet publike.

2. Çfarë zgjidhje propozoni?

Për sa i përket PPP-ve, problemi do të zgjidhet plotësisht, sepse do të përdoret mundësia ekzistuese - në SEPP të publikohen marrëveshjet e lidhura për PPP në, në pjesë ku edhe tani publikohen informacione për PPP-të, siq janë konkursi dhe dokumentacioni i tenderit. .

Për koncesionet kjo është vetëm një zgjidhje e pjesshme, pasi marrëveshjez do të publikohen në web-faqen e Ministrisë së Ekonomisë, ku publikohen informacionet bazë për koncesionet. Pjesërisht, sepse për koncesionet është e nevojshme që në të ardhmen t'i qasemi zgjidhjeje plotësisht elektronike, siç është SEPP, dhe sepse nuk mbulohen të gjitha koncesionet, por vetëm ato për burimet minerale dhe eksploatim. Por publikimi i këtyre marrëveshjeve koncesionare do të nënkuptojë hap të parë drejt transparencës së marrëveshjeve të tjera koncesionare të lidhura edhe nga institucione të tjera, të cilat mund të vijojnë në PNA-në e radhës për PQH-në.

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Angazhimi në thelb do të nënkuptojë rrumbullakim të transparencës të marrëveshjeve publike (prokurimeve publike, koncesioneve, PPP-ve), që cila është e rëndësie të madhe për të mundësuar mbikëqyrjen publike të këtyre marrëveshjeve dhe verifikimin publik nëse ato e mbrojnë interesin publik. Të gjitha këto marrëveshje janë ndër më të ndjeshmet ndaj korrupsionit dhe kjo do të mundësojë zbulimin, por edhe parandalimin e tij, me rolin e drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile. Me angazhimi në thelb do të vazhdojnë përpjekjet e Ministrisë së Ekonomisë për rritjen e transparencës së koncesioneve të dhëna.

Analizë e angazhimit	
Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë angazhimi transparençën?	Me angazhimin arrihet progres i dukshëm në transparençë në sferën e koncesioneve dhe PPP. Angazhimi për shpalljen publike të këtyre marrëveshjeve është në përputhje me masat e parashikuara në Strategjinë Nacionale për Parandalimin e Korrupsionit

	dhe Konfliktit të Interesit 2021-2025, si dhe me rekomandimet e Entit Shtetëror të Revizionit në Raportin e Revizionit të kryer të Buxhetit Bazë të RMV-së për vitin 2022, me qëllim që edhe komunat ti kenë marrëveshjet për koncesione të dhëna për territoret e tyre.
2. Si do të ndihmojë angazhimi në nxitjen e llogaridhënies?	Duke qenë se marrëveshjet për koncesione dhe për PPP do të vihen në dispozicion dhe në mbikëqyrje të publikut dhe të gjithë grupeve të interesuara, do të rritet ndjeshëm llogaridhënia e institucioneve publike. Kështu, angazhimi do të kontribuojë edhe në rritjen e besimit tek institucionet publike edhe nga ana e publikut dhe investitorëve potencialë në këto dy fusha, të cilat tashmë po ndodhin ende nën vallon e jotransparencës dhe dyshimeve për korrupsion.
3. Si do të përmirësojë angazhimi pjesëmarrjen e qytetarëve në definimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	Duke i pasur detajet e marrëveshjeve, veçanërisht për aspektet financiare dhe të tjera dhe kushtet në të cilat është dhënë koncesioni, qytetarët mund të vlerësojnë nëse marrëveshja është e mirë apo e keqe për resurset publike, siq janë burimet minerale, apo nëse dhe si është mbrojtur interesi publik në marrëveshjet për PPP. Duke ditur këtë, qytetarët mund edhe ti parandalojnë marrëveshjet eventuale të dëmshme, që nënkupton pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë në përmirësimin e situatës.

Planifikim i angazhimit					
<i>Arritjet</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Data e pritshme e përfundimit</i>	<i>Palët e interesuara</i>		
1.3.1 Koordinim dhe marrëveshje për mënyrën e zbatimit të angazhimit dhe të parakushteve të nevojshme teknike për atë	U arrit marrëveshje dhe zgjidhje teknike specifike për publikimin e marrëveshjeve për koncesione në web-faqen e Ministrisë së Ekonomisë dhe për PPP të SEPP.	Maj 2024	Institucioni udhëheqës: Ministria e Ekonomisë		
			<u>Mbështetje</u>		
			Spektori Publik	HBO	Të tjerë
			Ministria e Ekonomisë, Byroja e Prokurimeve Publike (MF)	QKQ	/
1.3.2 Shpallja publike e marrëveshjeve për koncesione dhe për	Marrëveshjet publikisht shpallen	Shkurt 2025	Byroja e Prokurimeve Publike	QKQ	/

krijimin e PPP			(MF) Ministria e Ekonomisë,		
----------------	--	--	-----------------------------------	--	--

2. PARTICIPIM NË VENDIMMARRJE DHE PJESEMARRJE QYTETARE

Numri dhe emri i angazhimit	2.1 PJESEMARRJE E PUBLIKUT NË KRIJIMIN E MASAVE AKTIVE, POLITIKAVE DHE SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Angazhimi ka për qëllim ti theksojë proceset egzistuese, praktikatat dhe politikatat të APRMV për konsultim të palëve të interesuara (të papunë, biznese, OJQ dhe institucione të tjera) përpara krijimit dhe miratimit të planit vjetor operacional për masat aktive, politikatat dhe shërbimet e punësimit, si dhe gjatë zbatimit të tij. Gjithashtu, angazhimi ka për qëllim standardizimin dhe zgjerimin e këtyre proceseve, praktikave dhe politikave, në atë mënyrë që të gjithë palët e interesuarit do të kenë mundësi ti japin sugjerime e tyre të informuara gjatë planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të planit operativ vjetor të punësimeve. Gjithashtu, angazhimi do të kontribuojë në krijimin e bazës së palëve të interesuara, të cilët do të marrin vazhdimisht informacione për mundësitë e përfshirjes dhe në fund do të kenë mundësinë të japin propozimet e tyre për përmirësimin e efikasitetit dhe ekonomisë së politikaveaktive, masave dhe shërbimeve të punësimit. Ky angazhim paraqet vazhdimësi të përpjekjeve për përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes në punën e APRMV-së të filluar në Planin Aksional të mëparshme për PQH 2021-2023. Ajo që është e rëndësishme të theksohet është se APRMV publikon informacione mbi zbatimin e planeve operative vjetore, të cilat do t'u mundësojnë palëve të interesuara të përfshihen në mënyrë të informuar dhe të ofrojnë propozimin e tyre për përmirësimin e masave, politikave dhe shërbimeve të punësimit. - Në thelb, angazhimi do të thotë shumë më tepër sesa thjesht mbledhja e propozimeve nga grupet e synuara dhe e njejta është vendosur në disa nivele, përkatësisht: - Niveli i parë, i referohet promovimit të politikave, proceseve dhe praktikave të APRMV-së për përfshirjen e palëve të interesuara, duke krijuar grup të gjerë palësh të interesuara (qytetarë të papunë, OJQ që punojnë për çështje të ndryshme, biznese, akademi, etj.) në afat të gjatë do të ofrojnë input për krijimin e Planit Vjetor operativ më të mirë, dhe krijimin e rrjeti dhe kapacitetesh lokale ndërmjet 30 njësive rajonale të APRMV për mobilizimin dhe përfshirjen e popullatës lokale të papunë dhe palëve të interesuara në ofrimin e të dhënave përpara krijimit të Planit Vjetor Operacional. - Niveli i dytë i referohet krijimit të zgjidhjeve teknike për mbledhjen e propozimeve nga publiku i gjerë (ato që nuk mbulohen nga niveli i parë)

	përpara miratimit të Planit Vjetor Operacional dhe vlerësimit të zbatimit të planit të miratuar. - Niveli i tretë i referohet promovimit dhe vënies në funksion të të gjithë sistemit.		
Institucioni udhëheqës	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale		
Mbështetje nga palët e interesuara	Spektori publik	Spektori joqeveritar	Të tjerë (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare, etj.)
	APRMV	(ESE)	/
Korniza kohore e angazhimit	1 shkurt 2024 – 31 janar 2026		

Definim i problemit
1. Çfarë problemi adreson angazhimi? Agjencia e punësimit ka praktikë të krijuar për konsultimin e sektorit të biznesit dhe organizatave të shoqërisë civile. Megjithatë, procesi i konsultimit dhe mënyra e përfshirjes së palëve të interesuara nuk janë të disponueshme për publikun, gjë që përsëri e kufizon mundësinë për të gjithë ata që nuk janë të ftuar drejtpërdrejt, por janë të interesuar, të sigurojnë kontributin e tyre në procesin e vendimmarrjes. Gjithashtu, të papunët, si një nga përdoruesit kryesorë të programeve dhe shërbimeve të punësimit, përveç komunikimit të përditshëm me të punësuarit, nuk kanë mundësi në mënyrë të organizuar të ofrojnë propozimet e tyre për përmirësimin e të njejtëve. Gjithashtu, gjatë zbatimit të planit të pestë aksional për PQH, u krijua grup punues i përbërë nga përfaqësues të MPPS, APRMV, ESE dhe tre organizata lokale të shoqërisë qytetare por gjithsesi ky grup punues kishte për qëllim vetëm koordinimin e aktiviteteve në kuadër të planit të pestë aksional, por është e rëndësishme që ne të përfaqësojmë grup kyç për konsultime përpara se të krijojmë planet vjetore operative.
2. Cilat janë shkaqet e problemit? Shkaku kryesor për këtë problem është se publiku nuk është i informuar për mundësitë ekzistuese për përfshirje, për shkak të mungesës së informacionit të disponueshëm publikisht për mënyrën dhe mundësitë e përfshirjes, si dhe mungesën e kanali publik për paraqitjen e propozimeve dhe zgjidhjeve.

Përshkrim i angazhimit

1. Çfarë është bërë deri më tani për të zgjidhur problemin?

Agjencia për Punësim dhe ESE, me mbështetjen e QRMV-së gjatë viteve 2021-2023, zhvilluan dhe publikuan platformë që gjeneron në mënyrë aktive informacione për shkallën e shfrytëzimit të mjeteve nga plani aktual vjetor operativ i masave aktive, politikave dhe shërbimeve të punësimit, si dhe informacione për përfshirjen e personave/bizneseve me secilin prej tyre. Gjithashtu, APRMV publikon një sërë treguesish statistikorë dhe financiarë që u japin mundësi të gjithë të interesuarve të kryejnë analizë të pavarur të funksionalitetit të masave, politikave dhe shërbimeve. Në të njëjtën periudhë, APRMV dhe ESE zhvilluan pyetësor të standardizuar për të vlerësuar nivelin e kënaqësisë me masat, politikat dhe shërbimet e punësimit dhe të njëjtin e pilotuan në tre njësi rajonale të Agjencisë.

Gjithashtu, gjatë zbatimit të planit të pestë aksional për PQH, u krijua grup pune i përbërë nga përfaqësues të MPPS, APRMV, ESE dhe tre OJQ vendore, por gjithsesi ky grup pune kishte për qëllim vetëm koordinimin e aktiviteteve në kuadër të planit të pestë aksional, por është e rëndësishme për ne që të përfaqësojmë grup kyç për konsultime përpara se të krijojmë planet vjetore operative.

2. Çfarë zgjidhje propozoni?

Nëpërmjet zbatimit të angazhimit do të përgatitet procedurë për përfshirjen e palëve të interesuara që do të jetë e disponueshme për publikun (mënyra, afatet kohore, kriteret etj.), do të identifikohen dhe përfshihen palët e tjera të interesuara dhe do të zhvillohet mundësi për paraqitjen elektronike dhe përpunimin e propozimeve.

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Krijimi i rocedurës për konsultime dhe grumbullim të propozimeve nga palët e interesuara për krijimin e masave, politikave dhe shërbimeve të punësimit në bazë të nevojave të tyre.

Analizë e angazhimit

Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë angazhimi transparencën?	Palët e interesuara para së gjithash do të kenë qasje në informacione për propozimin e planit operativ vjetor para miratimit të tij dhe aksesit në informacione për zbatimin e planeve të mëparshme. Keto informacione do t'u mundësojë atyre të mënyrë të informuar të përfshihen në diskutim dhe të propozojnë zgjidhje konkrete dhe efikase që do të ndihmojnë APRMV të miratojë plan bazuar në nevojat e përdoruesve përfundimtarë.
2. Si do të ndihmojë angazhimi në nxitjen e llogaridhënies?	Propozimet e pranuar do të jenë të disponueshme për publikun, dhe përsëri publiku do të informohet paraprakisht për kriteret për përzgjedhjen e rëndësisë së

	propozimeve. Gjithashtu, për çdo propozim të pranuar do të jepet informacion nëse dhe si është pranuar (sipas kriterëve) dhe nëse nuk pranohet, cila është arsyeja e mospranimit të tij.
3. Si do të përmirësojë angazhimi pjesëmarrjen e qytetarëve në definimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	Angazhimi ka si qëllim kryesor ofrimin e kanali për komunikim të vazhdueshëm me palët e interesuara, përmes standardizimit të procedurës së konsultimit dhe hapjes së mundësive për dorëzim elektronik të propozimeve.

Планирање на заложбата					
<i>Arritjet</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Data e pritshme e përfundimit</i>	<i>Palët e interesuara</i>		
2.1.1 Përgatitja e procedurës për mbledhjen e propozimeve dhe realizimin e konsultimit publik përpara miratimit të Planit Vjetor Operativ të masave, programeve dhe shërbimeve aktive për punësim.	Procedurë e përgatitur dhe e publikuar	shtator, 2024	Institucioni udhëheqës: ABPCM		
			<u>Mbështetje</u>		
			Spektori Publik	HBO	Të tjerë
			APRMV, MPPS	ESE	/
2.1.2 Krijimi i baze të OJQ-ve, akademive, biznesit, të papunëve, të cilët kanë interes të konsultohen nga ana e APRMV-së, dhe MPPS-së përpara përgatitjes dhe miratimit të Planit Vjetor Operacional.	Bazë e krijuar	shtator, 2024	APRMV, MPPS	ESE	/
2.1.3 Zhvillimi i një pjesë peri konsultime në faqen e APRMV-së.	Një pjesë e zhvilluar për konsultime në faqen e internetit të APRMV-së	dhjetor, 2024	APRMV, MPPS	ESE	/

2.1.4 Vënia e procedurës dhe pjesës për konsultimi në funksion gjatë miratimit të Planit Vjetor Operacional për vitin 2026.	U realizua raund konsultimesh dhe përfshiu propozime në Planin Vjetor Operacional 2026	dhjetor 2025	APRMV, MPPS	ESE	/
---	--	--------------	-------------	-----	---

Numri dhe emri i angazhimit	2.2 FUTJA E TRAJNIMIT TË DETYRUESHËM TË NËPUNËSVE ADMINISTRATIV PER TEMAT QË LIDHEN ME TRANSPARENCËN DHE LLOGARIDHËNIEN, LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT, PËRFSHIRJEN E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE ETJ.				
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Angazhimi ka për qëllim të kontribuojë në përmirësimin e programeve të rregullta vjetore për trajnime gjenerike të nëpunësve administrativë, si dhe të trajnimeve të specializuara që janë të disponueshme në sistemin e të mësuarit të MSHIA - (LMS). Në këtë mënyrë, nëpunësve administrativë (në nivel nacional dhe lokal) do t'u mundësohet të mësojnë dhe të marrin njohuri të vazhdueshme përmes trajnimeve për tema që kanë të bëjnë me transparencën dhe llogaridhënie, luftën kundër korrupsionit, përfshirjen e qytetarëve në vendimarrje etj. Ky angazhim, përveç përmirësimit të njohurive, synon edhe ndërtimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe MSHIA-së në drejtim të ndarjes dhe shfrytëzimit të burimeve të përhershme për mësim të përbashkët, ndërtim të aftësive dhe bashkëpunim. Në këtë drejtim, trajnimet e përhershme të ofruara nga ana e organizatave të shoqërisë civile në fushat e interesit do të përshtaten dhe do të vihen në dispozicion për ngritjen e vazhdueshme të aftësive të nëpunësve administrativë, përmes sistemit elektronik të menaxhimit të mësimi (LMS), do të obligohen të gjithë nëpunësit administrativë një herë në vit të kalojnë me sukses trajnimet e zhvilluara në lidhje me temat me interes për këtë angazhim përmes dhe duke u obliguar nga Qeveritë për ti ndjekur ato trajnime dhe në fund për të marrë certifikatë - të posedojë certifikatë se ka kryer me sukses trajnimet e përcaktuara që do të rrjedhin nga ky angazhim.				
Institucioni udhëheqës	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës				
Mbështetje nga palët e interesuara	Spektori publik	Spektori joqeveritar	Të tjerë (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare, etj.)		
	/	(ESE)	/		

Korniza kohore e angazhimit	1 shkurt 2024 – 31 janar 2026
------------------------------------	-------------------------------

Definim i problemit
1. Çfarë problemi adreson angazhimi? Problem kryesor i cili adresohet përmes këtij angazhimi është kapaciteti i ulët i nëpunësve publikë për njohjen, raportimin dhe veprimin në rastet e korrupsionit; kapacitetet e ulëta të nëpunësve publikë për identifikimin dhe ndarjen e informacioneve dhe të dhënave me publikun; dhe kapacitetet e ulëta për krijimin e mekanizmave për komunikim të vazhdueshëm me grupet e synuara. 2. Cilat janë shkaqet e problemit? Arsyeja e këtij problemi është se nëpunësit publikë nuk kanë obligim të ndjekin trajnime për këto tema. Përveç rregulloreve nacionale, nëpunësit publikë nuk kanë mundësi në një vend të gjejnë informacione përkatëse, literaturë, shembuj, mjete, etj. të cilat mund t'i ndihmojnë ata në ngritjen e njohurive të tyre.

Përshkrim i angazhimit
1. Çfarë është bërë deri më tani për të zgjidhur problemin? Në kuadër të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës ekziston Akademia për përkrrerje profesional të nëpunësve administrativë, e cila organizon trajnime për forcimin e kapaciteteve të nëpunësve publikë. Gjithashtu, çdo vit, pas propozimit të nëpunësve publikë dhe vlerësimit të Ministrisë, përgatitet program vjetor për trajnime për nëpunësit publik me tema të ndryshme, si: strategjitë, programet, komunikimin, sigurinë kibernetike etj. Trajnimet zhvillohen përmes portalit të mësimit elektronik LMS. Gjatë vitit 2023, MSHIA realizoi procedurë për përmirësimin e funksionalitetit të këtij portali. Një pjesë e nëpunësve publikë në periudhën e kaluar kanë pasur mundësinë të ndjekin trajnime lidhur me korrupsionin, qasjen në informacione, përfshirjen e qytetarëve, të cilat janë organizuar nga institucionet relevante apo OQ. Kjo qasje nuk lejon që të përfshihen të gjithë të punësuarit dhe ata që ishin të përfshirë të kishin mundësi të përmirësonin njohuritë e tyre në këto fusha. 2. Çfarë zgjidhje propozoni? Me qëllim që të mundësohet që të gjithë nëpunësit publikë të kenë akses në përmbajtje, materiale dhe trajnime për tema që kanë të bëjnë me korrupsionin, aksesin në informacione dhe përfshirje të qytetarëve, si dhe për të mundësuar rinovimin e vazhdueshëm e njohurive të tyre, ky angazhim do të mundësojë përmirësimin e sistemit elektronik të të mësuarit me përmbajtje nga fushat e mësipërme që do të jenë vazhdimisht të disponueshme dhe të përditësuara me informacione dhe përmbajtjen më të fundit. Gjithashtu, këto trajnime do të jenë të detyrueshme për të gjithë nëpunësit publikë dhe të njejtë do të gjenerojnë certifikatë që do të jetë kyç në matjen e performancës së tyre. 3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Funksionimi i sektorit publik si ofrues i shërbimeve për qytetarët dhe komunitetin e biznesit përfaqëson pjesën më të madhe të çdo shoqërie. Pa përmirësimin e vazhdueshëm të tij, përkatësisht modernizimin, nuk është i mundur zhvillimi i përgjithshëm i vendit. Prandaj, bazën e veprimit të çdo qeverie, përveç politikave dhe strategjive, e përbën edhe administrata eksperte, profesionale. Njohuritë dhe aftësitë e nëpunësve, përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit duhet të sigurojnë shërbim efikas për qytetarët. Me zhvillimin e shpejtë të shoqërisë dhe përmes digjitalizimit rriten edhe pritshmëritë e qytetarëve nga puna e administratës. Gjithashtu, kapaciteti administrativ është parakusht për dorëzimin e obligimeve të dakorduara në Bashkimin Evropian. Prandaj është i nevojshëm përmirësimi i burimeve njerëzore dhe performanca e tyre, që është detyrë parësore e zhvillimit profesional. Përveç profesionalizmit të nëpunësve, përkushtimi i tyre ndaj vlerave të larta si etika, integriteti, përgjegjësia, efikasiteti, profesionalizmi dhe përshtatshmëria gjenerojnë besim dhe siguri mes qytetarëve dhe komunitetit të biznesit.

Në këtë drejtim, trajnimet e përhershme të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile në fushat e interesit do të përshtaten dhe do të vihen në dispozicion për ngritjen e vazhdueshme të aftësive të nëpunësve administrativë, përmes sistemit elektronik (LMS), do të jepen udhëzime dhe duke u obliguar nga Qeveria për ti ndjekur ato trajnime dhe në fund për të marrë certifikatë - të posedojë certifikatë se ka kryer me sukses trajnimet e përcaktuara që do të rezultojnë nga ky angazhim.

Analizë e angazhimit	
Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë angazhimi transparencën?	Informacionet, materialet, shembujt, praktika pozitive dhe mjetet që do t'u prezantohen gjatë trajnimeve do të kontribuojnë në përmirësimin e ndërgjegjësimit të nëpunësve publikë për kuptimin, rëndësinë dhe mundësitë për përmirësimin e transparencës së institucionit në të cilin ata punojnë.
2. Si do të ndihmojë angazhimi në nxitjen e llogaridhënies?	Informacionet, materialet, shembujt, praktika pozitive dhe mjetet që do t'u prezantohen gjatë trajnimeve do të kontribuojnë në përmirësimin e ndërgjegjësimit të nëpunësve publikë për kuptimin, rëndësinë dhe mundësitë për përmirësimin e përgjegjësisë së institucionit në të cilin ata punojnë.
3. Si do të përmirësojë angazhimi pjesëmarrjen e qytetarëve në definimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	Informacionet, materialet, shembujt, praktika pozitive dhe mjetet që do t'u prezantohen gjatë trajnimeve do të kontribuojnë në përmirësimin e ndërgjegjësimit të nëpunësve publikë për kuptimin, rëndësinë dhe mundësitë për komunikim dhe konsultime me publikun para miratimit të vendimeve thelbësore

Planifikimi i angazhimeve					
<i>Arritjet</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Data e pritshme e përfundimit</i>	<i>Palët e interesuara</i>		
2.2.1 Nënshkrim i memorandumit për bashkëpunim ndërmjet MSHIA-së dhe ESE	Memorandum për bashkëpunim i nënshkruar	maj, 2024	Institucioni udhëheqës MSHIA		
			<u>Mbështetje</u>		
			Spektori Publik	HBO	Të tjerë
			MSHIA	ESE	/
2.2.2 Identifikimi i temave me rëndësi për ngritjen e aftësive të nëpunësve administrativë në fushën e transparencës, llogaridhënies, korrupsionit, qeverisjes së mirë, pjesëmarrjes qytetare etj. (shembull: publikimi proaktiv i informacioneve, ofrimi i informacioneve në procedurë për akses të lirë në informacione publike, si të njohish dhe parandalosh korrupsionin, cilat janë përfitimet e përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe cilat janë mekanizmat që mund të zbatoni, etj.	Lista e përgatitur e temave. Standardet e zhvilluara (teknike dhe përmbajtësore) që trajnimi duhet ti përmbushë. Kriteret e zhvilluara për përzgjedhjen e materialeve të emësimin (pika vijuese)	qershor 2024	Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë deri te Informacionet me karakter publik, KSHPK, dhe të tjerë	Shoqata ESE dhe OJQ të tjera që do të shprehin interes për përfshirje	/

2.2.3 Thirrje publike për mbledhjen e materialeve për e-mësim të cilët janë zhvilluar dhe zbatuar nga ana e shoqërisë civile dhe organizata të tjera në fushën e transparencës, llogaridhënies, korrupsionit, qeverisjes së mirë, pjesëmarrjes civile etj.	Mblodhi të paktën tre propozime	shtator 2024	MSHIA	ESE	/
2.2.4 Vlerësim dhe përzgjedhje e materialeve të marra.	Selektuar të paktën nga 1 material/ aktvednim për e-mësim për secilën temë	Tetor 2024	MSHIA	ESE	/
2.2.5 Vendosja e materialeve që duhet të jenë në Maqedonisht, Shqip dhe Anglisht në platformën LMS	Vendosur të paktën nga një trajnim nga çdo fushë të LMS	Dhjetor 2024	MSHIA	/	/
2.2.6 Qeveriatë marrë vendim për ndjekjen e detyrueshme të këtyre trajnimeve në nivel vjetor dhe posedimin e certifikate)	Është marrë vendim për mbajtje të detyrueshme të trajnimeve	Dhjetor 2024	Qeveria	/	/
2.2.7 Futje në programin për trajnime - trajnime të nëpunësve administrativë	Janë futur të gjitha trajnimet e vendosura të LMS në programin për trajnime	Dhjetor 2024 dhe 2025	MSHIA	/	/
2.2.8 Njoftim i të gjithë nëpunësve administrativë për disponueshmërinë e trajnimeve dhe	Është dërguar njoftim tek të gjithë nëpunësit administrativë	janar 2025	MSHIA	/	/

nevojën për t'i kaluar ato.					
2.2.9 Realizim i trajnimeve	60 _____ % e nëpunësve administrativë kanë marrë certifikat për trajnimin e kaluar	janar 2026	MSHIA	/	/

Numri dhe emri i angazhimit	2.3 PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË KONSULTIMEVE PUBLIKE NË NIVEL NACIONAL				
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Pjesëmarrja në kohë dhe thelbësore e qytetarëve në krijimin e politikave është parakusht që një shoqëri demokratike të njihet si transparente dhe e përgjegjshme, prandaj edhe qëllimi i angazhimit është përmirësimi i cilësisë së konsultimeve publike. Konkluzioni i përgjithshëm është se sistemi elektronik për konsultime publike (ENER) nuk është përdorur në potencialin e tij të plotë, dhe kontrolli i cilësisë dhe monitorimi i procesit të konsultimit publik duhet të përmirësohet. Për këtë qëllim, duhet të aplikohet praktika e krijimit dhe publikimit të planeve vjetore për konsultime së bashku me kornizë kohore në drejtim të përfshirjes më të madhe të palëve të interesuara në procese dhe vendosjes së kontrollit të cilësisë së konsultimeve publike (institucionet duhet të japin informacione kthyes nga konsultimet, përkatësisht të krijohen procesverbale nga proceset konsultative, si aktivitet vijues me arsyetim pse disa propozime pranohen ose nuk pranohen). Gjithashtu, duhet të sigurohet promovim dhe edukim më i madh i popullatës për ENER në kuadër të përfshirjes më të madhe të tyre me kontributin e tyre në rregullore të ndryshme. Për të lehtësuar informimin e qytetarëve dhe përfshirjen në politikëbërje, të gjitha web-faqet shtetërore duhet të kenë pjesë të veçantë me informacionet e nevojshëm për proceset e konsultimit (plani i konsultimit, njoftimi për debatin publik, procesverbalet, dokumentet për të cilat diskutohet etj.) në lidhje direkte me ENER.				
Institucioni udhëheqës	Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut				
Mbështetje nga palët e interesuara	Sektori publik	Sektori joqeveritar		Të tjerë (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare, etj.)	
	(MSHIA) Ministria	Fondacioni Metamorfozis		/	

Korniza kohore e angazhimit	dhjetor 2024 – dhjetor 2025
-----------------------------------	-----------------------------

Definim i problemit
1. Çfarë problemi adreson angazhimi? Angazhimi adreson mungesën e pjesëmarrjes thelbësore të qytetarëve në krijimin e politikave si parakusht për ndërtimin e një shoqërie demokratike transparente dhe të përgjegjshme, për shkak të mungesës së informacioneve të qartë, të rregullta dhe në kohë për kanalet zyrtare të komunikimit të institucioneve publike. Po ashtu, perceptimi i qytetarëve është se konsultimet publike realizohen në mënyrë jo transparente dhe të paplanifikuara, për çka u zvogëlohet besimi tek institucionet dhe për më tepër u lind dyshimi se disa nga politikat dhe ligjet miratohen formalisht për shkak të përmbushjes së standardeve ndërkombëtare, duke mos i kushtuar vëmendje kontekstit lokal, ose rreptësisht për të mirën e individëve ose grupeve të caktuara. Në të njëjtën kohë, platforma ENER mbetet e pashfrytëzuar me kapacitet të plotë si platformë për konsultime publike online për shkak të mungesës së informacionit të qytetarëve për të njëjtën, si dhe cilësisë së ulët të reagimeve të marra nga përdoruesit e saj. <u>Numri i komenteve për ENER-in</u> e thekson nevojën për rritjen e informimit të qytetarëve për mundësitë që i ofron ENER dhe para së gjithash, ngritjen e besimit se komentimi i ENER-it mund të ndikojë realisht në përmbajtjen e propozim-ligjeve.
2. Cilat janë shkaqet e problemit? Shkaku kryesor për këtë problem është ai se publiku nuk është i informuar mjaftueshëm, rregullisht dhe sistematikisht për procesin e konsultimeve publike, si dhe për mundësitë ekzistuese dhe mënyrat për përfshirjen e tyre, prandaj politikat kyçe miratohen pa kontribut thelbësor nga të gjitha palët e interesuara, nevojat e të cilëve duhet të plotësohen nëpërmjet tyre. Asnjë institucion në vend nuk përgatit dhe nuk publikon plane vjetore për konsultime së bashku me kornizë kohore indikative, në mënyrë që palët kryesore të interesuara të përgatiten në kohë për të marrë pjesë në to. Gjithashtu, institucionet publikojnë informacione në mënyrë jo të rregullt në kohë, të qarta dhe transparente në lidhje me konsultimet që i realizojnë publikun, si dhe mënyrat përmes të cilave publiku mund të përfshihet, dhe janë të pakta institucionet që publikojnë procesverbalet pas konsultimeve me arsyetime për propozimet që janë shqyrtuar, pranuar ose nuk janë pranuar. Njëkohësisht, platforma ENER përdoret zakonisht nga ekspertët, odat ekonomike dhe një pjesë e përfaqësuesve të sektorit civil të cilët sipas aktivitetit të tyre e ndjekin zhvillimin e politikave të ndryshme dhe kanë njohuri për përdorimin e kësaj platforme, ndërkohë që qytetarët dhe organizatat më të vogla të shoqërisë civile që punojnë në nivel lokal dhe janë në kontakt të drejtpërdrejtë me kategori të ndryshme qytetarësh, nevojat e të cilëve duhet të merren parasysh përmes politikave publike, mbeten të përjashtuara nga i gjithë procesi për shkak të mungesës së informacionit për platformën dhe mundësitë që ajo ofron. Ata palë të interesuara që e përdorin ENER janë më tej të dekurajuar

nga përdorimi i kësaj platforme, sepse ata nuk marrin gjithmonë komente për kontributin e tyre në reagimet e tyre, dhe në rastet kur ata marrin, informacioni është i përgjithshëm ose i pakuptueshëm.

Përshkrim i angazhimit

1. Çfarë është bërë deri më tani për të zgjidhur problemin?

Përpjekjet e deritanishme bazohen në publikimin në ENER tabelën në disa nga web-faqet e internetit të institucioneve publike, dhe disa prej tyre në njoftimet e tyre për konsultime publike lënë link në ENER që të çon në dokumentin që është objekt konsultimi. Institucione të caktuara, pas përfundimit të konsultimeve publike, publikojnë lajm të shkurtër për konsultimin publik, por pa specifikuar propozimet që janë diskutuar gjatë konsultimit, si dhe arsyet e pranimet apo mospranimet të propozimeve apo komenteve të caktuara nga palët e interesuara.

2. Çfarë zgjidhje propozoni?

Nëpërmjet zbatimit të angazhimit do të përgatitet procedurë për përmirësimin e cilësisë së konsultimeve publike në nivel nacional, e cila do të përfshijë 1) krijimin dhe publikimin e planeve vjetore për konsultime (emri i dokumentit, korniza kohor për përgatitjen e dokumentit, mënyra dhe korniza kohore për konsultime publike, etj.), së bashku me tiplejt të unifikuar për hartimin e planeve; 2) vendosjen e kontrollit të cilësisë së konsultimeve publike përmes krijimit të procesverbaleve të unifikuara të proceseve të konsultimit (të dhëna për konsultimet dhe link tek dokumenti që është objekt konsultimi, të pranishmit në konsultim, listë të propozimeve të dhëna me arsyetim për ato që janë aprovuar ose nuk janë aprovuar). Gjithashtu, përmes zbatimit të angazhimit, do të krijohet dhe zbatohet plan për promovimin dhe edukimin e popullatës për ENER në drejtim të përfshirjes më të madhe të tyre me kontributin e tyre në rregullore të ndryshme.

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Vendosjen e procedurës për përmirësimin e cilësisë së konsultimeve publike në nivel nacional dhe krijimi dhe zbatimin e planit për promovimin dhe edukimin e popullatës për ENER në drejtim të përfshirjes më të madhe të tyre me kontributin e tyre në rregullore të ndryshme.

Analizë e angazhimit

Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë angazhimi transparencën?	Palët e interesuara para së gjithash do të kenë akses në informacionet në lidhje me konsultimet publike që planifikohen dhe zbatohen në nivel nacional, gjë që do t'i lejojë ata të përfshihen në kohë në mënyrë të informuar në diskutime dhe të japin propozimet e tyre specifike të bazuar në nevojat e tyre si përdorues.
2. Si do të ndihmojë angazhimi në nxitjen e llogaridhënies?	Korniza kohore për konsultime publike si dhe propozimet e marra me arsyet në bazë të të cilave janë pranuar apo nuk

	janë pranuar do të jenë të disponueshme në mënyrë publike në kanalet zyrtare të institucioneve publike, gjë që do t'i mundësojë publikut të kërkojë përgjegjësi nga palët e interesuara nëse ka është ka përpjekje të pabazuara për mospranimin e propozimi të caktuar.
3. Si do të përmirësojë angazhimi pjesëmarrjen e qytetarëve në definimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	Angazhimi ka për qëllim kryesor të ofrojë udhëzime dhe mekanizma për informimin e vazhdueshëm të palëve të interesuara përmes krijimit të plane vjetore për konsultime publike, duke standardizuar procesverbalet e konsultimeve publike dhe duke vendosur plan afatgjatë për promovimin e vazhdueshëm dhe edukimin e publikut për mundësinë e përdorimit të ENER për konsultime publike.

Planifikimi i angazhimit					
<i>Arritjet</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Data e pritshme e përfundimit</i>	<i>Palët e interesuara</i>		
2.3.1 Përgatitje e procedurës për krijimin dhe publikimin e planeve vjetore për konsultime, së bashku me templejt të unifikuar për përgatitjen e planeve.	Procedurë e përgatitur dhe e miratuar	dhjetor, 2024	Institucioni udhëheqës: SP i QRMV-së		
			<u>Mbështetje</u>		
			Spektori Publik	HBO	Të tjerë
			SP i QRMV, MSHIA, Ministrinë	Fondacioni Metamorfozis	/
2.3.2 Përgatitja e templejti të standardizuar për procesverbalet e proceseve konsultative.	Templejt i përgatitur dhe i miratuar.	shtator, 2025	SP i QRMV, MSHIA, Ministrinë	Fondacioni Metamorfozis	/
2.3.3 Krijimi i plani për promovimin dhe edukimin e popullatës për ENER në drejtim të përfshirjes më të madhe të tyre me kontributin e tyre në rregullore të ndryshme	Plan i krijuar.	dhjetor, 2025	SP i QRMV, MSHIA, Ministrinë	Fondacioni Metamorfozis	/

2.3.4 Realizimin e plani për promovimin dhe edukimin e popullatës për ENER në drejtim të përfshirjes më të madhe të tyre me kontributin e tyre në rregullore të ndryshme.	Një cikël i planit është realizuar.	dhjetor, 2025	SP i QRMV, MSHIA, Ministritë	Fondacioni Metamorfozis	/
---	-------------------------------------	---------------	------------------------------	-------------------------	---

Numri dhe emri i angazhimit	2.4 PUBLIKIM I RREGULLT DHE I VAZHDUESHËM I RAPORTEVE VJETORE PËR MUNDËSI TË BARABARTA PËR MESHKUJT DHE FEMRAT NGA ANA E MINISTRIVE DHE KOMUNAVE		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Raportet vjetore për barazinë gjinore i përgatisin edhe ministritë dhe komunat si obligim i tyre ligjor, por megjithatë të nuk janë në dispozicion të publikut në mënyrë që ti përdorin qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe të mund të monitorojmë punën e bërë. Aktualisht, pothuajse asnjë nga ministritë apo komunat nuk i shpall publikisht raportet e tilla		
Institucioni udhëheqës	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale		
Mbështetje nga palët e interesuara	Spektori publik	Spektori joqeveritar	Të tjerë (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare, etj.)
	Ministritë dhe komunat	Koalicioni Rural	/
Korniza kohore e angazhimit	mars 2024- janar 2026		

Definimi i problemit
1. Çfarë problemi adreson angazhimi? Vetëm gjysma e komunave dorëzojnë raporte për mundësi të barabarta në MPPS në baza vjetore. Pothuajse asnjë komunë nuk i publikon raportet e këtilla në web-faqen e saj të internetit dhe nuk përdor mekanizëm dhe ndonjë mjet tjetër për të informuar publikun e gjerë për

aktivitetet e ndërmarra në fushën e përmirësimit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në nivel lokal. Në nivel nacional gjendja nuk është shumë më e mirë, kështu që edhe ministrat nuk i publikojnë raportet për mundësi të barabarta, kështu që qytetarët dhe organizatat civile dhe vetë institucionet nuk janë mjaftueshëm të informuar për aktivitetet që ndërmerren në këtë fushë të jetës sociale. E gjithë kjo shpesh kontribuon në krijimin joadekuat të masave, politikave, programeve që duhet të kontribuojnë në avancimin e barazisë gjinore në nivel nacional dhe lokal.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Barazia gjinore për fat të keq nuk është vendosur si prioritet te institucionet nacionale dhe vetëqeverisja lokale, për të marrë vendime të informuara se si të avancohet barazia gjinore, por edhe si të merren parasysh nevojat specifike të kategorive të ndryshme të qytetarëve. Përgatitja dhe shpërndarja e raporteve vjetore është obligim ligjor sipas Ligjit për mundësi të barabarta, por i njëjti nuk praktikohet nga ana e institucioneve. Obligimi i tillë është definuar në nenin 12 të ligjit, por edhe promovimi i konceptit të barazisë gjinore në nivel institucional është një nga prioritetet strategjike të Qeverisë, ndërsa në drejtim të kontributit të shtetit në realizimin e qëllimit për zhvillimi të qëndrueshem nr. 5-Barazia gjinore nga qëllimet dhe agjenda për zhvillim të qëndrueshëm 2030. Gjithashtu, në këtë periudhë, shteti është në proces të hartimit dhe miratimit të Ligjit të ri për Barazi Gjinore, i cili edhe më shumë duhet ti forcojë obligimet e institucioneve në drejtim të promovimit të barazisë gjinore, dhe në të njëjtën kohë edhe të njoftojnë për punën e bërë në këtë temë. Përmes njoftimit, sipas Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, mundësohet informimi i publikut të gjerë për situatën aktuale, por edhe u jepen informacione qytetarëve, të cilët mund t'i përdorin më tej për të marrë pjesë në proceset konsultative dhe në proceset e vendimmarrjes, si në nivel nacional, ashtu dhe në nivel lokal. (Raport vjetor mbi aktivitetet e ndërmarra dhe progresin e arritur në krijimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në RMV, 2022, MPPS).

Përshkrim i angazhimit

1. Çfarë është bërë deri më tani për të zgjidhur problemin?

Obligimi ligjor është vendosur në Ligjin për Mundësi të Barabarta, por nuk i njëjti respektohet nga ana e të gjitha ministrive dhe nga ana e disa komunave. Përkatesisht, në vitin 2022, 73 komuna kanë dorëzuar raport vjetor për mundësi të barabarta, por as gjysma e tyre nuk kanë ndërmarrë aktivitete reale për promovimin e mundësive të barabarta në nivel lokal dhe as ato raporte nuk mund të lexohen publikisht në web-faqe apo kanale të tjera komunikimi të komunave përveçse nëse kërkohet përmes Kërkese për qasje të lirë në informacione të karakterit publik. Ndër organet e administratës shtetërore, vetëm 33 prej tyre kanë paraqitur raport të tillë, dhe sipas hulumtimit të Koalicionit Rural, konkretisht në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, më shumë se 90 % e mbi 500 të anketuarve nuk e njohin koordinatoren për mundësi të barabarta në Ministrinë e Bujqësisë, as nuk ka të dhëna lehtësisht të disponueshme për rolin e tij, kompetencat. Gjithashtu, konkretisht për këtë ministri

thuhet se nuk ka dorëzuar raport për mundësi të barabarta në MPPS për vitin 2022, ndaj nuk mund të shihet se si ka qenë situata me gratë në mjediset rurale për vitin 2022 në mënyrë që qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesuara të mund të kenë informacionin e nevojshëm për të ditur se si dhe në cilin fushë dhe me çfarë propozimesh të përfshihen në proceset vendimmarrëse.

2. Çfarë zgjidhje propozoni?

Arsyetimi për këtë angazhim është më i madh nëse merret parasysh se trupat ndërkombëtare për monitorimin e zbatimit të standardeve për të drejtat njerëzore të grave, siq janë Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave pranë Kombeve të Bashkuara KB, vazhdimisht theksojnë nevojën për veprime parandaluese nga shteti. Nevoja për intensifikimin dhe diversifikimin e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes publike është theksuar edhe në raportin e parë vlerësues të RMV-së të Grupit të ekspertëve të Këshillit të Evropës për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje nga GREVIO, trupi për monitorimin e zbatimit të Konventës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të Këshillit të Evropës (Konventa e Stambollit).

Përshkrim i angazhimit

1. Çfarë është bërë deri më tani për të zgjidhur problemin?

Qasja e deritanishme e shtetit ishte kryesisht deklarative dhe konsistonte në miratimin e strategjive, politikave dhe ligjeve pa sigurimin e parakushteve të nevojshme për zbatimin e tyre në praktikë. Edhe pse parandalimi i dhunës në familje, d.m.th nevoja për të ndërmarrë aktivitete për informimin e publikut dhe edukimin e praktikuesve nga institucionet kompetente, njihet si një nga fushat prioritare të veprimit në politikat dhe ligjet në fushën e barazisë gjinore, dhunës ndaj grave dhe në familje, megjithatë mungon zbatimi efektiv i synimeve, masave dhe aktiviteteve të planifikuara në këtë fushë. Aq më tepër që nuk zbatohen as obligimet e qarta ligjore për sigurimin e mjeteve financiare nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje, i arsyetuar më herët.

Përpjekjet e deritanishme në fushën e ngritjes së vetëdijes publike dhe edukimit të praktikantëve janë ndërmarrë kryesisht me iniciativën e organizatave ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile, të cilat deklarativisht janë mbështetur nga ministritë dhe institucionet kompetente. Megjithatë, mbulimi i kufizuar i popullsisë me këto fushata (veçanërisht popullsia nga zonat rurale) dhe varësia e tyre nga mbështetja e donatorëve reflekton drejtpërdrejt në ndikimin që ato kanë në nivel nacional.

2. Çfarë zgjidhje propozoni?

Planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve gjithëpërfshirëse parandaluese nga ana e ministrive dhe institucionet kompetente të përfshira në sistemin e mbrojtjes nga dhuna në familje do të kontribuojë drejtpërdrejt në njohjen e dhunës dhe do të inkurajojë gratë ta raportojnë atë, duke mundësuar gjithashtu përmirësimin e veprimeve të praktikuesve nga Institucionet kompetente. Fokusi do të jetë në intensifikimin e zbatimit të obligimeve ligjore në lidhje me parandalimin e dhunës në familje nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë. Ministria e Punëve të Brendshme është ministria udhëheqëse për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, duke pasur parasysh se policia është pika hyrëse në sistemin penalo-juridik për mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe ka një rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e masave të mbrojtjes emergjente "largim i autorit nga banesa" dhe ndalimi për afrim", si dhe në lidhje me masat e përkohshme të mbrojtjes që përbëjnë sistemin juridik civil të mbrojtjes. Ministria e Drejtësisë do të përfshihet aktivisht në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara dhe në grupin e punës do të ftohen edhe subjekte të tjera si MPPS MSH ELS dhe të tjerë

Pika fillestare për zbatimin e angazhimit është përgatitja e Planit për parandalimin e dhunës në familje nga ana e ministrive kompetente, i cili do të përfshijë dy fusha prioritare të veprimit:

1. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut, veçanërisht për grupet vulnerabël të grave, për natyrën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të garantuara ligjërisht, nëpërmjet një fushate gjithëpërfshirëse nacionale në zonat urbane dhe rurale, duke përdorur kanale "tradicionale" dhe alternative për komunikim me publikun.
2. Përmirësimi i kapaciteteve të praktikuesve nga policia, gjyqtarët civilë dhe penalë dhe prokurorët publikë për t'u marrë me dhunën në familje, nëpërmjet organizimit të trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme, duke përfshirë edhe lloje të tjera edukative.

Për secilën nga fushat prioritare do të specifikohen masat konkrete, indikatorët, bartësit dhe fondet e nevojshme buxhetore për zbatimin e tyre. Planifikimi do të bazohet në përvojën dhe nevojat e grave që kanë vuajtur dhunën në familje dhe vetë praktikuesve të përfshirë në sistemin e mbrojtjes, duke promovuar kështu planifikimin e bazuar në prova. Përgatitja e planit dhe aktivitetet përgatitore për zbatimin e të njejtit të ndërmarra në vitin 2024, zbatimi do të fillojë duke filluar nga viti 2025. Është me rëndësi të theksohet se angazhimi parashikon vazhdimin e aktiviteteve në lidhje me dhunën në familje të përfshira në PNA-në aktual për PQH 2021-2023, siq është publikimi i rregullt i të dhënave për rastet e raportuara dhe masat e marra për mbrojtjen e viktimave.

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

1. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut lidhur me natyrën, karakteristikat dhe pasojat e dhunës në familje, si dhe mekanizmat e mbrojtjes ligjore. Angazhimi duhet të rezultojë në njohjen e dhunës në familje, raportim të detyrueshëm në institucione, njohje me mekanizmat e mbrojtjes ligjore, siq është procedura penale për krimet e kryera si rezultat i dhunës në familje dhe procedura civile për vendosjen e masave të përkohshme të mbrojtjes, si dhe si të drejta të garantuara me ligj siq është e drejta e përjashtimit nga pagesa e shpenzimeve dhe e drejta për ndihmë juridike falas në proceset gjyqësore civile.
2. Janë përmirësuar veprimet e policisë, gjyqtarëve penalë dhe civilë dhe prokurorëve publikë si rezultat i përforcimit të njohurive dhe aftësive përmes edukimit të vazhdueshëm. Praktikuesit do ti fitojnë njohuritë dhe aftësitë e duhura për të përmirësuar aspektet individuale të veprimeve të tyre dhe për të siguruar mbrojtje dhe zgjidhje efektive të problemeve specifike të grave që kanë pësuar dhunë në familje.

Analizë e angazhimit	
Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë angazhimi transparencën?	➤ ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse: • mundëson akses në më shumë informacione të reja për publikun, viktimat e dhunës në familje dhe praktikuesit nga institucionet dhe gjyqësori • e përmirëson cilësinë e informacioneve, përmes zhvillimit dhe komunikimit të mesazheve të veçanta për çdo grup të synuar • e përmirëson aksesin ndaj informacioneve për dhunën në familje përmes përfshirjes proaktive të policisë dhe gjyqësorit
2. Si do të ndihmojë angazhimi në nxitjen e llogaridhënies?	➤ ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIEN PUBLIKE sepse: • krijon/përmirëson rregulla, rregullore dhe mekanizma për llogaridhënien publike të funksionarëve, përmes përmirësimit të sjelljes së institucioneve dhe gjyqësorit dhe shpalljen periodike publike të të dhënave për rastet e raportuara dhe veprimet e ndërmarra.
3. Si do të përmirësojë angazhimi pjesëmarrjen e qytetarëve në definimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	➤ ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN QYTETRAE sepse: • Krijon/përmirëson mundësitë dhe kushtet për pjesëmarrje dhe ndikim publik në vendimmarrje, duke planifikuar masa parandaluese në bazë të nevojave specifike të grave që kanë pësuar dhunë në familje, duke përfshirë grupet e cënueshme, siq janë gratë nga zonat rurale, minoritetet etnike dhe gratë me aftësi të kufizuara • Krijon/përmirëson mjedis të favorshëm për shoqërinë civile përmes zgjidhjes së problemeve afatgjata në nivelin e parandalimit për të cilat në vazhdimësi për 20 vjetl punojnë organizatat civile punojnë për barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore

Planifikimi i angazhimeve				
<i>Arritjet /результат/успех</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Data e pritshme e përfundimit</i>	<i>Palët e interesuara</i>	
3.2.1 Hartimi i plani për parandalimin e dhunës në familje	Plan i miratuar për parandalimin e dhunës në familje, i cili përfshin: - ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut për natyrën dhe mekanizmat e mbrojtjes nga dhuna në familje - zbatimi i edukimit të praktikantëve	–mars – tetor 2024	Institucioni udhëheqës: MPB	
			<u>Mbështetje</u>	
			Spektori Publik	HBO Të tjerë
			MD (njësi rajonale të drejtësisë, OJJ, gjykata themelore) MTSP (CSR), MSH (institucione shëndetësore), ELS	ESE dhe OJQ të tjera. Spektori privat Organizatrat ndërkombëtare

3.2.2 Promovim i materialeve edukative për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe rolin e praktikantëve	- Manual i përgaditur për ndërgjegjësimin e publikut për natyrën e dhunës në familje dhe procedurat para institucioneve kompetente - Përgaditje e materialeve (programe dhe udhëzime për edukimin e praktikantëve)	korrik – dhjetor 2024			
3.2.3 Mbajtja e (dy) punëtorive për praktikuesit për t'u njohur me planin e parandalimit dhe materialet promovuese-parandaluese	komunikimi i përmirësuar ndërmjet praktikuesve për mënyrën se si ta informojnë publikun	janar – shkurt 2025	Institucioni udhëheqës MPB Mbështetje: Spektori publik: MD (njësitët rajonale të drejtësisë, PTHP, gjykata themelore) ELS	Ese dhe OJQ- të tjerë	
3.2.4 Mbajtja e katër tribunave informuese për publikun e gjerë në katër qytete dhe shpërndarja e materialeve promovuese në 78	Ndërgjegjësimi i publikut për natyrën dhe mekanizmat ligjorë për mbrojtjen nga dhuna në familje	prill – tetor 2025	Institucioni udhëheqës MPB Mbështetje: Spektori publik:	ESE dhe OJQ të tjera	

stacione policore, 27 gjykata themelore, 22 PTHP,			MD (njësitët rajonale të drejtësisë, PTHP, gjykata themelore) ELS		
3.2.5 Realizim i dy trajnimeve për praktikuesit për të përmirësuar trajtimin e tyre në rastet e dhunës në familje	Njohuri dhe aftësi të përmirësuara të praktikuesve kur veprojnë në kuadër të sistemit të të drejtës penale për mbrojtje, masa emergjente dhe masa të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje.	maj 2025 – janar 2026			

4. ZHVILLIM DHE PËRDORIM I TEKNOLOGJIVE DIGJITALE

Numri dhe emri i angazhimit	4.1 DIGJITALIZIM I PROCESEVE PËR NJOFRIM FINANCIAR TË PARTIVE POLITIKE
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Qëllimi i angazhimit është që të mundësohet transparencë sistematike e financimit të partive politike sepse është identifikuar se në mënyrat e tanishme të financimit të partive politike krijohet mjedis i favorshëm për korrupsion. Përkatësisht, përmes financimit të partive politike hapen mundësitë për krijimin e lidhjeve të forta dhe pozitive të forta që më vonë (nga pozita e qeverisë-donatorit) mund të shfrytëzohen për korrupsion. Prandaj, për të forcuar mbikëqyrjen nga institucionet, por edhe për të mundësuar monitorimin e financimit nga qytetarët, propozohet vendosja e transparencës sistematike të financimit, që nënkupton qasje në të dhënat nga financimi i partive politike në një vend në format të hapur, por edhe për të thjeshtuar formën, përmbajtjen dhe mënyrën e njoftimit financiar të partive politike duke rishikuar formën dhe përmbajtjen e Regjistrit të Donacioneve, Raportit të Donacioneve të pranuar, Raportit Vjetor Financiar dhe raporteve gjatë fushatave zgjedhore.

Institucioni udhëheqës	Ministria e Financave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Ministria e Drejtësisë		
Mbështetje nga palët e interesuara	Spektori publik	Spektori joqeveritar	Të tjera (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare, etj.)
	(ESHR), (DAP), (KSHZ), RQRMV Këshilli i Komunave dhe Qyteti i Shkupit	ZMAI (IDSCS), (IRI), Metamorfozis, QKQ	Partitë politike - janë palët kryesore të interesuara në proces dhe është e nevojshme që gjatë zbatimit përvojat e tyre të merren parasysh
Korniza kohore për angazhimin	mars 2024 – tetor 2025		

Definimi i problemit
1. Çfarë problemi adreson angazhimi? Në përputhje me Ligjin për financimin e partive politike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, burimet e financimit të partive politike dhe shpenzimet e tyre janë publike dhe transparente dhe i nënshtrohen kontrollit nga organet shtetërore. Për të përmbushur transparencën në operacionet financiare, partitë duhet ti publikojnë dokumentet e mëposhtme: • Regjistrin për donacione, i cili përmban emrin e secilit donator individual, llojin dhe vlerën e donacionit, si dhe datën e marrjes së donacionit; • Raportin mbi donacionet e pranuar; • Raportin financiar vjetor, i cili përmban funksionimin financiar të llogarisë së partisë politike, si dhe nënlllogaritë e degëve lokale dhe nënlllogaritë e qendrës hulumtuese-analitike të partisë; • Llogarinë vjetore për operacionet financiare; • Për fushatat zgjedhore: raportin financiar total për fushatën. Financimi i partive politike, nëse nuk është transparent, krijon mjedis në të cilin rritet rreziku i korrupsionit. Nëse rregullativa ligjore dhe auditimi nga institucionet dështon dhe nuk siguron transparencë të të dhënave për paratë që i marrin dhe i shpenzojnë partitë, atëherë probabiliteti për korrupsion është i lartë. Në përputhje me Ligjin për financimin e partive politike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, burimet e financimit të partive politike dhe shpenzimet e tyre janë publike dhe transparente dhe i nënshtrohen kontrollit nga organet shtetërore.¹

¹ IRI dhe ZMAI, Spasovska N., Trajkovska M. (2022) "Praktika të mira për paraqitjen e të dhënave financiare të partive dhe kandidatëve"

Nga ana tjetër, rregullorja e tanishme parasheh paraqitjen jo digjitale të raporteve financiare, gjë që e vështirëson monitorimin e financimit të partive politike nga institucionet mbikëqyrëse. Mënyra aktuale e njoftimit përfshin raporte të skanuara të dorëzuara në letër, të cilat nuk janë të lexueshme nga makineritë dhe nuk mund të futen lehtësisht dhe shpejt në bazën e të dhënave, por kërkojnë punë intensive dhe të zgjatur që çon në përdorim joefikas të burimeve njerëzore në institucione. Institucionet janë të ngadalta për t'u përgjigjur sepse të dhënat nuk janë të disponueshme në format të hapur digjital në formën e grupeve të të dhënave, gjë që nuk mundëson analizë të shpejtë dhe të automatizuar të të dhënave të raportit. Në të njëjtën kohë, shoqëria civile nuk mund në kohë dhe më herët të paralajmërojë për praktikën e mundshme korruptive që shfaqen përmes financimit të partive politike.

Mbikëqyrja e operacioneve financiare dhe materiale të partive politike e kryen (ESHR). Dokumentet lidhur me veprimtarinë financiare të partive politike i dorëzohen edhe (KSHPK), (DAP), (KSHZ), (MF), të cilat gjithashtu kanë obligim ligjor për publikimin e të dhënave.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Përveç formave të përcaktuara ligjore për publikimin e raporteve financiare të partive politike në ueb-faqet e partive, si dhe në ueb-faqet e institucioneve përgjegjëse për punën e tyre, në RMV nuk ekziston format i përcaktuar për paraqitjen e financave të partive politike, parti që do të ishin të unifikuara dhe më të thjeshta për t'u kërkuar. Prandaj, për Maqedoninë e Veriut nuk mund të thuhet se ka sistem raportimi mjaft transparent dhe lehtësisht të aksesueshëm për financimin e partive politike, dhe është e nevojshme të punohet në përmirësimin dhe avancimin e tij.

Gjatë mbledhjes së të dhënave financiare brenda partisë, por edhe gjatë njoftimit të tyre tek institucionet dhe publiku, duhet të përfitohet nga digjitalizimi. Prezantimi i zgjidhjeje të integruar softuerike, ku person i autorizuar nga partia mund të dorëzojë raporte financiare drejtpërdrejt nga tabelat e tyre, do të lehtësojë ndjeshëm barrën administrative të këtij procesi.

Përshkrim i angazhimit

1. Çfarë është bërë deri tani për zgjidhjen e problemit?

Deri më tani nuk janë bërë përpjekje për digjitalizimin e procesit të plotësimit të raporteve të partive politike lidhur me financimin e rregullt dhe zgjedhor të partive politike dhe subjekteve të tjera të përfshira në fushatë zgjedhore, sa i përket zgjidhjes softuerike. Deri më tani, formatet e përcaktuara për përgatitjen e raporteve të partive politike lidhur me financimin e rregullt dhe zgjedhor të partive dhe subjekteve të tjera të përfshira në fushatë zgjedhore janë në format word ose excel.

2. Çfarë zgjidhje propozoni?

Me këtë angazhim do të përgatitet zgjidhje softuerike që do të mundësojë përgatitjen e raporteve financiare direkt në sistem online. Në këtë mënyrë, institucionet do të kenë në të njëjtin moment të gjitha të dhënat në format digjital në formën e grupeve të të dhënave që mund të analizohen dhe përpunohen lehtësisht për ushtrimin e kompetencave të tyre ligjore në ushtrimin e kontrollit dhe monitorimit të financimit të partive politike. Partitë politike do të jenë në gjendje të përgatisin shpejt dhe me efikasitet dhe të dorëzojnë në mënyrë elektronike raportet në formatin e përcaktuar. Publiku do të ketë akses në grupet e të dhënave në të njëjtin moment kur raportet dorëzohen tek institucionet kompetente.

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Me zbatimin e angazhimit do të mundësohet transparenca sistematike e financimit të partive politike. Përmes zgjidhjes digirale për përgatitjen e raporteve financiare do të lehtësohet edhe aksesimi në bazën e të dhënave të nevojshme për analizën e të dhënave financiare të partive politike, e cila do të forcojë mbikëqyrjen e institucioneve, por edhe do të mundësojë monitorimin e financimit të partive politike nga ana e publikut. Nëpërmjet vendosjes së transparencës sistematike të financimit, do të mundësohet aksesimi në të dhënat nga financimi i partive politike në një vend në format të hapur, si dhe thjeshtimi i formës, përmbajtjes dhe mënyrës së njoftimit financiar të partive politike duke rishikuar edhe formën dhe përmbajtjen e Regjistrimit të Donacioneve Raportit të donacioneve të pranuar, Raportit vjetor financiar dhe raportet gjatë fushatave zgjedhore.

Analiza e Angazhimit	
Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë transparençën angazhimi?	Investimi në teknologjitë digjitale për shfaqje të njoftimeve financiare të partive politike është një mënyrë për rritjen e transparencës. Në shumë vende demokratike (p.sh. Mbretëri të Bashkuar, Estoni, Letoni, Finland, Norvegji, Suedi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada, Australi, etj.) në mënyrë aktive, po përdoren përfitimet e digjitalizimit në mënyrë që partitë politike të njoftojnë online dhe tu dërgojnë njoftime organeve mbikëqyrëse, të cilët më pas i bëjnë këto raporte të disponueshme publikisht në faqen e tyre të internetit. Sistemi i tillë i njoftimit online në shumë vende është i lidhur edhe me sisteme të tjera përmes shkëmbimit të të dhënave, siq janë sistemi i taksave, sistemi i popullsisë dhe regjistri i biznesit, ku kontrollimi shtesë i të dhënave nga baza të ndryshme të të dhënave mund të japë indikacione të

	caktuara për ekzistencën e korrupsioni dhe transfertat e paligjshme ² .
2. Si do të ndihmojë angazhimi në nxitjen e llogaridhënies?	Zbulimi i plotë i informacioneve financiare të partive politike, mund të shërbejë edhe si barierë për të reduktuar ndikimet e padëshiruara mbi to. Sipas sugjerimeve të GRECO (Grupi i Shteteve kundër korrupsionit), sistemi që nuk siguron zbulimin e duhur të burimeve të të ardhurave dhe llogarive të partive, shpeshherë ka vështirësi në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve që e rregullojnë financimin e partive politike dhe fushatave, si dhe në zbatimin e sanksioneve të nevojshme. Në të njëjtën kohë, duhet theksuar se publikimi i të dhënave në vetvete nuk është dëshmi e transparencës financiare të partive politike. Në përputhje me definicionin e Komisionit të Letrave me Vlerë të SHBA-së,(U.S. Securities and Exchange Commission), transparenca financiare nënkupton zbulimin në kohë, kuptimplotë dhe të besueshëm të performancës financiare.
3. Si do të përmirësojë angazhimi pjesëmarrjen e qytetarëve në definimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	Transparenca financiare e fushatave politike paraqet një nga tiparet më të rëndësishme të demokracive funksionale. Ajo është bazë për sigurimin e llogaridhënies së partive politike dhe mjet për votuesit - për të marrë vendime të informuara më lehtë, dhe për institucionet që në mënyrë efektive të mbikëqyrin punën e partive politike.

² IRI dhe ZMAI, Spasovska N., Trajkovska M. (2022) "Praktika të mira për paraqitjen e të dhënave financiare të partive dhe kandidatëve"

Planifimiki i angazhimeve					
Arritjet	Rezultatet e pritura	Data pritshme e përfundimit	Palët e interesuara		
4.1.1 Aktet nënligjore të identifikuara lidhur me financimin e partive politike që i miraton Ministri i Financave dhe bazat ligjore për digjitalizimin e procedurës për përgatitjen elektronike të raporteve.	1. Është përgatitur lista e akteve nënligjore lidhur me financimin e partive politike që i miraton Ministri i Financave dhe bazat ligjore për digjitalizimin e procedurës për përgatitjen elektronike të raporteve. 2. Dinamik e definuar për ndryshime në akteve nënligjore lidhur me financimin e partive politike në drejtim të digjitalizimit të procesit të përgatitjes së njoftimit financiar lidhur me operacionet e rregullta dhe zgjedhore të partive politike (dhe subjekteve të tjera të përfshira në fushata zgjedhore).	mars 2024	Institucioni udhëheqës: MΦ		
			Mbështetje		
			Spektori publik	HBO	Të tjerë
			MF, KSHPK, ESHR, DAP, KSHZ, RQRMV	ZMAI, IDSC; IRI Metamorfoza, QKQ	Partitë politike

4.1.2 Akte të reja nënligjore të miratuara lidhur me financimin e partive politike të cilat i miratona Ministri i Financave	1. Është formuar grup pune për përgatitjen e formateve të reja të njoftimit financiar 2. Akte të reja të përgatitura lidhur me financimin e partive politike, të cilat i miraton Ministri i Financave.	qershor 2025	MF, KSHPK, ESHR, DAP, KSHZ, RQRMV	ZMAI, IDSCS; IRI Metamorfoza, QKQ	Partitë politike
4.1.3 Është përgaditur zgjidhje softuerike për plotësimin elektronik të raporteve të partive politike lidhur me financimin e rregullt dhe zgjedhor të partive politike dhe subjekteve të tjera të përfshira në fushatë zgjedhore	1. Përgatitja e specifikimeve teknike për zgjidhje softuerike 2. Zhvillimi i zgjidhje softuerike 3. Testimi i zgjidhje softuerike 4. Zbatimi i zgjidhje softuerike në	shtator 2024 – mars 2025	KSHPK, MF, ESHR, DAP, KSHZ, RQRMV	ZMAI, IDSCS; IRI Metamorfoza, QKQ	Partitë politike

4.1.4 Është mundëuar parashtimi elektronik i raporteve të partive politike lidhur me financimin e rregullt dhe elektoral të partive politike dhe subjekteve të tjera të përfshira në fushatë zgjedhore pranë institucioneve në përputhje me ligjet.	Janë bërë ndryshime në Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Financimin e Partive Politike për të mundësuar dorëzimin elektronik të raporteve duke përdorur certifikatën e nënshkrimit dixhital. 2. Aktivizim një moduli në kuadër të zgjidhjes softuerike të zhvilluar për dorëzimin elektronik të raporteve në institucionet në përputhje me ligjet (KSHPK)	qershor 2025	KSHPK, MF, ESHR, KSHZ, RQRMV	ZMAI, IDSCS; IRI Metamorfoza, QKQ	Partitë politike
---	--	--------------	------------------------------	-----------------------------------	------------------

4.1.5 Partitë politike trajnohen për përgatitjen elektronike dhe dorëzimin e raporteve në lidhje me financimin e rregullt dhe zgjedhor të partive politike dhe subjekteve të tjera të përfshira në fushatë zgjedhore në institucione në përputhje me ligjet.	1. Janë përgatitur manuale për përdorimin e zgjidhjes softuerike 2. Janë zhvilluar trajnime për partitë politike për përgatitjen elektronike dhe dorëzimin e raporteve lidhur me financimin e rregullt dhe elektoral të partive politike.	prill – qershor 2025	KSHPK, MF, ESHR	ZMAI, IDSCS; IRI Metamorfoza, QKQ	Partitë politike
4.1.6 Mediumet dhe organizatat e shoqërisë civile janë trajnuar për përdorimin e të dhënave nga zgjidhja softuerike për financimin e partive politike	1. U realizuan trajnime për mediumet dhe organizatat e shoqërisë civile për përdorimin e të dhënave nga zgjidhja softuerike për financimin e partive politike	shtator dhjetor 2025	KSHPK,	ZMAI, IDSCS; IRI Metamorfoza, QKQ	/

Numri dhe emri i angazhimit	4.2 DIGJITALIZIM I TË DHËNAVE PËR AVANCIM TË POLITIKAVE LOKALE EKONOMIKE
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Centralizimi i politikave publike të Maqedonisë së Veriut i thelloi dallimet rajonale. Decentralizimi përmes specializimit të zgjuar rajonal, bazuar në vëzhguesit lokalë të të dhënave, mund ti zvogëlojë këto dallime. Megjithatë, barrierat për akses dhe boshllëqet në kompetencat digjitale të nëpunësve për përdorimin e këtyre të dhënave kufizojnë transformimin. Qëllimi i angazhimit është përshpejtimi i procesit të decentralizimit përmes promovimit të sistemit për ngritjen e politikave të zhvillimit rajonal dhe lokal të bazuar në të dhëna. Kjo

	do të arrihet duke rritur cilësinë dhe disponueshmërinë e të dhënave komunale si dhe duke futur mjete moderne për analizën dhe interpretimin e tyre. Ky angazhim ka për qëllim bashkëpunimin me tri institucione publike në drejtim të përmirësimit dhe publikimit të të dhënave ekonomike lokale që ata i posedojnë Agjencia për Punësim dhe Drejtoria e të Ardhurave Publike. Kështu, ky angazhim do të rrisë disponueshmërinë dhe dobinë e të dhënave ekonomike nën juridiksionin e institucioneve publike. Për shembull, Drejtoria e të Ardhurave Publike posedon të dhëna për TVSH-në dhe të ardhurat e individëve sipas aktiviteteve dhe komunave, por ato janë të publikuara në nivel të agreguar. Agjencia e Punësimit gjithashtu ka të dhëna të ngjashme: situata e punësimit mund të matet në nivel komunal dhe sektorial. Nëse këto të dhëna paraqiten me grumbullim më të ulët (në nivel komune), atëherë mundësitë për kryqëzimin e të dhënave dhe ngritjen e politikave publike të bazuara në dëshmi do të thjeshtohen dhe do të jenë më efikase. Dixhitalizimi dhe hapja e këtyre të dhënave për publikun e gjerë do të mund të nxisë rritjen ekonomike lokale të drejtuar nga të dhënat, duke inkurajuar çdo institucion në nivel qendror dhe lokal që të ndërtojë strategji zhvillimi të informuara, efektive dhe të qëndrueshme.		
Institucioni udhëheqës	DAP, APRMV		
Mbështetje nga palët e interesuara	Spektori publik	Spektori joqeveritar	Të tjerë (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare, etj.)
	(DAP), (APRMV)	ZMAI, IRI, ESE	/
Korniza kohore e angazhimit	shkurt 2024 – janar 2026		

Definim i problemit
1. Çfarë problemi adreson angazhimi? Sa arin paga e programerëve në Manastir? Cilat janë diferencat gjinore të pagave? Çfarë është pabarazia e të ardhurave në industrinë e tekstilit? Sa punësime kishte në industrinë e TIK në Manastir? Cilat janë ndryshimet gjinore në punësim në industrinë e tekstilit? Cila është shkalla e arsimimit të punësimit në sektorin bankar

Përgjigjet për këto pyetje janë të nevojshme për të siguruar krijimin e politikave publike të bazuara në prova dhe informacione. Në të njëjtën kohë, këto pyetje shpesh shtrohen dhe analizohen në qarqet akademike për hulumtime shkencore dhe nga organizatat e shoqërisë civile për nevoja aktiviste, eksperte ose përfaqësuese. Megjithatë, çdo individ që dëshiron të ketë akses në:

- "Të dhënat e të ardhurave lokale", është e nevojshme të paraqesë kërkesë në Drejtorinë e të Ardhurave Publike (DAP)

- "Të dhëna lokale për punësim", është e nevojshme të paraqesë kërkesë në APRMV.

DAP, për t'i dorëzuar këto të dhëna individit, kryen shërbim të grumbullimit të mikro të dhënave të mbledhura nga formulari MPIN. APRMV, për t'i dorëzuar këto të dhëna individit, kryen proces manual të grumbullimit dhe anonimizimit të mikro të dhënave të mbledhura nga baza e të dhënave të Agjencisë.

Për të kapërcyer këtë problem, ky angazhim ka për qëllim të digjitalizojë procesin e publikimit të të dhënave publike të prodhuara nga DAP, APRMV nëpërmjet zhvillimit të metodologjisë dhe hallkës për sistemim, grumbullim dhe publikim. Hallka do të vihet në dispozicion të DAP për përdorim të pandërprerë. Digjitalizimi i të dhënave të të ardhurave deri në nivel komune është edhe pjesë e angazhimit të BE-së për informacion më të mirë gjatë ndërtimit të politikave publike dhe ligjeve të reja. Ky qëndrim është theksuar edhe në raportin e fundit për progresin e Maqedonisë së Veriut, ku në rubrikën "Krijimi i politikave dhe koordinimi" theksohet se "Shumë institucione ende nuk i kanë digjitalizuar regjistrat e tyre. Shkëmbimi i të dhënave administrative duhet të zgjerohet dhe të dhënat duhet të thjeshtohen për të informuar më mirë politikëbërjen dhe legjislacionin e ri." Në të njëjtën kohë, një numër në rritje i vendeve të BE-së, por edhe jashtë BE-së, përdorin mjete digjitale për të publikuar të dhënat e të ardhurave në nivel komune, përkatësisht të vetëqeverisjes lokale.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Aksesi te "të dhënat e të ardhurave lokale" përfaqëson pothuajse gjithmonë proces të gjatë burokratik që kërkon një angazhim të madh nga të dy palët e interesuara. Domethënë, nga njëra anë, sa herë që ka nevojë për të dhëna, individit duhet të paraqesë një kërkesë (edhe nëse për të rivendosur aksesin në të njëjtat të dhëna). Nga ana tjetër, të punësuarit në institucione duhet të veprojnë çdo herë sipas asaj kërkesë dhe të grumbullojnë të dhënat. Aksesi i tillë e ndërlikon punën e nëpunësve publikë dhe e ngadalëson procesin e krijimit të politikave publike, e kjo është veçanërisht e vërtetë për politikën ekonomike.

Përshkrim i angazhimit

1. Çfarë është bërë deri më tani për të zgjidhur problemin?

Praktika aktuale tregon se numri më i madh i institucioneve që prodhojnë ose mbledhin të dhëna ekonomike, për momentin i mbledhin të njëjtat në formë jo standarde dhe dhe si të papërpunuara i

ndajnë si të dhëna me (ESHS). Më pas, ESHS i standardizon të dhënat dhe të njëjtat i publikon në nivel të përmbledhur në bazën e të dhënave MAKStat të ESHS-së. Sistemi i krijuar në këtë mënyrë e burokratizon procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave dhe vendos gjithë barrën për të dhënat mbi ESHS. Përkundrazi, praktikat evropiane tregojnë se institucionet janë ato që kanë pronësi mbi të dhënat dhe standardizojnë mbledhjen, përpunimin dhe publikimin/shkëmbimin e tyre. Prandaj, në Maqedoninë e Veriut shpesh ka vonesë në publikimin e disa prej të dhënave kryesore ekonomike.

2. Çfarë zgjidhje propozoni?

DAP

Përmes këtij angazhimi, do të krijohet sistem i automatizuar i grumbullimit të të dhënave nga MPIN, i cili më pas do të publikohet vetë në web-faqen e internetit të IRS (të njëjtat do të rishikohen në bazë të rregullt). Të dhënat që DAP do ti bëjë publike janë shumat e pagës mesatare, pagave totale të paguara dhe pagave sipas kuintileve (më e ulëta 20%, deri në 80%) të ndara sipas komunace, gjinisë, aktivitetit dhe grupmoshës. Shembuj të të dhënave të tilla janë:

1. Paga mesatare e femrave të moshës 20 deri në 30 vjeç, në shërbime juridike në komunën Qendër.
2. Totali i pagave të paguara për personat e moshës 40-50 vjeç në komunën e Tetovës.
3. Të ardhurat mesatare të 20% të të punësuarve më pak të paguar në komunën e Ohrit.

Përmes zbatimit të këtij angazhimi do të nxitet rritja rajonale e drejtuar nga të dhënat, duke inkurajuar ndërtimin e strategjive të informuara, efektive dhe të qëndrueshme të zhvillimit.

APRMV

Përmes këtij angazhimi, do të krijohet sistem i automatizuar i grumbullimit të të dhënave nga baza ekzistuese e të dhënave, të cilat më pas do të publikohen në faqen e internetit të APRMV (të njëjtat do të rishikohen në bazë të rregullt) ose do t'i përcillen institucioneve përkatëse si ESHS. Të dhënat që APRMV do ti shpallë publikisht janë numri punësimeve gjithsej në aktivitet specifik, në komunë të caktuar, në moment të caktuar kohor. Gjithashtu, këto të dhëna do të ndahen sipas komunës, gjinisë, aktivitetit dhe grupmoshës. Shembuj të të dhënave të tilla janë:

1. Numri i punësimit të grave nga mosha 20 deri në 30 vjeç në biznesin e shërbimeve juridike në komunën e Qendrës.
2. Numri i përgjithshëm i punësimeve/papunësimeve të moshës 40-50 vjeçare në komunën e Tetovës.
3. Sistemimi i shkallës së arsimimit të punësimeve në sektorin e bujqësisë në komunën e Ohrit.

Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të theksohet se e drejta për privatësi e të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale do të respektohet plotësisht gjatë publikimit të të dhënave. Domethënë, të dhënat personale të personave fizikë apo juridikë nuk do të publikohen në asnjë hap të procedurës së publikimit.

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Përmes këtij angazhimi do të krijohet sistem i automatizuar i grumbullimit të të dhënave nga bazat ekzistuese e të dhënave të APRMV, dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike, të cilat më pas do të publikohen në web-faqen e internetit të tre institucioneve (të njëjtat do të rishikohen në bazë të rregullt).

Përmes zbatimit të këtij angazhimi do të nxitet rritja rajonale e drejtuar nga të dhënat, duke inkurajuar ndërtimin e strategjive të informuara, efektive dhe të qëndrueshme të zhvillimit.

Analizë e angazhimit	
Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë angazhimi transparencën?	Automatizimi dhe përmirësimi i sistemeve të bazave të të dhënave dhe infrastrukturës digjitale në institucionet publike e promovon ndjeshëm transparencën e qeverisjes qendrore dhe lokale. Zgjidhjet dixhitale të proceseve lidhur me të dhënat ekonomike i reduktojnë gjasat e gabimit njerëzor, duke siguruar saktësinë dhe konsistencën e të dhënave. Saktësia dhe konsistenca e mbështesin besueshmërinë e informacioneve të karakterit publik, i cili është i rëndësishëm për besimin dhe kredibilitetin e institucioneve publike (të cilët marrin pjesë në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave ekonomike.) Për më tepër, të dhënat e besueshme janë thelbësore për menaxhimin efektiv dhe zhvillimin e politikave, pasi ato ofrojnë bazën e nevojshme për analizë, planifikimi dhe zbatim të shërbimeve publike dhe nevojave të biznesit. Veprimtaritë në këtë angazhim çojnë në publikimin e saktë, në kohë dhe transparent të të dhënave ekonomike të përshtatshme për nevojat e operatorëve të biznesit, pushtetit lokal, komunitetit akademik dhe qytetarëve. Disponueshmëria e të dhënave në grumbullime që plotësojnë nevojat e qytetarëve rrit dobinë e të dhënave ekonomike, dhe rrjedhimisht përdorimin dhe dukshmërinë e tyre. Me këtë angazhim promovohet edhe transparencën e pushtetit lokal. Sigurimi i të dhënave për indikatorët ekonomikë në nivel komunal e rrit dukshmërinë e nevojave dhe rezultateve ekonomike lokale. Njëkohësisht, aktivitetet në këtë angazhim kontribuojnë në uljen e korrupsionit, si kërcënim për transparencën e

	institucioneve publike. Automatizimi i proceseve që lidhen me mbledhjen, ruajtjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave ekonomike i minimizon mundësitë për korrupsion duke reduktuar ndikimin njerëzor në procese. Gjithashtu, përdorimi efektiv i të dhënave ekonomike burimore nga institucionet publike është mjet i rëndësishëm për izolimin e aktiviteteve problematike ekonomike dhe ekspozimin e korrupsionit.
2. Si do të ndihmojë angazhimi në nxitjen e llogaridhënies?	Ky angazhim inkurajon llogaridhënien e institucioneve publike dhe të vetëqeverisjes lokale ndaj qytetarëve përmes rritjes së disponueshmërisë së të dhënave që i monitorojnë dhe vlerësojnë aktivitetet ekonomike dhe ndryshimet e tyre. Rritja e disponueshmërisë së të dhënave të dobishme ekonomike është mekanizëm i rëndësishëm për monitorimin dhe vlerësimin e nismave të ndryshme nacionale dhe lokale. Grumbullimet e ndryshme të të dhënave burimore të këtyre tri institucioneve (për shembull, papunësia, rritja e eksportit të mallrave dhe profesioni më i zakonshëm në komunën e Manastirit) do të mundësojnë matjen e rezultateve të politikave të ndryshme lokale dhe politikave nacionale për zhvillimin rajonal. Mundësimi i të dhënave të disponueshme në formë të agreguar siç duhet është mekanizëm kyç për vlerësimin e politikave publike dhe rezultateve të tyre. Gjithashtu, publikimi në kohë dhe i vazhdueshëm i këtyre të dhënave do të mundësojë monitorimin e proceseve kyçe në kohë. Statistikat nacionale që lidhen me aktivitetet ekonomike shpesh përmbajnë dallime të rëndësishme rajonale. Mungesa e të dhënave për aktivitetet kryesore ekonomike në nivel komunal paraqet pengesë për matjen dhe monitorimin e dallimeve ekonomike rajonale si dhe efektin e politikave të ndryshme nacionale dhe lokale mbi to. Ajo e ndërlikon procesin e përcaktimit të përgjegjësisë për shkaqet që kontribuojnë në statistikatat nacionale. Me këtë angazhim reduktohen barrierat për aksesin në të dhënat përkatëse ekonomike që përdoren për të vlerësuar efektin e politikave publike dhe për të përcaktuar llogaridhënien për njejtat.
3. Si do të përmirësojë angazhimi pjesëmarrjen e qytetarëve në definimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	Automatizimi dhe përmirësimi i sistemeve të bazës së të dhënave dhe infrastrukturës digjitale në institucionet publike do të lehtësojë ndjeshëm aksesin në informacionet publike.

Planifikimi i angazhimit					
<i>Arritjet</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Data pritshme e përfundimit</i>	<i>Palët e interesuara</i>		
4.2.1. Sistemi i automatizuar i grumbullimit të të dhënave nga LLMPI i cili më pas do të publikohet në faqen e internetit të DAP (të njëjtat do të rishikohen në bazë të rregullt).	1. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi në kohë dhe i standardizuar i të dhënave të të ardhurave, të agreguara në nivel lokal, sipas metodologjisë së njohur ndërkombëtarisht. 2. Kompetenca të rritura të nëpunësve shtetëror në DAP për digjitalizimin e proceseve që lidhen me të dhënat e të ardhurave.	janar 2026	Institucioni udhëheqës: DAP		
			<u>Mbështetje</u>		
			Spektori Publik	HBO	Të tjerë
			DAP	ZMAI, IRI	
4.2.2 Sistemi i automatizuar i grumbullimit të të dhënave nga baza e të dhënave ekzistuese të cilat më pas do të publikohen në web-faqen e internetit të APRMV (të njëjtat do të rishikohen në mënyrë tërregullt) ose do t'i përcillen institucioneve përkatëse si ESHS.	Mbledhja, përpunimi dhe publikimi në kohë dhe i standardizuar i të dhënave për punësimin dhe personat e papunët dhe tregun e punës, të agreguara në nivel lokal, sipas metodologjisë së njohur ndërkombëtarisht. 2. Kompetenca të rritura të	janar 2026	APRMV	ZMAI, IRI	/

	nëpunësve shtetëror në APRMV për digjitalizimin e proceseve lidhur me të dhënat për eksportin dhe importin e mallrave.				
--	--	--	--	--	--

5. PROMOVIM I AKTIVITETEVE PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Numri dhe emri i angazhimit	5.1 PJESMARRJE EFEKTIVE E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE NË FUSHËN E TË DREJTËS PËR UJËRAT		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Angazhimi synon të lehtësojë dhe të rrisë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje në fushën e mjedisit jetësor ose që ndikojnë mbi mjedisin jetësor.		
Institucioni udhëheqës	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor		
Mbështetje nga palët e interesuara	Spektori publik	Spektori joqeveritar	Të tjerë (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare, etj.)
	MMJPH	Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj	/
Korniza kohore e angazhimit	janar 2024 – janar 2026		

Definim i problemit

1. Çfarë problemi adreson angazhimi?

Transparenca, aksesin në informacione dhe pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje lidhur me mjedisin jetësor është sfidë me të cilën përballlet shteti dhe e cila

konstatohet vazhdimisht nga Komisioni Evropian në raportet për progresin e shtetit për vitet [2020, 2021 dhe 2022](#). Sfidë në lidhje me pjesëmarrjen e publikut janë identifikuar edhe nga [OJQ-të e Maqedonisë](#). Pjesëmarrja e publikut në fushën e mjedisit jetësor zë vend të rëndësishëm në të drejtën ndërkombëtare, kështu që një nga shtyllat e Konventës së Aarhusit, e ratifikuar nga Maqedonia e Veriut në vitin 1999, është pikërisht detyrimi i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, të paktën për proceset dhe aktivitetet që ajo vetë Konventa i parashikonte. Në të njëjtën kohë, Bashkimi Evropian aderoi në Konventën e Aarhus-it dhe vetë BE-ja me direktivat e saj parashikon pjesëmarrjen e detyrueshme të publikut në vendimet dhe proceset që lidhen me mjedisin jetësor. Publiku (qytetarët, OJQ, etj.), dhe veçanërisht publiku i prekur (qytetarët që janë aktualisht dhe/ose në të ardhmen mund të preken ose të kenë interes në miratimin e vendimi për mjedisin jetësor dhe/ose që janë ka të ngjarë të ndjejë pasojat e marrjes së vendimit, duke përfshirë organizatat civile të formuara për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit) përballen me vështirësi, dhe në raste të caktuara, me mohimin e së drejtës për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve që lidhen me mjedisin. Duke marrë parasysh raportet e KE-së, kjo sfidë ekziston në vend prej të paktën 4 vitesh dhe këmbëngulja e saj nuk e lejon publikun dhe publikun e prekur të përfshihet efektivisht dhe të ndikojë në vendimmarrje në fushën e mjedisit jetësor në mënyrë që do të parandalonte ose reduktonte ndikimin negativ në mjedisin jetësor.

Angazhimi i referohet në radhë të parë rëndësisë së pjesëmarrjes së publikut në procedurat për përgatitjen dhe zbatimin e: 1) elaboreve për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe 2) lejeve të së drejtës ujore. Në pjesë të madhe të procedurave që lidhen me dhënien e lejes së të drejtës ujore, duhet miratuar paraprakisht elaboret për mbrojtjen e mjedisit jetësor, ndaj për këtë arsye dhe në drejtim të reformimit të sistemit të menaxhimit të ujit dhe përfshirjes aktive të publikut në të gjithë procesin, Angazhimi fokusohet edhe në elaboret për mbrojtjen e mjedisit jetësor, si pjesë e mëparshme e dhënies së lejes për shfrytëzimin e ujërave apo shkarkimin në ujëra.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Arsyet për pjesëmarrjen e publikut në procese mund të grupohen në tre grupe:

- **Ligjore** - Ligji për mjedisin jetësor në nenin 24 nuk parashikon 1) publikimin e elaboreve për mbrojtjen e mjedisit jetësor, 2) mundësinë dhe afatet për pjesëmarrjen e publikut përmes paraqitjes së komenteve me shkrim dhe vërejtjeve, 3) obligimin për marrjen e mendimit nga publiku gjatë miratimit të raporteve, 4) mbrojtje ligjore për publikun dhe palët e prekura. Çështja është elaboruar në [analizat e OJQ-të maqedonisë](#). Në të njëjtën kohë, megjithëse Ligji për Ujërat parashikon se përmbajtja e publikimit të kërkesës për leje të së drejtës ujore në gazetën e përditshme dhe në faqen e internetit të MMJPH definohet me akt nënligjor, **i cili ende nuk është miratuar** dhe publikimi bazohet në praktikën e Sektorit të Ujërave në Drejtorinë e Mjedisit Jetësor në kuadër të MMJPH. Kërkesa e fundit për leje të së drejtës ujore është e vitit 2016, kur nuk është publikuar kërkesa, por letra bashkangjitore që kërkuesi e ka dorëzuar në MMJPH
- **Teknike** – në shtet nuk ekziston vend qendror ku publikohen të gjitha dokumentet dhe njoftimet ku publiku ka të drejtë të paraqesë komente dhe medime. Dokumentet e tilla publikohen në vende të ndryshme në web-faqen e internetit të MMJPH dhe në portalet e zhvilluara nga MMJPH. Kështu, për shembull: 1) informacione për kërkesat e paraqitura për leje për të drejtat e ujit publikohet në pjesëne faqes së internetit të MMJPH të destinuar

për Sektorin e Ujit, në rubrikën "Publikime"; 2) informacionet lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor publikohen në pjesën "Shërbime", nënseksioni "Studimet e Vlerësimit të Ndikimit mbi Mjedisin Jetësor" në web-faqen e internetit të MMJPH; 3) informacionet lidhur me lejet e integruara mjedisore publikohet në pjesën "Shërbime" nënseksioni "Parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes-ISKZ" në faqen e internetit të MMJPH dhe njëkohësisht në portalin [REGJISTRI](#), si dhe informacione të veçantë publikuar edhe në portalin [REGJISTRI I SUBJEKTEVE TË MBIKËQYRUR DHE RAPORTET E INSPEKTIMIT](#) të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit JETËSOR. Duke qenë se pjesëmarrja e publikut kufizohet me afate, në të gjitha këto portale nuk ka gjenerim automatik të datave të publikimit të dokumentit, kështu që mund të shkaktohet problem për sa i përket shqyrtimit të afateve për paraqitjen e komenteve, dhe më pas për sa i përket afateve për mbrojtje ligjor, ku e njëjta është parashikuar.

- **Kadrovike** – MMJPH përballlet me [mungesë të të punësuarve](#) për zbatimin me efikasitet të të gjitha kompetencave të shumta që i ka.

Përshkrim i angazhimit

1. Çfarë është bërë deri më tani për të zgjidhur problemin?

Ajo që është bërë deri më tani është se shumica e dokumenteve në Sektorin e Ujrave janë miratuar, por ato nuk janë sistemuar siç duhet dhe nuk janë të disponueshme për publikun në mënyrë që qytetarët të kenë akses në to dhe të përfshihen në procesin e konsultimit në çdo kohë. Njoftime të tilla nuk bëhen, ndoshta sepse nuk janë të detyrueshme sipas Ligjit për Mjedisin (neni 24), por në kuadër të rritjes së transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies për atë që është bërë, është shumë e nevojshme të bëhet dhe në në këtë mënyrë të gjitha vendimet dhe dokumentacioni i miratuar më parë të jenë të suksesshme edhe në pjesën e plotësimit të kriterëve për PQH.

2. Çfarë zgjidhje propozoni?

1. Përmirësimi i disponueshmërisë dhe informacioneve lidhur me regjistrat ujorë që përgatiten dhe redaktohen në web-faqen e internetit të MMJPH sipas parimit të mëposhtëm::
 - Mundësia për komente për dokumentet që tashmë janë vendosur në web- faqen e internetit;
 - Publikimi i të gjitha dokumenteve lidhur me temën
 - o Për shembull kur Sektori i Ujrave duhet të publikojë kërkesë për marrjen e lejes, vetë softueri do të ofrojë fushë në të cilën duhet të bashkëngjitet i gjithë formulari i kërkesës, fushë në të cilën duhet të jetë bashkëngjitet aktvendimi për elaboratin e miratuar për mbrojtjen e mjedisit jetësor ose studimi i vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe të ngjashme. Këto fusha do të jenë të detyrueshme për t'u plotësuar me skedarë, përpara se të kalohet në fazën tjetër të publikimit të informacionit në portal.

Zbatimi i këtyre aktiviteteve 1) do të sigurojë parakushte për pjesëmarrjen e publikut në të gjitha procedurat e vendimmarrjes lidhur me përdorimin e ujit, 2) do të lehtësojë aksesin e publikut në informacion që do të çojë në përfshirjen efektive të publikut në procesin e vendimmarrjes dhe mundësinë për ndikim thelbësor në menaxhimin e ujit. Prandaj, zbatimi i këtyre aktiviteteve pritet

të zgjidhë plotësisht problemet juridike dhe teknike të identifikuara më sipër, por gjithashtu do të kontribuojë në zbatimin e vazhdueshëm të legjislacionit mjedisor të Maqedonisë, si dhe në përmbushjen e qëllimit të dokumenteve ndërkombëtare për pjesëmarrjen e publikut në vendime lidhur me mjedisin jetësor në fushën e të drejtës ujore.

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Përmirësimi i regjistrave ekzistues të MMJPH në fushën e të drejtës ujore, përmes të cilit do të parashikohet si publikim i detyrueshëm i dokumenteve specifike nga procese të caktuara, përpara se të kalohet në fazën tjetër të procedurës së rregulluar me ligj, do të kontribuojë në zbatimin e plotë të legjislacionit të Maqedonisë dhe do të ndikojë në ndryshimin e vërejtjeve të Komisionit Evropian për pjesëmarrjen e publikut në proceset që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor. Obligimi i të punësuarve në MMJPH është që fillimisht të publikojnë të gjitha dokumentet në platformë përpara se të vijojnë me fazën tjetër të procedurës ligjore do të kontribuojë në ndryshimin e praktikave të mundshme negative. Nga ana tjetër, publiku dhe publiku i prekur do të kenë akses më të lehtë për t'u përfshirë në vendimmarrje lidhur me menaxhimin e ujërave, ndërsa platforma e krijuar në mënyrën e përshkruar më sipër do të shërbejë gjithashtu si udhërrëfyes për pjesëmarrjen e tyre të suksesshme në procese. Qasja në të gjitha dokumentet e nevojshme për përfshirje efektive në vendimmarrje do të rrisë ndikimin e publikut dhe pjesëmarrjen në mbrojtjen e mjedisit jetësor. Në këtë mënyrë do të forcohen njohuritë, aftësitë dhe kapacitetet e publikut dhe publikut të prekur në vendimmarrje lidhur me mjedisin jetësor, përmes digjitalizimit dhe përdorimit të mjeteve të TIK-ut.

Analizë e angazhimit	
Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë angazhimi transparencën?	Realizimi i angazhimit do të mundësojë direkt rritjen e transparencës së MMJPH duke vënë në dispozicion të gjitha dokumentet që janë me interes për publikun në një vend, të organizuar dhe çdo qytetar që është i interesuar do të mund të lexojë ato dhe të paraqesin komentet ose vërejtjet e tyre.
2. Si do të ndihmojë angazhimi në nxitjen e llogaridhënies?	Vetë publikimi i dokumenteve me interes për qytetarët në faqen e MMJPP do të ndikojë shumë në rritjen e përgjegjësisë së institucionit si për konsultimet me qytetarët ashtu edhe në zbatimin e obligimeve ligjore apo obligimeve që rrjedhin nga dokumentet strategjike.
3. Si do të përmirësojë angazhimi pjesëmarrjen e qytetarëve në definimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	Nëpërmjet vetë procesit të disponueshmërisë dhe mundësive për rishikim të proceseve dhe dokumenteve, do të mundësohet përfshirja aktive e qytetarëve në proceset e konsultimit publik, qytetarët do të kenë mundësinë të informohen në kohën e duhur dhe të reagojnë aty ku është e nevojshme, dhe përmes proceseve strategjike, sërish do të kenë mundësi të përfshihen drejtpërdrejt në zbatimin e masave dhe aktiviteteve, por edhe të monitorojnë zbatimin.

Planifikimi i angazhimeve					
Arritjet	Rezultatet e pritura	Data pritshme e përfundimit	Palët e interesuara		
5.1.1 Komponentët e përcaktuar, funksionet, paraqitjen e /platformës si pjesë përbërëse e web-faqes MMJPH	Platformë e zhvilluar në lidhje me web-faqen e MMJPH, e cila do të synojë publikimin e dokumenteve në fushën e të drejtës së ujërave që janë të detyrueshme për konsultim me qytetarët dhe publikun e gjerë.	dhjetor 2024	Institucioni udhëheqës: МЖСПП		
			<u>Mbështetje</u>		
			Spektori Publik	HBO	Të tjerë
			MMJPH	Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj	/
5.1.2 Publikimi i rregullt dhe në kohë i të gjitha dokumenteve lidhur me lejet e të drejtës ujore në platformën e zhvilluar dhe përforcimi i efektivitetit të informimit të qytetarëve dhe OJQ-ve duke promovuar informacionin për dokumentet e publikuara në kanalet e komunikimit të MMJPH.	100% e kërkesave për të drejtat e ujit të marra në periudhën prej 2024-2026 publikohen në platformën e zhvilluar dhe promovohen përmes kanaleve të komunikimit të MMJPH	tetor 2025	MMJPH	Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj	/

5.1.3 Ndryshim i nenit 24 të Ligjit për Mjedisin Jetësor	Ligji për Mjedisin Jetësor mundëson pjesëmarrjen e publikut në procedurat për përgatitjen dhe miratimin e raporteve për mbrojtjen e mjedisit jetësor.	janar 2026	MMJPH	Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj	
--	---	------------	-------	--	--

Numri dhe emri i angazhimit	5.2 INFORMIM MË I MADH I QYTETARËVE PËR AKTIVITETET NË INSTITUCIONET LIDHUR ME NDRYSHIMET KLIMATIKE PËRMES PROMOVIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDERSEKTORIAL NDËRMJET MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE EKONOMISË SË UJËRAVE DHE MINISTRISË SË MJEDISIT JETËSOR DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit	Masat dhe aktivitetet që planifikohen dhe zbatohen në të dy ministritë më së shpeshti nuk janë të koordinuara dhe nuk ka bashkëpunim të rregullt në fushën e ndryshimeve klimatike, kështu që ministritë punojnë veçmas si institucione, edhe pse në fushën e ndryshimeve klimatike, nevojitet angazhimi i tyre i përbashkët, i cili do të realizohet pikërisht përmes zbatimit të këtij angazhimi. Angazhimi parashikon shkëmbimin dhe shpërndarjen e rregullt të informacioneve në lidhje me ndryshimet klimatike si dhe publikimin e tyre publik në faqet e internetit të dy ministrive, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërsektorial ndërmjet dy ministrive.		
Institucioni udhëheqës	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor		
Mbështetje nga palët e interesuara	Spektori publik	Spektori joqeveritar	Të tjerë (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare, etj.)
	MBPEU, MMJPH	Kualicioni Rural	/
Korniza kohore e angazhimit	Mars 2024- Janar 2026		

Definimi i problemit

1. Çfarë problemi adreson angazhimi?

Mungon bashkëpunimi i rregullt mes dy ministrive të përmendura, për shkak se për pjesë të madhe të aktiviteteve lidhur me ndryshimet klimatike, që zbatohen në fushën e mjedisit jetësor, fermerët zakonisht mbeten të panjohur. Nuk ka shkëmbim të rregullt të informacioneve që janë të lidhur me ndryshimet klimatike, mundësitë për edukim, rregullore të reja etj., ose nëse ka, atëherë i ka vetëm nga njëra nga dy ministrinë. Këtu veçanërisht, duam të përmendim këtu faktin se prodhimi bujqësor është më i prekuri nga ndryshimet klimatike dhe nevojitet angazhim i përbashkët i të dyja ministrive, në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të të gjithë qytetarëve, por edhe aplikimit të masave që do të mbulojnë të gjithë sektorët që preken nga ndryshimet klimatike. Në 20 vitet e fundit, edhe sikur të flitej për ndryshimet klimatike, sfida mund të mos ishte marrë seriozisht, por tashmë jemi në një gjendje ku çdo hap dhe masë është e rëndësishme për të zbutur efektet. Sidomos vitet e fundit vendi ynë është prekur nga efektet e ndryshimeve klimatike, ndaj kemi ulje të ndjeshme të prodhimit bujqësor në rajone të caktuara dhe kjo ndikon në zhvillimin e qëndrueshëm si të politikave dhe masave komunitare ashtu edhe nacionale. Pikërisht për këtë nevojitet ndërhyrje e cila nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit mes ministrive do të ndikojë drejtpërdrejt në ndërgjegjësimin e qytetarëve, duke rritur kështu transparencën dhe llogaridhënien e dy ministrive në fushën e ndryshimeve klimatike. dhe në të njëjtën kohë do t'u jepet dhe informacion i mjaftueshëm qytetarëve në mënyrë që ata të përfshihen në proceset vendimmarrëse.

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Kur flitet për ndryshimet klimatike, të krijohet përshtypja se të dy ministrinë punojnë veçmas në vend që të ndërthurin kapacitetet, njohuritë dhe veprimin e tyre në terren. E njëjta gjë vlen edhe për rregullativën ligjore. Për shembull, u miratua Ligji për aksion klimatik në të cilin shoqatat bujqësore ose fermerët nuk konsultohen fare. Gjatë përgatitjes së raporteve, veçanërisht për shembull për Kapitullin 27, ndryshimet klimatike dhe efektet e tij merren vetëm nga aspekti i mjedisit jetësor, por jo nga aspekti i prodhimit bujqësor apo aktiviteteve dhe efekteve të tjera në sektor. Pikërisht për këtë është i nevojshëm avancimi i bashkëpunimit mes dy ministrive, si dhe avancimi i shkëmbimit të informacionit në fushën e ndryshimeve klimatike dhe kjo do të rrisë mundësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve si në procesin e vendimmarrjes dhe në fushën e zbatimit të legjislationit në lidhje me veprimin klimatik. Në të njëjtën kohë, do të përmirësohet niveli i ndërgjegjësimit, si dhe shpërndarja në kohë e informacionit për të gjitha palët e interesuara.

Përshkrim i angazhimit

1. Çfarë është bërë deri më tani për të zgjidhur problemin?

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka përgatitur edhe webfaqe të veçantë për rritjen e informimit të publikut në fushën e ndryshimeve klimatike <https://klimatskipromeni.mk/> por nuk është rasti me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Sepse informacionet tashmë ekzistojnë dhe publikohen për zgjidhjen e plotë të problemit propozohet angazhimi për rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet këtyre dy institucioneve.

2. Çfarë zgjidhje propozoni?

Propozohet formimi i grupi ndërsektorial midis dy ministrive, në të cilin do të jenë anëtarë edhe të gjithë palët e interesuara, si dhe koordinimi i dy web-faqeve të internetit të dy ministrive në pjesën e ndryshimeve klimatike dhe informacioni i rregullt për aktivitetet dhe takimet e dy grupeve sektoriale IPA brenda ministrive. Natyrisht, se jemi të hapur për masa dhe aktivitete të tjera që institucionet do të propozojnë, të cilat do të nënkuptojnë tejkalimin e këtij problemi dhe do të rrisin veprimin dhe koordinimin e përbashkët në fushën e ndryshimeve klimatike. Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet ministrive, si dhe hapja e një skede të veçantë në faqen e MBPEU, ku do të ndahen informacionet, si dhe mundësitë për edukim dhe përfshirje në zbatimin e rregullativës ligjore në fushën e ndryshimeve klimatike, do të kontribuojnë drejtpërdrejt në ndërgjegjësimin më të madh të qytetarëve, dhe drejt transparencës dhe llogaridhënies më të madhe të ministrive në fushën e ndryshimeve klimatike. Në të njëjtën kohë, hapja e grupeve të sektorit IPA në të dyja ministritë do të rritet dhe në nivel planifikimi do të ketë një koordinim më të madh kur bëhet fjalë për veprim në fushën e ndryshimeve klimatike.

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Në periudhë dyvjeçare do të arrijmë informim të rregullt dhe aktivitete të koordinuara ndërmjet dy ministrive në fushën e çështjeve klimatike, por edhe veprim të përbashkët në terren në bashkëpunim me komunat dhe organizatat e shoqërisë civile. Në këtë mënyrë do të rritet informimi i publikut të gjerë dhe palëve të interesuara për aktivitetet që do të ndërmerren në fushën e ndryshimeve klimatike dhe do të mundësohet një qasje dhe reagim i përbashkët i koordinuar ndaj efekteve të shaktuara nga ndryshimet klimatike në të gjithë sektorët që preken prej tyre. Në këtë mënyrë do të krijojmë një praktikë të re të shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve, por do të kontribuojmë edhe në një transparencë dhe bashkëpunim më të madh të institucioneve me qytetarët, si dhe në drejtim të zbatimit të rregullores që lidhet me ndryshimet klimatike.

Analizë e angazhimit

Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë angazhimi transparencën?	Angazhimi do të kontribuojë në rritjen e transparencës, si dhe në përmirësimin e aksesit të qytetarëve ndaj informacioneve dhe aktiviteteve që lidhen me ndryshimet klimatike. Njëkohësisht do t'i bëjë të dyja ministritë më të hapura dhe më transparente ndaj

	qytetarëve dhe në të njëjtën kohë do të rritet besimi i qytetarëve tek institucionet pasi të shohin investimet e përbashkëta të institucioneve në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së qytetarët në proceset që lidhen me reagimin e shtetit dhe institucioneve ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike dhe Agjendës së Gjellbër të shtetit.
2. Si do të ndihmojë angazhimi në nxitjen e llogaridhënies?	Angazhimi i tillë do ti hapë proceset e punës në fushën e ndryshimeve klimatike dhe në të njëjtën kohë do të mundësojë rritjen e mundësive për monitorimin e aktiviteteve të realizuara nga ana e qytetarëve. Nëpërmjet aksesit në informacione lidhur me ndryshimet klimatike, si dhe promovimit të bashkëpunimit dhe ndërveprimit të ndërsjellë ndërmjet këtyre dy institucioneve, qytetarët do të njihen rregullisht me proceset që po ndodhin në këtë fushë, të cilat janë të shumta, veçanërisht në fushën e miratimit të rregullativës ligjore dhe akteve nënligjore, që duhet ti zbatojnë qytetarët me mbështetjen e institucioneve, në mënyrë që të mundësohet lehtësimi i këtyre proceseve përmes zbatimit të angazhimit.
3. Si do të përmirësojë angazhimi pjesëmarrjen e qytetarëve në definimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	Përmes rritjes së informimit në fushën e ndryshimeve klimatike, do të krijohen edhe kushte që qytetarët dhe veçanërisht fermerët të përfshihen në proceset e vendimmarrjes dhe/ose zbatimin e rregullativës ligjore dhe akteve nënligjore. Njëkohësisht do të mundësohet përfshirja proaktive e qytetarëve në zbatimin e zgjidhjeve ligjore përmes edukimit, por edhe në pjesën e monitorimit të rezultateve të zbatimit të rregullimit ligjor në nivel shtetëror.

Planifikimi i angazhimeve				
<i>Arritjet</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Data e pritshme e përfundimit</i>	<i>Palët e interesuara</i>	
<i>5.21 Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet MBPEU dhe MMJPH</i>	Formimi i grupi ndërsektorial apo mekanizma tjetër që do të mundësojë komunikim të	janar 2026	Institucioni udhëheqës: MMJPH	
			<u>Mbështetje</u>	
			Spektori Publik	HBO Të tjerë

	rregullt ndërmjet institucioneve në fushën e ndryshimeve klimatike Përmbajtja e përcaktuar që do të publikohet rregullisht në portalet e dy ministrive në konsultim me grupet nënsektoriale të fermerëve në përbërje të MBPEU.		MMJPH MBPEU	Kualicioni Rural	/
<i>5.2.2 Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së MBPEU dhe MMJPH në fushën e ndryshimeve klimatike</i>	Është krijuar skedë e veçantë për ndryshimet klimatike në kuadër të MBPEU Realizohen të paktën 5 evente promovuese në bashkëpunim me ministritë dhe organizatat e shoqërisë civile për promovimin e skedës, si dhe krijimin e hallke mjeti për plotësimin e lajmeve dhe aktiviteteve nga ana e fermerëve dhe organizatave të shoqërisë civile. Numri i përcaktuar i vizitave në skedë për vitin 2025 si baseline për vitet e	janar 2026	MMJPH MBPEU	Kualicioni Rural	/

	ardhshme dhe numri i lajmeve të ndara çdo vit Skeda e promovuar e ndryshimeve klimatike në mediat sociale me mbështetjen dhe ndarjen e OJQ dhe Rrjetit Nacional Rural (rrjeti i OJQ--ve i krijuar nga MBPEU)				
--	---	--	--	--	--

PLANI AKSIONAR 2024-2026

I KUVENDIT NDAJ PARTNERITETIT PËR QEVERISJE TË HAPUR (OGP)

Partneriteti për qeverisje të hapur (PQH) është iniciativë vullnetare ndërkombëtare e cila bazohet në idenë se qeverisja e hapur është në dispozicion, përgjegjëse dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve. Ky partneritet unik i kombinon fuqitë e përfaqësuesve të pushteteve dhe shoqërisë qytetare që të promovojë qeverisje të hapur, pjesëmarrëse, inkluzive dhe të përgjegjshme.

Kuvendi e njohu rëndësinë e hapjes dhe transparencës së shtëpisë ligjvënëse. Informacionet parlamentare i përkasin publikut dhe kuptimi i shtëpisë ligjvënëse është të sigurojë hapje të të dhënave në mënyrë proaktive, në formë digjitale, sa të jetë e mundshme kjo gjë.

Kuvendi i përcaktoi qëllimet dhe prioritetet e veta strategjike në Planin aksional të Kuvendit për vitin 2024-2028, të miratuar më 31.08.2022. Planin strategjik ka 6 qëllime (parlament funksional, i hapur, digjital dhe i sigurt, diplomacia parlamentare dhe shërbim efikas).

Qëllimi i parlamentit të hapur i Planit strategjik, zhvillon prioritetet dhe aktivitete në lidhje me promovimin e kulturës së hapjes, përfshirjes së publikut dhe të grupeve të marginalizuara në shoqëri, reformë të kanalit të Kuvendit, Partneritet për qeverisje të hapur, komunikim me publikun dhe të dhëna të hapura.

Kuvendi u përfshi në PQH në vitin 2017 dhe që atëherë ka punuar dy plane aksionare 2018-2021 dhe 2021-2023.

Me Planin e ri aksionar 2024-2026 për PQH Kuvendi i propozon këto 4 angazhime të cilat janë përpiluar në këtë dokument:

- Regjistër i i trupave rregullatorë të themeluar nga Kuvendi
- Informimi i publikut nëpërmjet TV-Kanalit të Kuvendit
- Debat mbikëqyrës në Kuvend për zbatimin e PQH-së nacionale 2024-2026
- Karvanë parlamentarë - parlament mobil për komunikim të drejtpërdrejtë të deputetëve me qytetarët

Numri dhe emri i angazhimit	1. REGJISTËR I I TRUPAVE RREGULLATORË TË THEMELUAR NGA KUVENDI		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit.	Përveç funksionit legjislativ, mbikëqyrës dhe përfaqësues, Kuvendi ka një rol të madh edhe në krijimin e organeve, agjencive dhe trupave të ndryshëm rregullatorë, që janë drejtpërdrejt përgjegjës për punën e vet para ligjvënësit. Duke filluar nga themelimi, deri tek emërimi i personave drejtues në to, anëtarëve të bordeve mbikëqyrëse dhe/ose drejtuese, etj., miratimi i programeve të tyre vjetore të punës, planeve vjetore financiare e deri te monitorimi i punës së tyre dhe miratimi i raporteve vjetore të punës, Kuvendi ka rolin e vet në funksionimin e këtyre organeve. Aktet dhe dokumentet që këto organe ia dorëzojnë Kuvendit aktualisht janë në dispozicion si pika, përkatësisht materiale të pranuar në trupat përkatës punues dhe janë të disponueshme në sistemin e-parlamenti dhe ueb-faqen www.sobranie.mk. www.sobranie.mk. Me këtë angazhim dëshirojmë të bëjmë një listë të detajuar të këtyre organeve, të cilat tani menaxhohen nga zyrtarët si lista të ruajtura në nivel lokal në Komisionin për Zgjedhje dhe Emërime. Për këtë arsye, Kuvendi e njeh rëndësinë e bërjes së një inventarizimi plotësisht të aksesueshëm të këtyre organeve, fushave të veprimit, mandateve të drejtuesve dhe të gjitha dokumenteve shoqëruese që hyjnë dhe, pas procedurës së duhur, dalin nga Kuvendi në një formë të tillë që është publike, të aksesueshme, të kërkueshme, të digjitalizuara për përdorim dhe duke informuar qytetarët, organizatat e shoqërisë qytetare, institucionet akademike etj.		
Institucioni udhëheqës	Kuvendi		
Mbështetje nga palët e prekura	Sektori publik	Sektori joqeveritar	Të tjerë (Parlament, sektor privat, organizata ndërkombëtare etj.)
	Të gjitha organet që mund të jenë objekt i këtij përpunimi mund të kontaktohen nëse shfaqet një nevojë e tillë.	Instituti Parlamentar do ta marrë parasysh bashkëpunimin me organizata joqeveritare të cilat kanë raport profesionale dhe analiza mbi temën për një përpunim më gjithëpërfshirës të të dhënave.	Kuvendi me kapacitetin e vet do ta zbatojë këtë angazhim sipas dokumenteve dhe të dhënave që i ka në dispozicion.

Korniza kohore për angazhimin	16 muaj, 2024-2025
Përcaktimi i problemit	
1. Çfarë problemi adreson angazhimi? Procesi i afrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian kontribuoi shumë sfera ku kërkohet në mënyrë eksplicite organet dhe trupat të cilët do të vepronin në mënyrë të pavarur nga pushteti ekzekutiv në punën e vet. Kjo është e rëndësishme për ata sektorë dhe veprimtari që të çlirohen nga ndikimi në punën e tyre dhe çon kah formimit të një sfere të tërë rregullatore në shumë fusha të cilat janë drejtpërdrejt nën autoritetin e pushtetit ligjvënës, ku edhe shumica edhe opozita kanë rol t'i ndjekin dhe kontrollojnë në punën e tyre. Zbatimi i angazhimit siç përshkruhet do të sigurojë në mënyrë proaktive informacion për publikun në formë digjitale, cilët janë ata trupa dhe organe, cilët janë personat udhëheqës të emëruar, me çfarë mandatesh me set të plotë të dhënash rreth tyre. Me këtë pritet të zvogëlohet perceptimin e publikut për mënyrën se si ata punojnë, në kuptimin se puna e pavarur i referohet funksionimit dhe dhënies së shërbimeve dhe se të gjithë janë pjesë e hapësirës së vetme administrative në shtet që mbajnë përgjegjësi para autoritetit legjislativ sovran dhe qytetarëve. Mandej, do të informojë në kohë për ato vende drejtuese për të cilat është e detyrueshme publikim i shpalljes nga Kuvendi, në mënyrë që qytetarët ta dinë dhe mundësisht të interesuarit të mund të aplikojnë. Dhe në fund, redaktimi i një liste të tillë do të zvogëlojë kërkesat për akses në informacionin publik në përputhje me ligjin, nga kjo sferë në Kuvend, duke qenë se ky informacion do të jetë në dispozicion në mënyrë proaktive. Për një periudhë të gjatë kohore, në publik mungon informacioni për punën e organeve , komisioneve, agjencive, rregullatorëve të ndryshme etj. Mungesa e informacionit shpesh lidhet me një ngjarje publike ku media i quan këto autoritete dhe zhvillohet një diskurs publik për punën e tyre se janë të pavarur dhe në mënyrë implicite nuk mbajnë përgjegjësi para askujt. Pra, palët e interesuara janë qytetarët në kuptimin më të gjerë, por edhe veçanërisht organizatat profesionale kur kërkojnë informacion. E gjithë kjo lidhet indirekt me rolin mbikëqyrës të Kuvendit mbi këto organe dhe trupa, ku ai shfaqet si themelues.	
2. Cilat janë shkaqet e problemit? Shkaqet e problemit lidhen me komunikimin e legjislacionit të ri të miratuar në dy dekadat e fundit, i cili rezultoi me shumë organe dhe autoritete me kompetenca të ndryshme. Publiku dëshiron të dijë për këta trupa, emërimin e drejtuesve të tyre etj.	
Përshkrimi i angazhimit	
1. Çfarë është bërë deri më tani që të zgjidhet problemi? Informacionet mbi pikat e rendit të ditës për seancat e Kuvendit janë në dispozicion në ueb-faqen e Kuvendit www.sobranie.mk. Nëse kërkohet diçka tjetër në aspektin e trupave rregullatorë, kërkohet sipas seancave dhe pikave të rendit të ditës, ose në fusha për kërkim, por nuk mund të identifikohet një listë e vetme për të gjithë ta dhe informacione për të gjithë ta në një vend. Shtesë,	

Kuvendi ka portal të të dhënave të hapura ku si sete të dhënash ka shumë informacione por, këto konkretisht nga angazhimi i marë nuk janë pjesë e tij.

2. Çfarë zgjidhjeje propozoni?

Qasja te këto informacione të përcaktuara në angazhim mund të jetë lëndë e një regjistri të veçantë të të dhënave të tilla ku do të përshkruhen detajisht dhe do të jenë në dispozicion www.sobranie.mk. Alternativë, mund të jetë një pjesë e setit të të dhënave në portal për të dhëna të hapura <https://data.sobranie.mk/en/>. Flasin për forma digjitale të të dhënave sepse tani dhe të kemi listë të tërësishme nuk është publike dhe nuk është në një vend. Problemi do të zgjidhet tërësisht, sepse do të jepet një listë e tërësishme për gjithçka që ekziston. Te të dhënat mund ta arrihet direkt nga ueb-faqja, nuk është e domosdoshme që të kërkohet qasje tek informacionet publike

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Ekzistenca e një regjistri të detajuar para së gjithash do të mundësojë monitorim më të lehtë të mandateve të personave të emëruar dhe Kuvendi do të mund të shpallë thirrjet brenda afatit për emërime në pozitat të cilat skadojnë. Do të përmirësojë parashikueshmërinë dhe efikasitetin.

Mandej, qytetarët do të kenë një pasqyrë në kohë reale të asaj që ekziston, a janë ndërmarrë veprime në lidhje me detyrat e Kuvendit, pastaj çfarë informacioni dhe raportesh ofrojnë organet rregullatore.

Deputetët do të kishin informacion në kohë reale nëse do të shfaqej ndonjë situatë në publik dhe media, a është përgjegjës një autoritet i caktuar që mban përgjegjësi drejtpërdrejt Kuvendit dhe jo para pushtetit ekzekutiv etj.

Analiza e angazhimit

Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë ky angazhim transparencën?	Zbatimi i këtij angazhimi nënkupton përpunim të informacioneve të cilat qytetarët do t'i dinë në kohë reale, të cilat do të jenë elektronike, të kërkueshme dhe do të shpallen në bazë proaktive pa nevojë për kërkesë për qasje tek informacionet apo fjalimet në Kuvend.
2. Si do të ndihmojë ky angazhim në nxitjen e përgjegjësisë?	Me shpalljen e të dhënave, përmirësohet në mënyrë indirekte parashikueshmëria, sidomos nga aspekti i përfundimit të mandateve, procedurave dhe afateve për emërime të reja etj. Me këtë regjistër sigurohen drejtpërdrejt informacione për deputetët për zbatimin e të drejtave dhe detyrave të tyre kushtetuese.
3. Si do ta përmirësojë ky angazhim pjesëmarrjen e qytetarëve në	Zbatimi i angazhimit do të përfshijë organizata profesionale të cilat kanë analiza paraprake mbi këtë temë. Mandej në procesin e bashkëkrijimit dhe

përcaktimin, zbatimin dhe ndjekjen e zgjidhjeve?		konsultimit do të informohen indirekt mbi mundësitë e tjera të ueb-faqeve apo softuerëve të tjerë për informacione të tjera. Duke qenë regjistri transparent presim edhe më shumë interes te qytetarët në formë të idesë ligjvënëse apo pyetjes për propozuesin e autorizuar (deputetët).		
Planifikimi i angazhimit				
Arritje Njoftimi tremujor i koordinimit mbi skadimin e mandatit ose afatet për emërimin e mandateve të reja në trupat që i themelon Kuvendi. Krijimi i grupit të punës për përshkrimin e të gjitha trupave dhe organeve të themeluara nga Kuvendi si dhe emërimet e tjera. Zbatim i prokurimit publik nëse zgjidhja kërkon mjet të ri softuerik që të jetë i disponueshëm në faqen e internetit. Zbatimi i kontratës Digjitalizimi dhe shpallja në ueb-faqe.	Rezultate të pritura	Data e përfundimit Mars 2025	Palët e prekura Kuvendi	
			Institucioni udhëheqës: Kuvendi, me Institutin Parlamentar	
			<u>Mbështetja</u>	
			Spektori publik	OJQ, Institut i Të tjerë (p.sh. Parlament,

				demokratik nacional (NDI), Qendra për menaxhim me ndryshimet dhe Institut i për demokraci Societatis Civilis	sektori privat, organizatat ndërkombëtare)

Numri dhe emri i angazhimit	2. INFORMIMI I PUBLIKUT NËPËRMJET TV KANALIT TË KUVENDIT			
Përshkrim i shkurtër i angazhimit.	Kuvendi do ta vazhdojë reformën me funksionim të tërësishëm të Kanalit të Kuvendit. Informimi i opinionit nëpërmjet Kanalit të Kuvendit do të duhet të jetë cilësor, në kohë, i rregullt, i parashikueshëm, nëpërmjet përmbajtjeve të paeditueshme, transmetimeve të drejtpërdrejta dhe transmetimit të regjistrimeve nga seancat plenare dhe komisionet, këshillat dhe aktivitetet e tjera, por edhe nëpërmjet dizajnit dhe produksionit të përmbajtjes personale nga TV-studioja e Kuvendit. Qëllimi i përgjithshëm i këtij angazhimi është zmadhimi i shikueshmërisë së TV-kanalit ose informim i zmadhuar në mënyrë indirekte i opinionit për agjendën legjislative.			
Institucioni udhëheqës	Kuvendi			
Mbështetje nga palët e prekura	Sektori publik	Sektori joqeveritar	Të tjerë (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare etj.)	

	Radio-Televizioni Maqedonas	Instituti demokratik nacional (NDI), Qendra për menaxhim me ndryshimet dhe Instituti për demokraci Societas Civilis	Kuvendi në kapacitetin e vet do ta zmadhojë këtë angazhim.
Korniza kohore për angazhimin	2024 - 2026		
Përcaktimi i problemit			
1. Çfarë problemi adreson angazhimi? Komunikimi i pushtetit legjislativ me publikun nëpërmjet kanalit të tij televiziv është një zgjidhje klasike për të komunikuar me kamerë dhe me ton drejtpërdrejt ose me regjistrim. Në këtë kuptim, Kuvendi ka punuar në modernizimin e kanalit të Kuvendit, nëpërmjet ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për Kuvendin, me blerjen e pajisjeve moderne ku janë investuar 250 mijë euro dhe punësimin e një stafi profesional prej 7 personash. Zbatimi i këtij angazhimi do të mundësojë përmbajtjen personale dhe produksionin e një kanali televiziv funksional si mënyrë komunikimi e Kuvendit me një kategori qytetarësh që informohen për Kuvendin në këtë mënyrë (paralelisht me ueb-sajtin, rrjetet sociale apo artikujt nga mediat e televizioneve kombëtare). Modernizimi dhe digjitalizimi në shoqëri nëpër vite bëri ndryshim që qytetarët të informohen kryesisht nga televizionet nacionale, kurse shumë më pak nga TV-Kanali i Kuvendit për atë që ndodh në shtëpinë ligjvënëse. Sipas disa hulumtimeve ekziston një kategori e qytetarëve në moshë më madhore të cilët e ndjekin më shumë TV-Kanalin e Kuvendit, dhe një pjesë e popullatës më të re që informohen në mënyrë tjetër.			
2. Cilat janë shkaqet e problemit? Shkaqet për këtë janë mënyrat e lehta moderne për akses në tek informimi nëpërmjet televizioneve, kurse sidomos nëpërmjet portaleve në internet dhe lajmet që lidhen nga portalet me rrjetet sociale. Informimi i saktë është i rëndësishëm edhe për luftën me lajmet e rreme dhe informacionet e pjesshme dhe joobjektive. Rënia e shikueshmërisë së TV-Kanalit të Kuvendit lidhet edhe me cilësinë e emetimit e cila për shkak të mosinvestimit nëpër vite ka mbetur pas. Mungesa e programit personal si emisionet debatuese, lajmet ligjvënëse dhe të tjera e bëjnë këtë program jotërheqës kur nuk ka transmetim të drejtpërdrejtë të seancës apo xhirime nga trupat punues.			

Përshkrimi i angazhimit

1. Çfarë është bërë deri më tani që të zgjidhet problemi?

Ky angazhim është vazhdim i angazhimit nga plani aksional i mëparshëm i Kuvendit për PQV 2021-2023.

Pajisja e studios me mjete moderne për emetim ishte prioritet dhe sfidë që Shërbimi ta përshkruajë, zbatojë si projekt i cili përfshin edhe pajisje, edhe punë edhe hapësira.

Mandej, ishin të domosdoshme ndryshime në kornizën ligjore, dhe në atë kuptim u zbatuan plotësime të Ligjit për Kuvendin ku u përcaktua më adër puna dhe kompetencat. Programi vjetor i punës, plani vjetor mbi llojin dhe përmbajtjen e programeve, marrëdhënia me RTVM-në, plani financiar dhe plani investues, përgjegjësia redaktuese etj.

Puna në studio lidhet drejtpërdrejt edhe me personelin profesional, prandaj në Aktin e sistematizimit të Shërbimit të Kuvendit janë paraparë pozita të reja, kurse është shpallur edhe thirrje, dy herë, për 7 vendet vakante.

2. Çfarë zgjidhjeje propozoni?

Angazhimi i paraparë këtu do të mundësojë zhvillim të programit konkret të punës të Kanalit të Kuvendit, së bashku me formimin e Këshillit të Kanalit të Kuvendit i cili duhet t'i miratojë të gjitha dokumentet. Këshilli i Kanalit të Kuvendit është obligim ligjor se TV-kanalin e ligjvënësit e menaxhojnë bashkërisht edhe shumica edhe opozita. Në përputhje me Ligjin, Këshillin e udhëheq nënkryetari i Kuvendit nga radhët e opozitës, së bashku me deputetët e shumicës dhe të opozitës, përfaqësuesin e RTVM-së, por dhe mundësi për emërim të ekspertëve të jashtëm me të drejtë fjale pa të drejtë vote. Mandej do të duhet të zhvillohet përmbajtje për komunikim me publikun, e cila do të përpunohet në mënyrë të pavarur ose në koproduksion, duke përfshirë më shumë njësi organizative. Në këtë kuptim presim të zhvillohen lajmet ditore ligjvënëse, parashikimi i programit, brifingje ligjvënëse/përmbajtje të shkurtra multimediale me rol shpjegues për propozimet për teleshikuesit etj., emisione debatuese midis deputetëve etj.

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Rezultat i përgjithshëm i këtij angazhimi është zgjidhjet e propozuara të zbatohen dhe Kanali i Kuvendit të funksionojë. Rezultat indirekt duhet të jetë zmadhimi i shikueshmërisë së TV-Kanalit të Kuvendit. Mënyra se si informohen qytetarët ndiqet vazhdimisht nga Instituti për demokraci Societas Civilis në anketat dhe hulumtimet përkatëse, kurse ato të dhëna do të merren si relevante nëpër vite që të ndiqet trendi i shikueshmërisë. https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2022/07/A4_ENG-ANKETA-2022.pdf

Analiza e angazhimit

Pyetje	Përgjigje
1. Si do ta promovojë ky angazhim transparencën?	Zbatimi i këtij angazhimi do të nënkuptojë parashikueshmëri të agjendës ditore të Kanalit të Kuvendit (mundet edhe mujore).

	Në këtë mënyrë do të ofrohet paraprakisht kalendar për qytetarët e interesuar që ta ndjekin. Përmbajtja edukative do t'i edukojë qytetarët për pushtetin ligjvënës. Në emisionet debatuuese do të ballafaqohen qëndrime dhe argumente. Brifingu ligjvënës do të japë shpjegim të propozimeve.		
2. Si do të ndihmojë ky angazhim në nxitjen e përgjegjësisë?	Vetë prania në medie publike ndihmon për ndjenjën e përgjegjësisë për atë që bëhet dhe flitet. Zbatimi i këtij aktiviteti do të ndiqet drejtpërdrejt me cilësinë e programeve të TV-Kanalit të Kuvendit.		
3. Si do ta përmirësojë ky angazhim pjesëmarrjen e qytetarëve në përcaktimin, zbatimin dhe ndjekjen e zgjidhjeve?	Si pjesë e aktiviteteve programore, do të ketë dhe programe të shkurtra informative për qytetarët, si për shembull si të vijnë në Kuvend, si të paraqiten për ditën e hapur, si të paraqiten për pjesëmarrje në aktivitetet edukative (Parlamenti i Fëmijëve, Kam qëndrim!) etj.		
Planifikimi i angazhimit			
Arritje	Rezultate të pritura	Data e përfundimit	Palët e prekura
Formimi i Këshillit të Kanalit të Kuvendit			Kuvendi
Angazhimi i ekspertëve të jashtëm në Këshill		2024-2026	TVM
Miratimi i programit të punës		gjatë gjithë periudhës së këtij plani aksional	
Përpunimi i përmbajtjeve për emetim			
Ekipim dhe trajnim i kuadrit			
Angazhim i koproduksionit			
			Institucioni udhëheqës:
			Mbështetja

			Spektori publik Kuvendi, TVM	OJQ, Institut i demokratio natio nali (NDI), Qendra për menaxhim me ndryshimet dhe Institut i për demokratio Societati Civilis	Të tjerë (p.sh. Parlamenti , sektori privat, organizatat ndërkombëtare)

Numri dhe emri i angazhimit	3. DEBAT MBIKËQYRËS NË KUVEND PËR ZBATIMIN E PLANIT NACIONAL TË PQH-SË 2024-2026
Përshkrim i shkurtër i angazhimit.	Kuvendi është pushtet legjislativ në sistemin e organizimit të pushtetit shtetëror në vend dhe përfaqësuesi sovran i vullnetit të qytetarëve. Në përcaktimin e hapjes dhe transparencës së pushtetit legjislativ, Kuvendi ka qenë pjesë e Partneritetit për Qeverisje të Hapur që nga viti 2018, me një grup pune të posaçëm, një Plan aksional të veçantë me angazhime ndaj PQH-së dhe qasje ndaj monitorimit të jashtëm të zbatimit të aktiviteteve të planifikuara. Përveç kësaj, në kapacitetin e funksionit të tij legjislativ, Kuvendi mbështet të gjitha zgjidhjet ligjore që i propozojnë autoritetet e tjera, ekzekutivi dhe gjyqësori, për realizimin e angazhimeve të tyre PQH. Në fund, Kuvendi ka edhe funksion mbikëqyrës dhe në këtë kuptim është i interesuar të ndjekë plotësisht zbatimin e planit kombëtar PQH 2024-2026. Për këtë arsye Plani i aksional 2024-2026 parasheh mbajtjen e një debati mbikëqyrës në trupin përkatës punues.

Institucioni udhëheqës	Kuvendi		
Mbështetje nga palët e prekura	Sektori publik	Sektori joqeveritar	Të tjerë (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare etj.)
	Përfaqësuesit e pushteti gjyqësor dhe ekzekutiv, do të kenë obligim të marrin pjesë në debatin mbikëqyrës.	Përfaqësuesit e organizatave qytetare që janë pjesë e Këshillit të PQH-së, por edhe të interesuarit e tjerë dhe/ose të konsultuar në procesin e përgatitjes së Planit nacional PQH.	Mundësi për pjesëmarrje të përfaqësuesve zyrtarë të OGP për rajonin dhe Evropën.
Korniza kohore për angazhimin	Nëntor 2024-shkurt 2025		
Përcaktimi i problemit			
1. Çfarë problemi adreson angazhimi? Angazhimi duhet të stimulojë praktikim të rolit mbikëqyrës të parlamenteve, madje edhe në raport me zbatimin e PQH-së. Sipas Memorandumit për përfshirjen e parlamenteve të OGP-së rekomandohet që parlamentet të përfshihen edhe me mbikëqyrje të asaj që zbatojnë pushtetet e tjera. Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për programim të ciklit të pestë të Planit aksional me PQH, Kuvendi si pushtet ligjvënës në kapacitetin e vet kushtetues për mbikëqyrje të organeve të pushtetit ekzekutiv deri më tani nuk ka zbatuar debat mbikëqyrës. Plani nacional PQH është dokument i pushtetit ekzekutiv të cilin e propozon MSHIA-ja dhe e miraton Qeveria. I prekur nga ky angazhim është Kuvendi sepse nënkupton praktikim të kompetencave kushtetuese të pushtetit ligjvënës. Palë të tjera të prekura janë edhe të gjitha organet e pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor të cilat propozojnë masa në planin nacional PQH.			
2. Cilat janë shkaqet e problemit? Zbatimi i debatit mbikëqyrës duhet t’u japë llogari dhe informim deputetëve për zbatimin e aktiviteteve nga Plani nacional PQH. Mandej, vetë programimi i angazhimit të tillë jep parashikueshmëri edhe të debateve mbikëqyrëse në Kuvend. Domethënë, ligjvënësi në Ligjin për Kuvendin tashmë ka paraparë se në institutin			

koordinim, koordinatorët e partive politike me Kryetarin e Kuvendit bëjnë plan vjetor të debateve mbikëqyrëse në Kuvend.

Përshkrimi i angazhimit

1. Çfarë është bërë deri më tani që të zgjidhet problemi?

Kuvendi duke marrë parasysh se është përfshirë në PQH nëpërmjet planit personal aksional, në suazat e procesit të bashkëkrijimit të dokumentit është përfshirë në nivel të grupit të punës të përbërë nga deputetë, përfaqësues të partive parlamentare politike, të punësuar në Shërbimin e Kuvendit, organizatat qytetare partnere ndërkombëtare dhe qytetare. Mandej në lidhje me angazhimet konkrete ekzistojnë nëngrupe pune.

Domethënë në lidhje me Planin personal aksional të Kuvendit ai njihet dhe zbatohet.

Mbi parimet dhe natyrën e PQH-së, janë të informuar pjesërisht deputetët në suazat e ngjarjeve të ndryshme për promovim të aktiviteteve dhe të partneritetit. Grupi i punës informohet vetëm për Planin aksional të Kuvendit, kështu që koordinatorët ose deputetët nuk njihen në mënyrë të detajuar me angazhimet e pushteteve ose organeve të tjera.

2. Çfarë zgjidhjeje propozoni?

Angazhimi parashikon organizim të debatit mbikëqyrës në një nga trupat e punës, me të gjitha hapat e paraparë në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Debati mbikëqyrës do t'i informojë deputetët mbi faktin se çfarë bën shteti në lidhje me Planin nacional PQH, por, gjithashtu, edhe në formën e fjalimeve, dëshmitarëve do të mund të njihen me problemet, shkallën e realizimit, udhëheqësit e zbatimit.

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Rezultati i këtij angazhimi është i drejtpërdrejtë dhe indirekt.

Rezultatet e drejtpërdrejta janë përfshirja e pushtetit ligjvënës në kapacitetin e vet mbikëqyrës.

Informimi i deputetëve për PQH.

Rezultate indirekte janë parashikimi i përdorimit të institutit debat mbikëqyrës në Kuvend në lidhje me tema dhe politika të ndryshme.

Analiza e angazhimit

Pyetje

Përgjigje (nëse nuk është e zbatueshme, përgjigjuni vetëm me N/P)

1. Si do ta promovojë ky angazhim transparencën?

Në zbatimin e këtij angazhimi, debati mbikëqyrës është i hapur për publikun.

	Në mënyrë plotësuese do të transmetohet në TV-Kanalin e Kuvendit. Mediat do të kenë, gjithashtu, mundësinë që të marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Hapja publike e zbatimit të politikave e bën Parlamentin të angazhuar në ndjekjen e punës së pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor në pjesën e zbatimit të PQH-së.			
2. Si do të ndihmojë ky angazhim në nxitjen e përgjegjësisë?	Prania e publikut në debatet mbikëqyrëse shkakton interes të madh edhe tek deputetët. Informimi i deputetëve me informim të publikut dhe qytetarët mund të njihen drejtpërdrejt në mënyrë burimore për çfarë punohet.			
3. Si do ta përmirësojë ky angazhim pjesëmarrjen e qytetarëve në përcaktimin, zbatimin dhe ndjekjen e zgjidhjeve?				
Planifikimi i angazhimit				
Arritje Miratimi i vendimit për organizimin e debatit mbikëqyrës Përcaktimi i trupit punues për zhvillimin e debatit mbikëqyrës Përcaktimi i agjendës, të ftuarve, fjalimet e organeve të tjera Ftesë për mysafirë, media, OJQ dhe qytetarë	Rezultate të pritura	Data e përfundimit Shkurt 2025	Palët e prekura Kuvendi Qeveria Pushteti gjyqësor	
			Institucioni udhëheqës:	
			<u>Mbështetja</u>	
			Spektori publik Përfaqësues të	OJQ, Këshilli t Nacion

			pushteti ekzekutiv dhe gjyqësor	al për PQH	privat, organizata t ndërkombë tare)

Numri dhe emri i angazhimit	4. KARVANI PARLAMENTAR - parlament mobil për komunikim të drejtpërdrejtë të deputetëve me qytetarët		
Përshkrim i shkurtër i angazhimit.	Kuvendi rregullisht mban ditë të hapura dhe organizon vizita në objekt për qytetarët. Kjo kontribuon në procesin e përmirësimit të imazhit të institucionit dhe gradualisht ndërton perceptimin se Kuvendi është i hapur dhe transparent. Megjithatë, disa qytetarë për arsye të ndryshme, moti, praktike apo ekonomike, nuk mund të udhëtojnë në Shkup dhe të vizitojnë ndërtesën e Kuvendit. Me organizimin e karvanit të propozuar, partnerët institucionalë dhe civilë do ta bëjnë Kuvendin “të lëvizshëm”.		
Institucioni udhëheqës	Kuvendi		
Mbështetje nga palët e prekura	Spektori publik	Spektori joqeveritar	Të tjerë (Parlamenti, sektori privat, organizatat ndërkombëtare etj.)
	Njësitë e vetëqeverisjes lokale Zyra për kontakt të qytetarëve me deputetët	Organizatat lokale joqeveritare	Shkollat, fakultetet në njësitë e vetëqeverisjes lokale
Korniza kohore për angazhimin	2024 - 2026 Aktiviteti do të realizohet një herë në vit.		
Përcaktimi i problemit			
1. Çfarë problemi adreson angazhimi?			

Qëllimet kryesore të karvanit janë prezantimi i Kuvendit si një institucion i hapur, i përgjegjshëm dhe transparent, si dhe afrimi i tij me qytetarët që nuk kanë mundësi ta vizitojnë objektin.

Disa nga objektivat kryesore do të jenë:

- edukative: dhe të rriturit, të rinjtë dhe fëmijët do të dëgjojnë informacione rreth proceseve ligjvënëse, mbikëqyrëse dhe të tjera
- promovuese: Takimet për karvanin do të jenë zyrat e kontaktit të deputetëve për të qenë më të dukshëm për qytetarët
- informative: Vizitorët e karvanit do të njihen me nismat e transparencës, si ueb faqja e re e Kuvendit, TV studio dhe kanali, Instituti Parlamentar etj.
- Zmadhim i dukshmërisë: karvani do të jetë gjithashtu një mundësi për të promovuar më tej transparencën dhe rolet mbikëqyrëse të Parlamentit
- “Karvani mobil parlamentar” parashikohet si një fushatë më e gjerë komunikimi dhe për të maksimizuar shikueshmërinë dhe arritjen e tij tek qytetarët, do të kërkojë një slogan (mesazh kyç) dhe një identitet vizual.
- Identiteti vizual do të zhvillohet në një fazë të mëvonshme të procesit të përgatitjes, ndërkohë që në këtë pikë, është thelbësore të përcaktohet mesazhi kryesor i fushatës, i cili do të shërbejë edhe si slogan i karvanit dhe do të përcillet në të gjithë elementët mbështetës.
- Konkretisht, sugjerimi është që slogani të jetë i thjeshtë, i qartë dhe efektiv, i ngjashëm me sloganin

Fushata "Kuvendi i Pavarur" - dhe të ndërliken disa pjesë të mesazheve kryesore nga ato aktivitete, në mënyrë që të ketë vazhdimësi.

- Slogani/mesazhi kyç i propozuar për "Karvanin mobil parlamentar" është:

“Kuvendi për qytetarët” është një mesazh shumë i thjeshtë dhe i qartë që të gjithë mund ta kuptojnë

- Me të, ideja është që të nënvizohet se Kuvendi ekziston për qytetarët, për të përfaqësuar nevojat e tyre, për t'u angazhuar në një debat demokratik me ta për të hartuar zgjidhje ligjore që do të përmirësojnë jetën në afat të shkurtër dhe afatgjatë.
- Nëntitulli “I hapur dhe i përgjegjshëm” (I hapur dhe i përgjegjshëm) do të thotë se Kuvendi është i hapur (po aq edhe transparent) dhe se si institucion është i përgjegjshëm ndaj qytetarëve.
- Përdorimi i “përgjegjshëm” (përgjegjës) do të lidhet me nëntitullin e fushatës së Kuvendit të Pavarur që ishte 'Për qeverisjen përfaqësuese dhe të përgjegjshme'

2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Pushteti ligjvënës, parlamentet në botë si dhe Kuvendi janë publikë në punën e tyre dhe të ekspozuar çdo ditë ndaj opinionit dhe njohurive të publikut, të paktën për sa i përket agjendës ligjvënëse. Për këtë arsye, perceptimet e qytetarëve kanë të bëjnë kryesisht me ngjarjet publike të deputetëve, zgjidhjet e propozuara ligjore, debatin dhe argumentet e zhvilluara etj. Në përgjithësi, deputetët punojnë në Shkup, edhe pse vijnë nga 8 njësi zgjedhore dhe nga shumë komuna të shtetit.

Nëse e kemi parasysh angazhimin me komisione dhe seanca plenare dhe punën në Shkup, mbetet vetëm dita e premte e javës për kontakt me ata që i votuan deputetët në mënyrë që të shkëmbejnë ide dhe të dëgjojnë nevojat e qytetarëve.

Angazhimi i paraparë do ta zmadhojë kohën e komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët

Përshkrimi i angazhimit

1. Çfarë është bërë deri më tani që të zgjidhet problemi?

Karvani parlamentar në formë eksperimentale u realizua në vitin 2022, si pjesë e PSP-së, program në bashkëpunim me IND-në.

Për të mos mbetur një aktivitet i njëhershëm dhe për hir të interesit të deputetëve dhe qytetarëve, angazhimi i propozuar përpiket ta vendosë atë si aktivitet të rregullt me kurrikulë të përcaktuar të punës.

2. Çfarë zgjidhjeje propozoni?

Karvani parlamentar do të mbahet në të gjitha qytetet ku ka Zyra për kontakt të qytetarëve me deputetët.

Në secilën prej këtyre pikave, një furgon i Kuvendit me të punësuarit e Institutit Parlamentar dhe Shërbimit të Kuvendit dhe/ose deputetë do të udhëtojnë duke mbajtur pajisjet e nevojshme për të vendosur pikën "Parlamenti mobil" - në varësi të lokacioneve ose në mënyrë të drejtpërdrejtë do të shfrytëzohen zyrat e deputetit ose hapësira para ose shumë afër tyre.

Furgoni do të mbajë set të:

- baner të brenduar dhe mbajtëse altoparlanti
- konfigurim të vogël audio dhe video (PA, mikrofonë, TV për prezantim)
- karrige mobile (maksimum 20)
- materiale promovuese të shtypura të Institutit Parlamentar

Në lidhje me përmbajtjen, kohëzgjatja e gjithë takimit do të jetë rreth 60 minuta dhe do të përfshijë:

- vërejtje të moderatorit
- fjalim të deputetit lokal
- prezantim edukativ të proceseve në Kuvend nga përfaqësues të IP,
- prezantim të aktiviteteve në lidhje me transparencën (ueb faqen, TV studion, sigurinë)
- sesion me moderim për pyetje dhe përgjigje

3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë me zbatimin e këtij angazhimi?

Me zbatimin e këtij angazhimi do të sigurohet prania e deputetëve në komunat e tyre zgjedhore, do të promovohet puna e tyre dhe e Kuvendit, do të dëgjohen përshtypjet e qytetarëve nga puna e tyre

dhe problemet që kërkojnë nismë legislative, sqarimi i kompetencave të deputetëve ndaj pyetjeve dhe problemeve që janë në kompetencë të pushtetit ekzekutiv ose të vetëqeverisjes lokale.

Analiza e angazhimit			
Pyetje		Përgjigje	
1. Si do ta promovojë ky angazhim transparencën?		Transparenca me zbatimin e këtij angazhimi do të jetë qasja e drejtpërdrejtë e qytetarëve. Me praninë e deputetëve, asistentëve në zyrat e tyre për kontakt me qytetarët, mundësohet shikueshmëri më e madhe e sistemit për nevojat e qytetarëve.	
2. Si do të ndihmojë ky angazhim në nxitjen e përgjegjësisë?		Ekspozimi i drejtpërdrejtë i mendimeve, ideve dhe kritikave të qytetarëve rrit përgjegjësinë e deputetëve për atë që bëjnë para atyre që i kanë zgjedhur.	
3. Si do ta përmirësojë ky angazhim pjesëmarrjen e qytetarëve në përcaktimin, zbatimin dhe ndjekjen e zgjidhjeve?		Realizimi i angazhimit do të rezultojë me përshkrim të plotë në formë të raportit për të gjitha vërejtjet dhe idetë e qytetarëve.	
Planifikimi i angazhimit			
Arritje	Rezultate të pritura	Data e përfundimit	Palët e prekura
Miratimi i vendimit të koordinimit për realizimin e aktivitetit		Në planin e propozuar varësisht nga obligimet e vitit zgjedhor, indikatori vendoset një herë në vit (minimum dy e maksimum 3 ngjarje)	Kuvendi Deputetët Shërbimi i Kuvendit Njësitë e vetëqeverisjes lokale Zyra për kontakt të qytetarëve me deputetët
Informimi i të gjitha grupeve të deputetëve dhe i deputetëve			
Organizimi i grupit të punës të Institutit Parlamentar dhe i Shërbimit të Kuvendit për realizimin e ngjarjeve			
Përcaktimi i agjendave, korniza kohore, resurset			
			Institucioni udhëheqës:

			<u>Mbështetja</u>		
			Spektori publik BNJVL, njësitë e vetëqeveris jes lokale, shkolla lokale	OJQ,	Tjetër (p.sh. Parlamenti , sektori privat, organizata t ndërkombë tare)

PLANI AKSIONAR PËR GJYQËSOR TË HAPUR 2024 – 2026

1. Hyrje

Republika e Maqedonisë së Veriut është pjesë e Partneritetit të Hapur Qeveritar nga viti 2011 me deri tani katër plane të zbatuara aksionare për rritjen e transparencës dhe qasjen e institucioneve shtetërore. Përmes qasjes vullnetare në iniciativën globale për Partneritet të Hapur Qeveritar, Republika e Maqedonisë së Veriut konfirmoi angazhimin e saj që vazhdimisht të përmirësohet dhe puna e saj të bazohet në institucione efikase qeveritare të sigurta, të hapura dhe transparente, që komunikojnë dhe bashkëpunojnë me qytetarët.

Në dekadat e kaluara, shteti vazhdimisht punon për përmirësimin e efikasitetit në punën e institucioneve shtetërore, rritjen e transparencës dhe qasjen në informacionet, luftën kundër korrupsionit dhe sigurimin e shërbimeve cilësore publike për qytetarët dhe bizneset përmes përdorimit të fuqisë së teknologjisë dhe inovacioneve.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut iu bashkua iniciativës për Partneritet të Hapur Qeveritar në vitin 2018 në kuadër të Planit aksionar 2018 – 2020, ndërsa nga ky vit, në Planin e pestë aksionar nacional (2021 – 2023), përfshihet edhe gjyqësori me angazhime konkrete dhe masa për përmirësimin e transparencës dhe qasjes në gjykatat dhe kthimin e besimit të publikut në institucionet gjyqësore.

1.1 Gjyqësor i hapur

Plani i parë aksionar për Gjyqësor të Hapur u zhvillua në diskutime të gjëra në mes të kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve dhe përfaqësuesve të shërbimit gjyqësor nga të gjitha gjykatat në RMV, përfaqësues nga Këshilli gjyqësor, Ministria e Drejtësisë, Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publik dhe përfaqësues të shoqërisë civile (organizata monitoruese). Konsultimet me përbërje të përzier u zbatuan në periudhën janar – mars 2020 dhe përfshin pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të Koordinatorit nacional për PQH dhe ekspertë tjerë të kësaj fushe për të afruar konceptin e Të dhënave të hapura në vet institucionet dhe organizatat. Idetë dhe nevojat e institucioneve dhe sektorit civil të diskutuara në themel në tryezat e rrumbullakëta, u transformuan në formë të Planit të parë aksionar për gjyqësor të hapur.

Institucione udhëheqëse për zbatimin e Planit aksionar janë Gjykata Supreme, Këshilli gjyqësor dhe Akademia për gjyqtarë dhe Prokurorë publik, ndërsa plani parashikon aktivitete në dy fusha primare:

- Qasjen në informacionet dhe të dhënat dhe
- Performansa.

Është paraparë që aktivitetet të realizohen përmes 6 angazhimeve që synojnë: Përmirësimin e portalit elektronik gjyqësor të RMV, Përmirësimin e marrëdhënieve me publikun të gjykatave, Përmirësimin e cilësisë dhe qasjes së të dhënave dhe informacioneve për funksionimin e Këshillit gjyqësor, Përforcimin e rolit mbikëqyrës të Këshillit gjyqësor ndaj transparencës së gjykatave, Unifikimin e strukturës së raporteve të gjykatave dhe cilësisë së të dhënave dhe Përmirësimin e sistemit elektronik për trajnim themelor në vazhdimësi të gjyqtarëve. Aktivitetet është parashikuar që të realizohen në një periudhë kohore 2021 – 2023 për të cilën do të krijohet edhe një mekanizëm për monitorimin e përparimit të Planit aksionar për Gjyqësor të Hapur 2021 – 2023.

Angazhimet e Planit aksionar për Gjyqësor të Hapur 2021 – 2023 nuk u realizuan plotësisht për shkak se të njëjtat janë paraparë në Planin e ri aksionar për Gjyqësor të Hapur 2024-2025 për shkak të aktualitetit të tij dhe rëndësisë për hapjen e gjyqësorit dhe institucioneve gjyqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

1. QASJA NË INFORMACIONET DHE NË TË DHËNAT

1.1 PËRMIRËSIMI I PORTALIT ELEKTRONIK GJYQËSOR TË RMV (WWW.SUD.MK)

(1 Shkurt 2024 – 31 Dhjetor 2025)

Cila çështje trajtohet me angazhimin?

Vendosja e Portalit elektronik gjyqësor të RMV (www.sud.mk) në vitin 2017 pritej të kontribuonte në një transparencë më të madhe të gjykatave, por ka ende dallime të mëdha midis cilësisë dhe vëllimin e të dhënave në dispozicion të gjykatave. Informacionet të cilat publikohen në ueb - faqet për çdo gjykatë nuk janë të unifikuara, nuk publikohen dhe nuk përditësohen rregullisht dhe jo të gjitha informacionet publikohen në format të hapur. Për shembull raportet e gjykatave dhe biografitë e gjyqtarëve nuk janë të unifikuara, dhe as nuk mund të gjenden të gjitha në ueb faqet dhe në disa raste janë të paqarta. Mos konsekuenca gjatë publikimit seleksionues së të dhënave çon në dyshimin për fshehjen e të dhënave që publikohen, gjë që ndikon drejtpërdrejtë në besimin e qytetarëve në gjyqësorin si degë e tretë e pushtetit në vend. Për më tepër, gjykatat nuk janë pro aktive në ndarjen e informacioneve lidhur me gjendjen e pronës së gjyqtarëve, kështu që te biografitë e gjyqtarëve nuk janë në dispozicion lidhjet në faqen e KSHPK, në të cilën janë publikuar gjendjet pronësore për secilin gjyqtar. Jo të gjitha gjykatat i kanë të publikuara të dhënat për informacionet me karakter publik të cilat duhet të jenë në dispozicion (personi për informacionet me karakter publik, E-mail/telefoni), dhe nuk ka praktikë të rregullt për publikimin e të dhënave të cilat veç më ndonjë i ka kërkuar me qasjen në informacionet me karakter publik. Çiltërsia është e nevojshme për të rritur besimin e publikut ndaj gjyqtarëve, gjykatave dhe tërë

	<i>sistemit gjyqësor si dhe për të kuptuar publiku atë se kush dhe në ç' mënyrë realizohet drejtësia nga gjykatat. Në këtë mënyrë, hapja është një nga komponentët kryesor të legjitimitetit të procesit gjyqësor dhe arsyeja nga e cila publiku ka besim në punën dhe vendimet e gjykatave. Portali gjyqësor nuk është i përshtatur për përdorimin e shfrytëzuesve me shikim të dëmtuar.</i>
Qëllimi kryesor i angazhimit	<i>Mundësimi i të dhënave dhe informacioneve të standardizuara dhe të unifikuara për gjykatat dhe praktikën gjyqësore dhe rritja e numrit së të dhënave në format të hapur lidhur me gjyqësorin.</i> <i>Zgjerimi për vëllimin e të dhënave në dispozicion në format të hapur të portalit.</i> <i>Rritja e vëllimit dhe përmirësimi i cilësisë për të dhënat dhe informacioneve të cilat publikohen.</i>
Si do të kontribuojë angazhimi në zgjidhjen e një çështje publike?	<i>Vëllimi i shtuar, cilësia e përmirësuar dhe përditësimi i rregullt i të dhënave që janë pjesë e portalit gjyqësor çon në futjen e një praktike të re në gjyqësorin maqedonas që imponon punë transparente dhe të përgjegjshme, por mbi të gjitha të dukshme të gjykatave për qytetarët e RMV.</i>
Pse është i rëndësishëm ky angazhim për vlerat e PQH?	<i>Ky angazhim mundëson qasjen në disa informacione, përmirëson cilësinë e të dhënave dhe e përmirëson qasjen në informacionet për publikun që tregon se angazhimi është i rëndësishëm për transparencën.</i>

Informacione shtesë			<i>Lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme”</i> <i>Target 16.6: Të zhvillohen institucione transparente, efektive dhe të përgjegjshme në të gjitha nivelet.</i> <i>Target 16.10 Të sigurohet qasja në informacionet me karakter publik dhe mbrojtja e lirive themelore, në pajtim me legjislacionin kombëtar dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.</i> <i>Ky angazhim do të kontribuojë në përmirësimin e përgjegjësisë publike të të gjithë faktorët në gjyqësor nëpërmjet përmirësimit dhe rritjes së vëllimit dhe cilësisë së të dhënave të portalit gjyqësor.</i>		
Nr.	Arritje	Indikatorë	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
	1.1.1 Përcaktimi i katalogut për të dhënat e hapura dhe cilësia dhe vëllimi i standardizuar sipas praktikës së mëparshme të publikimit të informacioneve në portalin gjyqësor, kërkesat për qasje në informacionet me karakter publik dhe analizat tanimë në dispozicion për transparencë dhe gjyqësor të hapur.	Numri i zvogëluar i kërkesave të arritura për qasje në informacionet me karakter publik në gjykatat e RMV	Gjykata Supreme e RMV, Qendra për hulumtime dhe analiza juridike	02.2024	06.2024
	1.1.2 Përgatitja e vlerësimeve individuale mbi përshtatjen e katalogut të përcaktuar i të dhënave të hapura dhe cilësia e standardizuar dhe vëllimi i informacioneve për çdo gjykatë.	Numri i zvogëluar i kërkesave të arritura për qasje në informacionet me karakter publik në gjykatat e RMV	Gjykata Supreme e RMV, Qendra për hulumtime dhe analiza juridike	07.2024	12.2024
	1.1.3 Zbatimi i përmirësimeve të domosdoshme dhe publikimi i të dhënave të hapura dhe informacionet me cilësi të standardizuar në përputhje me vlerësimet e bëra për çdo gjykatë veç e veç.	Ueb portali me informacionet dhe të dhënat e standardizuara për publikun	Gjykata Supreme e RMV, Qendra për hulumtime dhe analiza juridike	01.2025	03.2025

1.1.4	Përmirësimi dhe përshtatja e përmbajtjes së portalit gjyqësor për shfrytëzimin e personave me shikim të dëmtuar, duke mundësuar versione audio të mendimeve juridike parimore, mendimeve juridike dhe sentencave të Gjykatës Supreme të RMV.	Mjet i futur për të krijuar tekstin – speech (tekstin në të folur) në ueb faqen e GJSRMV	Gjykata Supreme e RMV, Qendra për hulumtime dhe analiza juridike	03.2025	12.2025
			Angazhim nga plani i mëparshëm		
Institucion udhëheqës i zbatimit			Gjykata Supreme e RMV		
Emri i personit përgjegjës në agjencinë për zbatimin			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Funksioni, Njësia			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Email			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Telefoni			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Subjekte tjera që përfshihen		Ministritë qeveritare, njësitë/agjencitë	Të gjitha gjykatat në RMV, Këshilli gjyqësor i RMV		

	Organizatat civile, sektorë privat, grupe punuese dhe multilaterale	<i>Shoqata e gjyqtarëve, Shoqata e administratës gjyqësore, Qendra për hulumtime dhe analiza juridike, Gjithëpërfshirëse</i>
--	--	--

1.2 PËRMIRËSIMI I MARRËDHËNIEVE PUBLIKE TË GJYKATAVE	
(1 Shkurt 2024 – 31 Mars 2025)	
Cila çështje publike adresohet me angazhimin?	<i>Në kuadrin institucional dhe të praktikuarit e hapjes dhe transparencës së vërtetë të gjykatave, paraqiten shumë çështje dhe sfida. Gjykatat, nuk kanë resurse, por as shumë njohuri për t'i plotësuar normat relevante të Rregullores gjyqësore për marrëdhënie me publikun. Gjyqtarët nuk përgatiten rregullisht për të komunikuar me publikun në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes konferencave për shtyp, intervistave, mediumeve elektronike dhe të ngjashme. Është e nevojshme që të ripërtërihet linku përkatësisht lidhshmëria e gjykatave me mediumet për tu kthyer besimi i publikut në gjyqësorin dhe në organet e gjyqësorit.</i>
Qëllimi kryesor i angazhimit	• Përmirësimi i komunikimit aktiv dhe transparencës së gjykatave me publikun • Futja e një kornize gjithëpërfshirëse sipas të cilës gjykatat do të komunikojnë me publikun dhe mediumet • Përpunimi i Strategjisë për gjyqësor të hapur • Zhvillimi i bashkëpunimit me Këshillin për mediumet-gjyqësore

Si do të kontribuojë angazhimi në zgjidhjen e një çështje publike?			Nëpërmjet realizimit të këtij angazhimi vendosen udhëzime afatgjate për përmirësimin e transparencës dhe hapjes së gjyqësorit përmes vendosjes së Metodologjisë për komunikim me publikun.		
Pse është i rëndësishëm ky angazhim për vlerat e PQH?			Angazhimi mundëson qasjen në më shumë informacione, përmirëson cilësinë e të dhënave dhe përmirëson qasjen në informacionet për publikun që tregon se angazhimi është i rëndësishëm për transparencën me të cilën do të jetë më e përafërt për qytetarët edhe puna e gjykatave përmes informimit me kohë.		
Informacione shtesë			Lidhje me Qëllim 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme” Target 16.6: Të zhvillohen institucione transparente, efektive dhe të përgjegjshme në të gjitha nivelet. Target 16.10 Të sigurohet qasja në informacionet me karakter publik dhe mbrojtja e lirive themelore, në pajtim me legjislacionin kombëtar dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky angazhim do të kontribuojë në rritjen e hapjes së gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet ndarjes së rregullt të informacioneve me mediumet dhe me publikun.		
Nr.	Arritja	indikatorë	Bartës të aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
	1.2.1 Përgatitja e Metodologjisë dhe/ose udhëzimeve sipas të cilave gjykatat do të komunikojnë me publikun dhe mënyrat e informimit të saj për përfshirjen e disa temave siç është përgatitja e raporteve vjetore, përgatitja e planeve vjetore, si dhe një format në të cilin ato do të publikohen.	Metodologji të miratuar dhe rregulla tjera (Udhëzues, Rregullore) për komunikimin e gjykatave të RMV me publikun	Gjykata Supreme e RMV	02.2024	06.2024

	1.2.2 Realizimi i takimeve konsultative me mediumet dhe me persona tjerë si shfrytëzues të drejtpërdrejtë të Metodologjisë	Metodologji të miratuar dhe rregulla tjera (Udhëzues, Rregullore) për komunikimin e gjykatave të RMV me publikun	Gjykata Supreme e RMV	04.2024	06.2024
	1.2.3 Përgatitja dhe vendosja e një Udhëzuesi/Drejtues/Rregullor e për marrëdhënien e gjyqësorit me mediumet.	Metodologji të miratuar dhe rregulla tjera (Udhëzues, Rregullore) për komunikimin e gjykatave të RMV me publikun	Gjykata Supreme e RMV	07.2024	10.2024
	1.2.4 Përpunimi i Strategjisë për gjyqësor të hapur si dokument 5-vjeçar të shoqëruar me Planin aksionar, ashtu që do të jenë të sistematizuara të gjitha përpjekjet për rritjen e transparencës dhe çiltërsinë gjithëpërfshirëse	Strategji të miratuar për gjyqësor të hapur nga KGJRMV	Këshilli gjyqësor i RMV	09.2024	03.2025
			<i>Angazhim nga plani i mëparshëm</i>		
Institucion udhëheqës i zbatimit			<i>Theksoni institucionin që ju e njihni si potencialisht kompetent për zbatimin e angazhimit</i>		
Emri i personit përgjegjës në agjencinë e zbatimit			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Funksioni, Njësia			Plotësohet nga institucionet kompetente në		

		fazën e mëvonshme
Email		Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme
Telefoni		Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme
Subjekte tjera që përfshihen	Ministritë qeveritare, njësitë/agjencitë	<i>Të gjitha gjykatat e RMV,</i>
	Organizata civile, sektorë privat, grupe punuese dhe multilaterale	<i>Shoqata e gjyqtarëve, Këshilli gjyqësor për medime, Qendra për hulumtime dhe analiza juridike</i>

1.3 PËRMIRËSIMI I CILËSISË DHE QASJA NË TË DHËNAT DHE INFORMACIONET PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT GJYQËSOR

(1 Shkurt 2024 – 31 Dhjetor 2025)

Cila çështje publike adresohet me angazhimin?	<i>Këshilli gjyqësor i RMV ka rol të dyfishtë kur bëhet fjalë për transparencën e sistemit gjyqësor. Në njërin anë ka rolin aktiv, përkatësisht duhet të monitorojë transparencën dhe çiltërsinë e gjyqësorit. Në anën tjetër paraqitet si subjekt pasiv që duhet të plotësojë obligime ligjore për të arritur transparencën.</i> <i>Ligji për Këshillin gjyqësor të RMV parashikon obligime për Këshillin që në ueb faqen e tij detyrueshëm të publikojë të dhënat</i>
---	---

	<i>rreth: zgjedhjes së anëtarëve të tij (neni 14 dhe neni 25), raportet e përpunuara tremujore dhe vjetore për punën e gjyqësorit (neni 36, paragrafi (1), pika 14), procesverbalet e seancave të tij (neni 39), vendimet e miratuara në procedurën e përsëritur (neni 72, paragrafi (5), raportet e tij vjetor.</i> <i>Sipas disa analizave më të reja, qasja në Këshillin gjyqësor të RMV vlerësohet dobët, përkatësisht konstatohet se Këshilli gjyqësor nuk ka burime të mira për komunikimin me qytetarët dhe me mediumet. Nuk ka udhëzues për paraqitjen e ankesave dhe parashtresave nga qytetarët nëpërmjet ueb portalit dhe nuk ka udhëzues për mediumet. Obligimet e Këshillit gjyqësor që rezultojnë nga supozimet e qytetarëve janë të rregulluara me Ligjin për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, në ueb faqen e Këshillit gjyqësor nuk mund të gjinden kurrfarë informacione mbi parashtrimin ose përgjigje ndaj parashtresave nga qytetarët e RMV.</i> <i>Parimi i transparencës është gjithashtu në nivel të ulët ngase përveç notave të mira sa iu përket informacioneve në dispozicion për strukturën organizative, vlerësohet se nuk ka politika për prokurime dhe nuk publikohen informacione lidhur me prokurimet publike të realizuara.</i> <i>Këshilli gjyqësor është posedues i informacioneve sipas Ligjit për qasje të lirë. Kjo do të thotë se ai është i detyrueshëm që t'i plotësojë detyrat që rezultojnë nga ky Ligj.</i>
Qëllimi kryesor i angazhimit	<i>Qasja e rritur dhe cilësia e informacioneve me të cilat disponon Këshilli gjyqësor, dhe lehtësim i qasjes te qytetarët për parashtrimin e parashtresave në Këshillin.</i> <i>Standardizimi i cilësisë dhe vëllimi i</i>

			të dhënave që doemos duhet t'i publikojnë gjykatat. • Vendosja e standardeve dhe mënyra për publikimin e të dhënave në ueb-faqen e Këshillit gjyqësor. • Qasje më të lehtë për parashtrimin e ankesave dhe parashtrësive nga qytetarët përmes ueb-faqes së Këshillit gjyqësor të RMV. • Përmirësimi i funksionimit të ueb-faqes së Këshillit gjyqësor të RMV.		
Si do të kontribuojë angazhimi në zgjidhjen e një çështje publike?			Angazhimi ndikon drejtpërdrejtë në qasjen e informacioneve, përgjegjësinë e institucioneve por edhe në pjesëmarrjen e publikut në punën e gjykatave nëpërmjet mundësisë të standardeve dhe procedurave për publikimin e të dhënave dhe vendosjen e mjeteve për parashtrimin e ankesave dhe parashtrësive nga qytetarët e RMV.		
Pse është i rëndësishëm ky angazhim për vlerat e PQH?			Angazhimi mundëson përmirësimin e kornizës juridike dhe mekanizmave të përgjegjësisë, ashtu që vet angazhimi është i rëndësishëm për përgjegjshmërinë publike në gjyqësor.		
Informacione shtesë			<i>Lidhje me Qëllim 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme”</i> <i>Target 16.6: Të zhvillohen institucione transparente, efektive dhe të përgjegjshme në të gjitha nivelet.</i> <i>Ky angazhim do të kontribuojë në rritjen e hapjes së Këshillit gjyqësor të RMV nëpërmjet përmirësimit të cilësisë dhe dispozicionin e të dhënave dhe informacionet për punën e tij.</i>		
Nr.	Arritja	indikatorë	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit

	1.3.1 Përcaktimi i katalogut i të dhënave sipas praktikës së mëparshme, historiku i kërkesave për qasje të lirë në informacionet me karakter publik dhe konsultimet e mbajtura.		Këshilli gjyqësor i RMV	02.2024	06.2024
	1.3.2 Përgatitja e procedurave standarde operative dhe përcaktimi i hartave të procesit për publikimin e të dhënave në ueb-faqen e Këshillit gjyqësor	Numri i zvogëluar i kërkesave të arritura për qasje të lirë në informacionet me karakter publik në Këshillin gjyqësor të RMV.	Këshilli gjyqësor i RMV	06.2024	12.2024
	1.3.3 Përgatitja e një udhëzuesi dhe futja e një mjeti për parashtrimin e ankesave dhe parashtrësive nga qytetarët përmes ueb-faqes të Këshillit gjyqësor të RMV	Numri i rritur i parashtrësive të parashtruara nga qytetarët e RMV përmes ueb faqes së Këshillit gjyqësor të RMV dhe numri i zvogëluar i parashtrësive të hedhura poshtë të parashtruara nga qytetarët	Këshilli gjyqësor i RMV	06.2024	12.2024
	1.3.4 Implementimi i përmirësimit të softuerëve të nevojshëm identifikues në ueb-faqen e Këshillit gjyqësor të RMV	Hapësirë e re në ueb faqen me më shumë informacione për mediumet dhe për mënyrat e parashtrimit të parashtrësive në KGJRMV	Këshilli gjyqësor i RMV	01.2025	12.2025
			<i>Angazhim nga plani i mëparshëm</i>		
Institucion udhëheqës i zbatimit			<i>Këshilli gjyqësor i RMV</i>		

Emri i personit përgjegjës në agjencinë e zbatimit		Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme
Funksioni, Njësia		Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme
Email		Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme
Telefoni		Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme
Subjekte tjera që përfshihen	Ministritë qeveritare, njësitë/agjencitë	<i>Të gjitha gjykatat në RMV</i>
	Organizata civile, sektorë privat, grupe punuese dhe multilaterale	<i>Shoqata e gjyqtarëve, Qendra për hulumtime dhe analiza juridike</i>

2. PERFORMANCA

2.1 PËRFORCIMI I ROLIT MBIKËQYRËS TË KËSHILLIT GJYQËSOR NDAJ TRANSPARENCËS SË GJYKATAVE

(1 Shtator 2024 – 31 Dhjetor 2024)

Cila çështje publike adresohet me angazhimin?

Në Ligjin për Këshillin gjyqësor neni 92, paragrafi (1), pika 5 është risi në kornizën juridike maqedonase, sipas të cilës, Këshilli gjyqësor vlerëson nëse kryetarët e gjykatave vazhdimisht kujdesen për marrëdhëniet me publikun. Këshilli gjyqësor këtë duhet ta bëjë nëpërmjet këqyrjes në ueb-faqen e gjykatave, përkatësisht nëpërmjet kontrolleve të njoftimeve, vendimeve, analizave dhe raporteve të cilat publikohen. Këshilli gjyqësor, gjithashtu, duhet të vlerësojë nëse kryetari i gjykatës kujdeset për veprimin adekuat për kërkesat për qasje të lirë në informacionet me karakter publik.

Në fund të vitit 2019, Këshilli gjyqësor solli dhe miratoi një Rregullore të re për punën e Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, megjithatë ende nuk ka filluar me realizimin e mbikëqyrjes mbi ueb-faqet e gjykatave. Këshilli gjyqësor t'i monitorojë ueb-faqet e gjykatave, përkatësisht të vlerësojë punën e kryetarëve, duhet të vendos rregulla proceduese konkrete për atë qëllim (cili i punësuar ose cila njësi organizuese në kuadër të Këshillit gjyqësor të RMV do të bëjë mbikëqyrjen në ueb-faqet e gjykatave, si ai person/ ajo njësi organizuese do ta njoftojë Këshillin gjyqësor për konstatimet, si anëtarët e Këshillit gjyqësor do të vlerësojnë nëse një kryetar i një gjykate konkrete ka vepruar sipas ligjit ose jo dhe të ngjashme).

Qëllimi kryesor i angazhimit			• <i>Përforcimi i rolit aktiv të Këshillit gjyqësor në ndjekjen e sigurisë së transparencës nga ana e kryetarëve të gjykatave në marrëdhëniet me publikun,</i> • <i>Përgatitja e akteve të reja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës sipas Rregullores së re të punës së Këshillit gjyqësor të RMV</i>		
Si do të kontribuojë angazhimi në zgjidhjen e një çështje publike?			<i>Angazhimi parasheh aktivitete të cilat janë plotësisht për rritjen e transparencës së gjykatave nëpërmjet futjes së një sistemi të monitorimit të punës së kryetarëve të gjykatave në RMV nëpërmjet ueb faqet e gjykatave.</i>		
Pse është i rëndësishëm ky angazhim për vlerat e PQH?			Angazhimi mundëson qasjen në një vëllim më të madh të informacioneve dhe e përmirëson qasjen në informacionet për publikun, pasi që angazhimi konsiderohet si transparent.		
Informacione shtesë			<i>Në lidhje me qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme”</i> <i>Target 16.6: Të zhvillohen institucione transparente, efektive dhe të përgjegjshme në të gjitha nivelet.</i> <i>Ky angazhim është i rëndësishëm për përmirësimin e përgjegjësisë publike të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nëpërmjet përmirësimit të rregullave dhe mekanizmave me të cilat do të sigurohet përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit gjyqësor dhe të punësuarve në realizimin e rolit aktiv në sigurimin e transparencës së gjykatave.</i>		
Nr.	Arritja	indikatorë	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit

2.1.1 Zhvillimi i Metodologjisë për vlerësimin e kryetarëve të gjykatave për marrëdhëniet me publikun dhe transparencën e punës	Metodologji e miratuar dhe rregulla tjera (Rregullore, Procedura) për vlerësimin e kryetarëve të gjykatave nga ana e KGJRMV	Këshilli gjyqësor i RMV	02.2024	06.2024
2.1.2 Përcaktimi cilësor i pikëve të kriterit të marrëdhënieve me publikun dhe transparenca e punës	Metodologji e miratuar dhe rregulla tjera (Rregullore, Procedura) për vlerësimin e ueb faqeve të gjykatave nga ana e KGJRMV	Këshilli gjyqësor i RMV	06.2024	09.2024
2.1.3 Përgatitja e procedurave standarde operative dhe përcaktimi i hartave proceduese për realizimin e monitorimit të ueb-faqeve të gjykatave, përkatësisht për vlerësimin e punës së kryetarëve në pjesën për marrëdhëniet me publikun dhe transparencën e punës	Metodologji e miratuar dhe rregulla tjera (Rregullore, Procedura) për vlerësimin e ueb faqeve të gjykatave nga ana e KGJRMV	Këshilli gjyqësor i RMV	09.2024	12.2024
		<i>Angazhim nga plani i mëparshëm</i>		
Institucion udhëheqës i zbatimit		<i>Këshilli gjyqësor i RMV</i>		
Emri i personit përgjegjës në agjencinë e zbatimit		Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		

Funksioni, Njësia		Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme
Email		Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme
Telefoni		Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme
Subjekte tjera që përfshihen	Ministritë qeveritare, njësitë/agjencitë	<i>Të gjitha gjykatat në RMV</i>
	Organizata civile, sektorë privat, grupe punuese dhe multilaterale	<i>Shoqata e gjyqtarëve, Qendra për hulumtime dhe analiza juridike</i>

2.2 PËRMIRËSIMI/UNIFIKIMI I STRUKTURËS SË RAPORTEVE TË GJYKATAVE DHE CILËSIA E TË DHËNAVE	
(1 Shtkurt 2024 – 31 Dhjetor 2024)	
Cila çështje publike adresohet me angazhimin?	<i>Në dokumentet strategjike të gjyqësorit vazhdimisht konstatohet se forma e raporteve vjetore të punës së gjykatave, Këshillit gjyqësor dhe të Gjykatës Supreme janë të pabarabarta, që krijon probleme në raport me qartësimin, kuptueshmërinë e raporteve, sidomos në pjesën e të dhënave statistikore</i>

	<i>për shkak të mos-harmonizimit së të dhënave. Një pjesë e madhe e gjykatave bëjnë statistikën për numrin e lëndëve të pranuar, të kryera dhe që janë në punë që në një masë të konsideruar dallohet nga statistika e Këshillit gjyqësor për këto gjykata. Prandaj, është e domosdoshme të uniformohen dhe të standardizohen të gjitha raportet (mujore dhe vjetore) që i përgatisin gjykatat dhe institucionet gjyqësore.</i>
Qëllimi kryesor i angazhimit	<i>Raportet e gjykatave janë të unifikuara dhe japin informacione të plota cilësore dhe sasiore për punën e gjykatave</i> <i>Nevojitet që të përgatitet dhe të miratohet një Metodologji për formularë të unifikuar për raportet vjetore, që pastaj të përgatitet formular adekuat i raporteve të gjykatave që do të pasohet me udhëzim të detajuar për plotësimin e tyre.</i>
Si do të kontribuojë angazhimi në zgjidhjen e një çështje publike?	<i>Vendosja e një Metodologjie për formularë të uniformuar për marrjen e unifikuar të informacioneve dhe të dhënave në publik para se gjithash do të arrihet të një sinkronizim i të dhënave me të cilat disponojnë institucionet gjyqësore. Praktika e deritanishme e grumbullimit dhe sistemimi i të dhënave të ndryshme statistikore për gjykatat në RMV do të zëvendësohet me qasje të unifikuar dhe formularë për grumbullimin dhe publikimin e këtyre të dhënave.</i>
Pse është i rëndësishëm ky angazhim për vlerat e PQH?	<i>Angazhimi mundëson uniformimin e të dhënave të gjykatave që janë në dispozicion për publikun, pasi që angazhimi është i rëndësishëm për përmirësimin e çiltërsisë dhe</i>

			transparencës.		
Informacione shitesë			<i>Në lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme” Target 16.6: Të zhvillohen institucione transparente, efektive dhe të përgjegjshme në të gjitha nivelet.</i> <i>Ky angazhim është i rëndësishëm për përmirësimin e përgjegjësisë së gjykatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut nëpërmjet përmirësimit dhe unifikimit të strukturës së raporteve të gjykatave dhe cilësia e të dhënave, me të cilat publikut do t'i mundësohet informim cilësor dhe sasior për punën e gjykatave.</i>		
Nr.	Arritja	indikatorë	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
	2.2.1 Përgatitja dhe miratimi i Metodologjive për formularë të unifikuar për raportet vjetore	Metodologji e miratuar dhe rregulla tjera (Rregullore, Udhëzues, model) për formularë të unifikuar për raportet vjetore të gjykatave në RMV	Gjykata Supreme e RMV	02.2024	06.2024
	2.2.2 Përgatitja e një modeli të raporteve për gjykatat	Metodologji e miratuar dhe rregulla tjera (Rregullore, Udhëzues, model) për formularë të unifikuar për raportet vjetore të	Gjykata Supreme e RMV	06.2024	09.2024

		gjykatave në RMV			
	2.2.3 Udhëzues për plotësimin e raporteve për gjykatat	Metodologji e miratuar dhe rregulla tjera (Rregullore, Udhëzues, model) për formularë të unifikuar për raportet vjetore të gjykatave në RMV	Gjykata Supreme e RMV	09.2024	12.2024
			<i>Angazhim nga plani i mëparshëm</i>		
Institucion udhëheqës i zbatimit			<i>Gjykata Supreme e RMV</i>		
Emri i personit përgjegjës në agjencinë e zbatimit			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Funksioni, Njësia			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Email			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Telefoni			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Subjekte tjera që përfshihen	Ministritë qeveritare, njësitë/agjencitë		<i>Këshilli gjyqësor i RMV, të gjitha gjykatat në RMV</i>		

	Organizata civile, sektorë privat, grupe punuese dhe multilaterale	<i>Shoqata e gjyqtarëve, Qendra për hulumtime dhe analiza juridike</i>

2.3 PËRMIRËSIMI I SISTEMIT ELEKTRONIK PËR TRAJNIMIN THEMELOR DHE TË VAZHDESHËM TË GJYQTARËVE (1 Shkurt 2024 – 30 Qershor 2025)	
Cila çështje publike adresohet me angazhimin?	<i>Ueb-faqja e re e Akademisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë është lëshuar në përdorim në Shtator të vitit 2019, megjithatë ende ka hapësirë dhe nevojë për mundësimin e modernizimit të punës së AGJPP nëpërmjet mundësimit të platformës moderne e-mësimit si për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë publik ashtu edhe për gjyqtarët dhe prokurorët publik ekzistues nëpërmjet mundësimit të webinarëve dhe mësimit nëpërmjet kërkimit të sofistikuar nëpër dokumentet në dispozicion të bibliotekës-e moderne dhe arkivit modern. Mbindërtimi i bibliotekës-e dhe arkivit të AGJPP është i domosdoshëm, për tu siguruar materiale adekuate për edukimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve publik (të ardhshëm).</i>
Qëllimi kryesor i angazhimit	<i>Mundësimi i qasjes më të lehtë në përmbajtjet e mësimit fillestar dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve</i> <i>Nëpërmjet platformës online për mbajtjen e trajnimeve themelore dhe</i>

	<i>të vazhdueshme për gjyqtarët (e-learning), bibliotekë-e moderne dhe arkiv-e do të mundësohet qasje më e lehtë në materialet për përsosjen e gjyqtarëve</i> • <i>Me sistematizimin dhe publikimin e rregullt të konkluzioneve të Gjykatave të Apelit dhe të qëndrimeve parimore dhe mendime juridike të Gjykatës Supreme për unifikimin e praktikës gjyqësore do të kontribuohet në rritjen e drejtësisë cilësore të barabartë ndaj të gjithëve.</i>
Si do të kontribuojë angazhimi në zgjidhjen e një çështje publike?	<i>Nëpërmjet angazhimit për modernizimin e sistemit për trajnim themelor dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, do të mundësohet qasje e tërësishme e trajnimit themelor dhe të vazhdueshëm për dëgjuesit, në role kur mësimi në largësi është mundësia e vetme për përsosjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve.</i>
Pse është i rëndësishëm ky angazhim për vlerat e PQH?	<i>Angazhimi parashikon shpalljen publike dhe qasjen e programeve dhe materialeve të cilat shfrytëzohen për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, duke përfshirë edhe konkluzionet nga takimet e katër gjykatave të apelit dhe Gjykatës Supreme të RMV që tregon mbi angazhimin për përmirësimin e transparencës së punës së AGJPP dhe gjykatave në RMV dhe rritjen e cilësisë së drejtësisë gjyqësore.</i>
Informacione shtesë	<i>Në lidhje me qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme” Target 16.6: Të zhvillohen institucione transparente, efektive dhe të përgjegjshme në të gjitha nivelet.</i> <i>Ky angazhim është i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së vendimeve</i>

			gjqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet përmirësimit të sistemit elektronik për trajnimin themelor dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve në Akademinë për gjyqtarë dhe Prokurorë publik në të cilën kanë qasje të gjithë gjyqtarët në RMV.		
Nr.	Arritja	indikatorë	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
	1.1.1 Zhvillimi i platformës online për mbajtjen e trajnimeve themelore dhe të vazhdueshme për gjyqtarët (e-learning) dhe përgatitja e materialeve edukative elektronike dhe qasja në bazat online.	Numri i trajnimeve të mbajtura nëpërmjet Platformës për mësim-e të AGJPP	Akademia për gjyqtarët dhe Prokurorët publik	02.2024	06.2024
	2.3.2 Sistematizimi dhe publikimi i rregullt i konkluzioneve të Gjykatave të apelit dhe qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike të Gjykatës Supreme të RMV për unifikimin e praktikës gjyqësore në ueb faqen e AGJPP	Numri i konkluzioneve të publikuara, mendimeve juridike dhe qëndrimeve parimore në ueb faqen e AGJPP	Akademia për gjyqtarët dhe Prokurorët publik	06.2024	09.2024
	2.3.3 Përforcimi i kapaciteteve të gjyqtarëve për përdorimin e platformës e-learning për mësimin e vazhdueshëm	Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve publik që kanë vizituar trajnime nëpërmjet platformës për mësim-e të AGJPP	Akademia për gjyqtarët dhe Prokurorët publik	10.2024	12.2024
	2.3.4 Publikimi i raporteve statistikore për aktivitetet e gjyqtarëve në platformën e-learning për mësimin e vazhdueshëm	Numri i raporteve të publikuara	Akademia për gjyqtarët dhe Prokurorët publik	01.2025	03.2025

	2.3.5 Vendorsja e bibliotekës-e moderne dhe arkivit-e.	Numri i librave-e në dispozicion në bibliotekën-e të AGJPP	Akademia për gjyqtarët dhe Prokurorët publik	02.2024	06.2025
			<i>Angazhim nga plani i mëparshëm</i>		
Institucion udhëheqës i zbatimit			<i>Akademia për gjyqtarët dhe Prokurorët publikë</i>		
Emri i personit përgjegjës në agjencinë e zbatimit			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Funksioni, Njësia			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Email			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Telefoni			Plotësohet nga institucionet kompetente në fazën e mëvonshme		
Subjekte tjera që përfshihen		Ministritë qeveritare, njësitë/agjencitë	<i>Këshilli gjyqësor i RMV, të gjitha gjykatat në RMV</i>		
		Organizata civile, sektorë privat, grupe punuese dhe multilaterale	<i>Shoqata e gjyqtarëve, Qendra për hulumtime dhe analiza juridike</i>		

